Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 11 (183) NËNTOR 2021. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

BIG

një epokë e re dashurie
ndaj jush po nis tani

DEBAT/SKAVICA

Një digë e vetme e madhe, është një katastrofë

Nga prof. asoc. dr. **VESEL HOXHA** — Faqe 7

INVESTIGIM

Qafë Buall-Krastë, 16 km e "rrugës së vdekjes"

Nga **ARJETA CUKA** — Faqe 8

VEPRIMTARI

Lura po vendoset në vendin që i takon në historinë shqiptare

Nga prof. dr. **ADEM BUNGURI** — Faqe 15

VEPRIMTARI

"Historia Shatku", dokumentari historiko-biografik

Nga **TOFIK JEGENI** — Faqe 18

Rruga e Arbrit, pjesë e rëndësishme e një korridori ekonomik në rajon

"Rruga e Arbrit çeli sot shtegun e vjetër në një dimension të ri infrastrukturor, bashkëkohor. Ajo është gati të ofrojë provizorisht një udhëtim dinjitoz, përgjatë 48 kilometrave të realizuara plotësisht dhe të dorëzuara, ndërkohë që mbeten edhe pak kilometra nga përfundimi i plotë i saj".

"Prej 1 shekulli e ëndërruar nga shqiptarët, rruga shkurton ndjeshëm distancën mes Dibrës dhe kryeqytetit, duke e bërë të përshkueshme në një hark kohor prej vetëm 47 minutash, nga 1 orë e 20 minuta që bëhet sot ose nga 4 orë që bëhej deri dje. Ndërkohë që lehtëson transportin e qytetarëve dhe krijon më shumë aksesueshmëri për daljen në treg të produkteve të zonës"

"Rruga është spektakolare për faktin se kalon përmes një natyre të mrekullueshme, që deri më sot ishte tërësisht e padukshme për shkak të izolimit".

"Shumë herë e nisur, por asnjëherë e bitisur, me projekte të lëna në mes dhe punime gjysmake, rruga mbeti për vite të tëra, peng i mentalitetit "shkel e shko". Sot, kjo rrugë është premtim i mbajtur nga qeveria, që shërben, jo vetëm si aks i brendshëm, por edhe si pjesë e rëndësishme e një korridori ekonomik në rajon".



NJIHU ME RRUGËN PËRMES VIDEOVE NË KOHË REALE

Pamje nga rruga e Arbrit në Xibër, Klos

Grupi i Lobimit përshëndet nisjen e parakohshme të qarkullimit në Rrugën e Arbrit

Punimet në vazhdim nuk duhet të rrezikojnë jetën e punëtorëve dhe udhëtarëve

Lexoni në faqet 2,3

KRIJOHET LËVIZJA: ALEANCA PËR MBROJTJEN E DIBRËS.

Qytetarët në protestë kundër ndërtimit të Skavicës

Ferzileta Gjika: Tri arsye pse jam kundër ndërtimit të HEC Skavica. **Arif Mata**: Skavica vret, nuk kuron

Lexoni në faqet 4-5

POSTA SHQIPTARE

Pajtohu në gazetën **RRUGA E ARBËRIT** pranë çdo filiali të **POSTËS SHQIPTARE në të gjithë Shqipërinë.** Një pajtim vjetor kushton **600 lekë.**

NË BRENDËSI:

- **Gazmend Hajdaraga** i Dibrës së Madhe
- Prof.asoc. dr.**Ali Tonuzi** - kirurgu vitreoretinal që kryen ndërhyrjet më të ndërlikuara në sy
- **Dibra** pas Pavarësisë Kombëtare (1912-1918)
- **Veprimtaria jubilare** për 100 vjetorin e fitores së Dibrës ndaj pushtuesve serbë më 1921
- **Udhëtim** përgjërues peizazheve të Pasmarit
- **Mulliri**
- **Naimi** poet
- 100 vjet **Shkolla shqipe e Ploshtanit**
- **Xhelal Hysa**, heroi që rron në përjetësi
- "**Ngjizja e papërlyeme**", romani tetralogjik i **Agron Tufës**
- **Nadire Kërkuti**, gruaja që mbushi 100 vjeç Ditën e Flamurit
- **Elez Rasha**, burri i mençur i Dardhës
- **Dogjan Dervishi**, "Një histori qëndrese"
- Një vit pa **Avni Xhepën**

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 11 (183). Nëntor 2021
Gazeta doli nga shtypi, 4 nëntor 2021.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit dhjetor 2021.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra
Editor i faqes online: Agim Deva
Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Adem BUNGURI
Vesel HOXHA
Arif MATA
Ferzileta XHIKA
Shaqir ÇERPJA
Arjeta ÇUKA
Halil RAMA
Selman MËZIU
Besnik RAMA
ISMEN BRIKA
HAJRI SHEHU

Redaksia falenderon përzemërsisht zotin **Artan Hysa** për donacionin prej 5000 lekësh dhënë për gazetën.

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Grupi i Lobimit përshëndet nisjen e parakohshme të qarkullimit në Rrugën e Arbrit

Punimet në vazhdim nuk duhet të rrezikojnë jetën e punëtorëve dhe udhëtarëve

Kryeministri Edi Rama më 29 nëntor 2021 ishte i pranishëm në hapjen e qarkullimit në Rrugën e Arbërit. Askush më shumë se dibranët nuk e pret më me padurim përurimin e kësaj vepre të rëndësishme infrastrukturore. Megjithatë, ceremonia e parakohshme e përurimit është një tregues tjetër i shkallës së ulët të kooperimit midis qeverisë dhe opozitës.

Ashtu siç ka ndodhur rregullisht me këtë vepër gjatë tre dekadave të fundit, edhe tani kur, si i thonë fjalës, dibranët më në fund po shohin dritë në fund të tunelit, kasta politike shqiptare po përdor këtë vepër të rëndësishme për interesat e tyre. Dita kur qeveria dhe opozita në Shqipëri, siç ndodh në vende të civilizuara, të marrin pjesë dhe gëzojnë së bashku në përurime veprash, duket akoma e largët.

Lajmi i nisjes së qarkullimit të pjesshëm në këtë aks të rëndësishëm rrugor është një lajm i mirë. Siç kemi deklaruar në nisje të peticionit, qëllimi është që Rruga e Arbërit të ndërtohet sa më shpejt dhe më standarde, dhe për këtë ne do të vazhdojmë të jemi vëzhgues të paanshëm deri në metrin e fundit.

Qeveria ka njoftuar se në fazën e ndërtimit të Tunelit të Murrizit kanë dalë problematika në lidhje me strukturën gjeologjike. Ne nuk e kemi parë këtë të ilustruar në terren. Deri më sot, asnjë media apo organizatë tjetër nuk është parë të hyjë në tunel dhe të bëjë publike pamjet. Po kështu, nuk kemi parë të ketë as ndonjë debat mes gjeologëve dhe specialistëve përkatës.

Megjithatë, ne shpresojmë dhe urojmë që punimet të vazhdojnë. Po kaq i rëndësishëm është edhe ndërtimi e një tuneli me standarde bashkëkohore.

Rruga e ndërtuar deri më tani vëmë re se është sipas parametrave të njoftuar më parë. Shpresojmë se punime e pambaruara do të jenë cilesore dhe se do të përmirësojnë cilësinë e rrugës dhe sigurinë e saj.

Nga informacionet e botuara deri më tani, nuk është e qartë se përse qeveria vendosi ta hapë rrugën për qarkullim tani. Duke qenë se rruga është akoma një kantier ndërtimi, siguria e punëtorëve, drejtuesve të automjeteve dhe kalimtarëve është më e rëndësishme se nisja e qarkullimit të përshpejtuar, pavarësisht dëshirës së mirë.

Kemi vënë re se në të gjitha segmentet janë vendosur sinjalistika të përkohshme që tregojnë vazhdimësinë e punime në rrugë. Shpresojmë dhe u bëjmë thirrje udhëtarëve dhe drejtuesve të automjeteve t'i respektojnë ato.

Hapja e parakohshme për qarkullim krijon lehtësira për qytetarët dhe ne urojmë që ky veprim të mos cënojë punimet në rrugë për dorëzimin në kohë dhe me cilësi në afatin e kontraktuar.

Segmenti nga Ura e Vashës deri në Qafë të Buallit konstatuam se është i pambaruar. Ky segment, së bashku me segmentin tjetër në dalje të Tiranës, pranë Qafës së Tujanit, përbën rrezik për kalimtarët, pasi nga skarpatet e larta dhe të thepisura mund të ketë rënie gurësh. Ne shpresojmë se në këtë fazë të ndërtimit të rrugës, kompania të ecë me ritme më të shpejta për të garantuar sigurinë e udhëtarëve.

Në kemi konstatuar se standardi C2 i rrugës i reklamuar nga qeveria shqiptare mbyllet në Maqellarë. Ne i kërkojmë qeverisë shqiptare që këtë standard ta vazhdojë edhe në drejtim të pikës doganore të Bllatës si dhe të negociojë me qeverinë e Maqedonisë së Veriut që ky segment të vazhdojë sa më parë drejt lidhjes me Shkupin.

Gjatë këtyre ditëve ne kemi vënë re përmes shtypit se qeveria po përpiqet që me hapjen e plotë të rrugës vitin e ardhshëm, të vendosë edhe një taksë kalimi. Ne shpresojmë që këto lajmë të jenë jo të vërteta. Ne e konsiderojmë vendosjen e një takse kalimi në këtë aks një vendim të padrejtë.

Nisja e qarkullimit të makinave përmes Rrugës së Arbëit është një rast i mirë për drejtuesit e automjeteve dhe qytetarët që të shohin ecurinë e punimeve dhe të raportojnë problematikat që hasin gjatë udhëtimit. Kritikat dhe sugjerimet e tyre duhet të merren parasysh nga specialistet në mënyrë që ato të korrigjohen sa më parë.

Faktori politik shqiptar në Maqedoni duhet të angazhohet pa vonesë që punimet për këtë vepër të fillojnë sa më parë. Grupi i Lobimit është në kontakt për këtë vepër me përfaqësues lokal dhe qëndror të politikës shqiptare në Maqedoni që nga viti 2014, dhe do ta vazhdojë lobimin në këtë drejtim.

Grupi i Lobimit do të ketë kënaqësinë të marr pjesë në përurimin e rrugës kur ajo të ndërtohet jo vetëm deri në Bllatë po edhe në Peshkopi sipas standardeve ndërkombëtare.

Deri sa te vij ajo ditë, peticioni për këtë vepër, që deri tani ka mbi 20,000 përkrahës, nga te cilet me shume se 18,000 online, do të qëndroj i hapur dhe mund të nënshkruhet këtu: https://bit.ly/3poy8r7

Njoftim për Mediat i Grupi i Lobimit,
Tiranë, 4 dhjetor 2021

> Ashtu siç ka ndodhur rregullisht me këtë vepër gjatë tre dekadave të fundit, edhe tani kur, si i thonë fjalës, dibranët më në fund po shohin dritë në fund të tunelit, kasta politike shqiptare po përdor këtë vepër të rëndësishme për interesat e tyre. Dita kur qeveria dhe opozita në Shqipëri, siç ndodh në vende të civilizuara, të marrin pjesë dhe gëzojnë së bashku në përurime veprash, duket akoma e largët.



> Nisja e qarkullimit të makinave përmes Rrugës së Arbëit është një rast i mirë për drejtuesit e automjeteve dhe qytetarët që të shohin ecurinë e punimeve dhe të raportojnë problematikat që hasin gjatë udhëtimit. Kritikat dhe sugjerimet e tyre duhet të merren parasysh nga specialistet në mënyrë që ato të korrigjohen sa më parë.



Kjo është një rrugë që zgjat 69 kilometra nga Tirana në Maqellarë, por në kontratën e koncesionit janë 54 kilometra, nga të cilat 48 janë që nga 29 nëntori në përdorim.

Rruga e Arbrit, pjesë e rëndësishme e një korridori ekonomik në rajon



DISTANCA E PËRAFËRT NGA QENDRA E TIRANËS

Klos:	40 km
Burrel:	55 km
Bulqizë:	55 km
Peshkopi:	100 km
Dibër e Madhe:	80 km.

Më 29 nëntor 2021 në afërsi të urës së fshatit Fshat në Klos u krye ceremonia e nisjes zyrtarisht të qarkullimit në një segment të Rrugës së Arbrit.

Kalimi në këtë segment prej 35 km, nga Tirana në Klos, është i mundur përmes një by-passi prej 8.8 km, që lidh dy anët e tunelit të Murrizit, 3.78 km.

Tuneli i Murrizit përbëhet nga dy tuba kalimi, njëri prej të cilëve do të përdoret si kalim për rastet emergjence. Sipas burimeve nga kompania, puna po vazhdon në të dy tunelet dhe pritet që bashkimi i dy anëve të tunelit të kryhet në në prill të vitit të ardhshëm. Burime nga kompania pohojnë se nga tuneli kryesor janë pa u hapur edhe gati 700 metra, ndërsa në tunelin e emergjencës janë pa u hapur edhe gati 650 metra.

"Rruga e Arbrit çeli sot shtegun e vjetër në një dimension të ri infrastrukturor, bashkëkohor. Ajo është gati të ofrojë provizorisht një udhëtim dinjitoz, përgjatë 48 kilometrave të realizuara plotësisht dhe të dorëzuara, ndërkohë që mbeten edhe pak kilometra nga përfundimi i plotë i saj", shkruhet në një njoftim të shpërndarë për publikun nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

"Prej 1 shekulli e ëndërruar nga shqiptarët, rruga shkurton ndjeshëm distancën mes Dibrës dhe kryeqytetit, duke e bërë të përshkueshme në një hark kohor prej vetëm 47 minutash, nga 1 orë e 20 minuta që bëhet sot ose nga 4 orë që bëhej deri dje. Ndërkohë që lehtëson transportin e qytetarëve dhe krijon më shumë aksesueshmëri për daljen në treg të produkteve të zonës. Por jo vetëm. Rruga është spektakolare për faktin se kalon përmes një natyre të mrekullueshme, që deri më sot ishte tërësisht e padukshme për shkak të izolimit", thuhet në njoftimin e MIE.

Hapja e këtij segmenti për kalimin e automjeteve konsiderohet nga qeveria si një "premtim i mbajtur".

"Shumë herë e nisur, por asnjëherë e bitisur, me projekte të lëna në mes dhe punime gjysmake, rruga mbeti për vite të tëra, peng i mentalitetit "shkel e shko". Sot, kjo rrugë është premtim i mbajtur nga qeveria, që shërben, jo vetëm si aks i brendshëm, por edhe si pjesë e rëndësishme e një korridori ekonomik në rajon", thuhet në njoftim.

Në ceremoninë e nisjes së qarkullimit më 29 nëntor në mesditë ishte edhe Kryeministri Edi Rama, i cili në mënyrë simbolike, në tunelin numër 2, u realizua edhe heqja e pengesës që shënon hapjen provizore për qarkullim në rrugën e Arbrit.

Belinda Balluku, Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke folur në ceremoninë e hapjes tha se "po bëhet gjithçka që rruga të realizohet brenda afateve të përcaktuara".

"Jemi në dalje të tunelit numër 2 dhe në platformën që e lidh me tunelin 3. Në mënyrë simbolike do të ngremë traun që bllokon Rrugën e Arbrit për momentin. Kjo është një rrugë që zgjat 69 kilometra nga Tirana në Maqellarë, por në kontratën e koncesionit janë 54 kilometra, nga të cilat 48 ne i dorëzojmë sot, në përdorim. Siç e patë qafën e Murrizit e kemi zgjidhur përmes një bypass-i i cili është i gjatë 8,8 km. Është një bypass provizor sepse ne duhet të vazhdojmë një pjesë të punimeve që duhen përfunduar. Kontrata ka afat dorëzimi fundin e prillit 2022 dhe do të bëjmë të pamundurën për të dorëzuar gjithçka në kohën e duhur." – u shpreh Ministrja Balluku, teksa shpjegoi se problematike mbetet gjeologjia e veçantë e tunelit të Murrizit, që ka vonuar edhe punimet.

"Ashtu siç kemi informuar herë pas here problemi qëndron në gjeologjinë e Tunelit të Murrizit që është tuneli më i gjatë i kësaj vepre me 3,8 kilometra, një tunel ku ne kemi hasur në shtresa argjilore dhe burime ujore nëntokësore, të cilat e shkrijnë këtë argjil. Megjithatë aty punohen në mënyrë të vazhdueshme, por nuk ka atë ecuri që ne kemi patur në 5 tunelet e tjera, apo në tunelin e Skërficës, i cili mbaroi nga e njëjta kompani "Gjoka" në kohë rekord. Kjo është një ditë e shënuar. Rruga, shkurtohet nga katër orë që dikur shkohej në Dibër, sot shkohet për një orë dhe duke patur parasysh të gjithë segmentet e tjera që do t'i bashkohen në vazhdim të gjithë veprës, ne jemi të sigurtë që deri në prill gjithçka do të jetë në vendin e duhur."- shpjegoi ajo.

Ministrja Balluku tha gjithashtu se janë marrë të gjitha masat, në koordinim me Policinë Rugore për informimin e drejtuesve të automjeteve, për specifikat e rrugës së hapur, duke kërkuar prej tyre, kujdes dhe respektim të rregullave të qarkullimit.

"Kemi bërë një koordinim shumë të mirë me policinë rrugore gjatë gjithë kohës, ku është punuar në këtë vepër dhe sidomos javën e fundit, duke qenë se është ende në kushtet e kantierit. Kështu që duhet të ketë një vëmendje nga policia rrugore gjatë gjithë kohës. Ne i kemi bërë thirrje përmes mediave të gjithë drejtuesve, të cilët duhet të tregohen të kujdesshëm, për të udhëtuar me shpejtësinë që parashikohet në të gjithë rrugën." – u shpreh Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku.

Tre ditë para se të inaugurohej një segment i rrugës, më 26 nëntor, Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, e shoqëruar nga drejtori i Policisë Rrugore në Policinë e Shtetit, Altin Qato dhe administratori i shoqërisë "Gjoka '87", Erind Gjoka, zhilluan një inspektim gjatë gjithë aksit të rrugës.

"Po e hapim këtë aks rrugor para afatit kontraktual", - tha përmes një videoje të shpërndarë në faqen e saj në FB ministrja Balluku.

"Kontrata e mbarimit të saj është në pranverë 2022, megjithëse ne po e hapim para kohe, me qëllim lehtësimin e trafikut gjatë periudhës së dimrit".

Ajo bëri thirrje për një vëmendje të shtuar gjatë qarkullimit në këtë aks, pasi "jemi në kushtet e kantierit, kështu që duhet shumë kujdes nga ana e drejtuesve të automjeteve".

"Ne i kemi marrë të gjitha masat" – tha Altin Qato, drejtor i Policisë Rrugore në Policinë e Shtetit.

"Kemi nxjerrë urdhër shërbimi për në të dy akset, si në qarkun e Tiranës ashtu edhe në atë të Dibrës. Do të jetë shërbim i shtuar në kontroll dhe shpejtësia do të jetë e kufizuar. Do të ushtrojmë kontrolle me qëllim rritjen e parametrave të sigurisë", tha Drejtori i Policisë Rrugore.

Erind Gjoka, administratori i kompanisë koncensionare "Gjoka '87" i tregoi ministres Balluku proceset e fundit të punës, para se të nisë qarkullimi zyrtarisht më 29 nëntor 2021.

"Jemi duke vendosur sinjalistikën rrugore, vizimet, barrierat mbrojtëse, tabelat dhe në bashkëpunim me policinë e shtetit, besojmë se deri ditën e diel, gjithçka do të jetë e përfunduar".

Erind Gjoka përsëriti thirrjen për drejtuesit e mjeteve që "të respektojnë sinjalistikën, pasi jemi akoma në një kantier ndërtimi".

"Rruga është e bukur, - tha ministrja Balluku, - është e parametrave europianë dhe ndoshta të thërret pak edhe për shpejtësinë, por kjo nuk duhet të ndodhë, pasi është një rrugë e re dhe do të dojë pak kohë të ambientohen edhe drejtuesit e mjeteve me ketë pjesë të rrugës".

Balluku tha gjithashtu se "by-passi, prej 8.8 km, është ndërtuar nga kompania Gjoka pa i shtuar asnjë kosto projektit,pavarësisht çfarë dëgjojmë kohët e fundit, dhe është bërë për të lehtësuar lëvizjen".

"Në tunelin e Murrizit, 3.8 km të gjatë, kemi hasur në formacione argjilore me rrjedhje të mëdha uji, duke krijuar rrëshqitje të herë pas hershme, duke e kthyer në një nga tunelet më kompleksë në këtë aks rrugor, pavarësisht se kjo rrugë ka edhe 5 tunele të tjerë".

Duke pasur parasysh se by-passi kalon në zonë malore, Balluku tha se "gjatë ditëve me reshje bore, rruga do të jetë e mbyllur për qarkullim".

"Në rastet kur do të ketë reshje dëbore, ne do të detyrohemi të mbyllim pjesën e by-passit. Bashkë me ARRSH kemi bërë një kërkim për tre vitet e fundit dhe, pak a shumë, nuk rezulton më shumë se 5 ditë me borë në tre vitet e fundit . Në këto ditë me borë by-passi do të mbyllet dhe do të përdoret rruga e vjetër" – theksoi ministrja Balluku.

Rruga, e cila do të jetë funksionale me datë 29 nëntor 2021, përveç by-passit, ka edhe një segment tjetër ku duhet pasur kujdes të shtuar, në shkallën e Tujani, rreth 2 km.

Punimet në këtë segment janë kryer përpara se "Gjoka '87" të merrte rrugën me koncension dhe, ashtu si në segmentin Ura e Vashës – Qafa e Buallit, ka nevojë për punime shtesë, sidomos mbrojtje anësore nga rënia e gurëve dhe krijimi i taracave të sigurisë. Në Shkallën e Tujanit, 2 metra nga ana e malit nuk janë asfaltuar, me qëllim krijimin e një hapësire sigurie, por edhe për vazhdimin e punimeve në rritjen e parametrave të sigurisë. Ditën e inagurimit pati disa vështirësi në qarkullimin e makinave përgjatë by-passit, për shkak të rënies së borës. Disa makina u bllokuan gjatë orëve të pasdites dhe u desh ndërhyrja e borëpastruesve që rruga të hapej në orët e para të natës.

Kilometri "0" në rrugën e Arbrit nis sapo kalon Tufinën. Deri në Klos rruga është e gjatë 35 km, 70 km më pak se në aksin tradicional nga Shkopeti. Ky segment, duke respektuar sinjalistikën e vendosur, parashikohet të kalohet për më pak se 50 minuta.

Korresp. Rr.A.

KALENDAR

4 janar 1996: 46 intelektualë të shoqatës "Nisma Dibrane" hartojnë një peticion, i pari zyrtarisht, ku i kërkohet qeverisë hapja e Rrugës së Dibrës.

2003: Qeveria akordoi fondin prej 11 milionë lekësh për studimin e fizibiletit.

25 korrik 2004: Këshilli Kombëtar i Rrugëve miratoi Studimin e Fizibilitetit

Korrik 2005: Nisin punimet formalisht në Fushë Bulqizës, pa një projekt.

Tetor 2007: zhvillohet tenderi për segmentin Bulqizë - Ura e Çerenecit.

Janar 2008: Filluan zyrtarisht punimet në Fushë Bulqizë

Qershor 2009: Hapet tenderi për segmentin Bulqiza te Ura e Vashës. Punimet fillojnë në vitin 2011. Ky segment akoma nuk ka mbaruar.

Maj 2011: Fillojnë punimet në segmentin Ura e Brarit - Shkalla e Tujanit.

Mars 2013: Nis një peticion online për Rrugën e Arbrit. Qëllimi është depolitizmi i çështjes dhe presioni ndaj qeverisë për të nisur punimet sa më shpejt.

Dhjetor 2014: Firmoset Memorandum Bashkëpunimi me Chinese Exim Bank për financimin e Rrugës së Arbrit.

Prill 2015: Kuvendi Miraton një ligj të posaçëm për dhënien e ndërtimit të rrugës së Arbrit me koncension kompanisë kineze "China State Construction Company". Bisedimet dështojnë.

Tetor 2016: Bëhet publik propozimi i pakërkuar i kompanisë "Gjoka Konstruktsion"

Gusht 2017: Hapet tenderi për ndërtimin e Rrugës së Arbrit në të gjithë gjatësinë e saj, 69 km.

Tetor 2017: Gjoka Konstruksion paraqet ofertën, 33,6 miliardë lekë.

Dhjetor 2017: Fillojnë formalisht punimet te Ura e Çerenecit.

Mars 2018: Qeveria miratoi kontratën e koncesionit/PPP, me kompaninë "Gjoka Konstruksion", sh.a., për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit.

Prill 2018: Parlamentin miratoi kontratën me "Gjoka Konstruksion" për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit.

Qershor 2018: Zhvillohet ceremonia zyrtare e nisjes së punimeve.

29 nëntor 2021: Nisin zyrtarisht qarkullimi makinave në segmentin krejtësisht të ri nga Tirana në Klos, 35 km.

Rruga e Arbërit nr. 183

Krijohet lëvizja: Aleanca për Mbrojtjen e Dibrës.

Dibër, qytetarët në protestë kundër ndërtimit të Skavicës



Pamje nga protesta në Peshkopi. Foto: ***facebook/bulqizaime***

Më 14 nëntor në mesditë, në Peshkopi janë mbledhur me qindra qytetarë të shqetësuar për projektin e propozuar të ndërtimit të Hidrocentralit të Skavicës. Pjesëmarrësit i bashkonte qëndrimi kundra idesë së ndërtimit të këtij projekti i cili do të sillte shpopullimin më të madh të asaj popullsie të vogël të mbetur tashme, zhdukjen e historisë dhe një impakt të rëndë në mjedisin dhe ekosistemin e zonë.

Të pranishëm ishin edhe shumë dibranë të cilët, megjithëse jetojnë larg, kishin ardhur për të shprehur mbështetjen e tyre nga qytete dhe shtete të ndryshme. Një prej tyre ishte, biri i Dibrës, themeluesi i Partisë Demokratike, themeluesi i komunitetit shqiptare në Britaninë e Madhë, themeluesi i Komitetit për Shpëtimin e Kosovës por tashme i angazhuar në rritjen e marrëdhënieve tregtare ndërkombëtar edhe përfaqëson Republikën e Afrikës së jugut në Republikën e Shqipërisë si Konsulli i tyre, zoti Zenel Hoxha.

Protesta u zhvillua në bulevardin Elez Isufi, ku thirrjeve të shoqatës kundër ndërtimit të Skavicës, iu bashkuan intelektualë, drejtues të shoqatave të tjera dhe qindra qytetarë. Ato firmosën edhe një peticion që do t'i dërgohet Qeverisë dhe Ambasadës së SHBA në Tiranë.

Te pranishmit theksuan urgjencën e angazhimit zyrtar në mënyrë që të dëgjohet zëri i Dibranëve por edhe të mbrohet identiteti i gjithë kombit tonë duke i thënë JO SKAVICËS. Prandaj ata votuan për krijimin e organizatës joqeveritare me emërtimin Aleanca për mbrojtjen e Dibrës. Më tej u konfirmua grupi themelues i cili zgjodhi unanimisht përfaqësuesin zyrtar të Aleancës, zotin Zenel Hoxha.

Aleanca për Mbrojtjen e Dibrës do të dalë së shpejti me relacionin zyrtare dhe shtrije firmosjen e peticionit JO SKAVICËS në të gjithë vendet ku ndodhen dibranë dhe shqiptarë. Legjislacionet e shumë vendeve, sidomos të Bashkimit Europian, parashikojnë peticione të tilla në mënyrë që popullsia e tyre të mund të marrë në llogaridhënie qeveritë e vendeve të tjera e sidomos atyre vendeve që aspirojnë të bëhen anëtarë të Bashkimit Eurpian.

Qëllimi i Aleancës është JO NDËRTIMI I SKAVICËS dhe të gjithë shqiptarët kudo që janë të ndërgjegjësohen dhe të kuptojnë se: VOTA E TYRE VLEN – Dibra edhe këtë herë si nën thirrjen e Elez Isufit do të mbroje identitetin kombëtar dhe do të bëhet motivi i shpëtimit të kombit tonë.

Zoti e ka bekuar Shqipërinë dhe shpëtuar, me dhjetëra herë, nga padrejtësitë.

Me pankarta në duar qytetarët protestuan për rreth në orë, ku shpalosën argumentet e tyre pse janë kundër këtij HEC-i që mbyt përgjithmonë, 32 fshatra, me rreth 12 mijë banorë dhe më shumë se 13 mijë hektarë tokë.

Në tubimin e sotëm fjalën e morën edhe të tjerë intelektualë, historianë, ekspertë mjedisi të cilët theksuan problematikat që shkakton një rezervuar kaq i madh, jo vetëm për ato që do të zhvendosen, por edhe ato që do të mbetet të jetojnë aty. Ndërtimi i një rezervuari kaq të madh do të sillte pasoja të rënda në mjedis dhe në ekosistem, ndërsa popullata e zhvendosur do të vuajë pasojat sociale.

(Korr. Rr.A.)

DEBAT

Skavica vret, nuk kuron

Nga **ARIF MATA***



Pamje nga protesta e 4 nëntorit 2021 të komunitetit dibran e më gjerë në Sheshin e lirisë, fare afër Pallatit të Qelqtë të Kombeve të Bashkuara në New York. Foto: Olsi Beci

Historia e Skavicës nuk është e re. Ajo nisi rreth vitit 1970, kur korifejtë Petrit Radovicka e Farudin Hoxha ishin në kulmin e krijimtarisë së tyre në fushën e energjisë dhe ndërtimit, ashtu si dhe Partia e Punës (Komuniste) të Shqipërisë në kulmin e fuqisë. Çështja e saj u vu në lëvizje në të gjithë treguesit që e përbënin dhe të gjithë produktivitetin që mund të sillte. Di të sigurt se ishte vënë në lëvizje dhe ide-projekti i ndërtimit dhe devijimit të rrugës automobilistike Tiranë-Peshkopi, prej fshatit Boçevë, si rrugë e re në anën e majtë të rrjedhjes së Drinit deri në afërsi të fshatit Hotesh ku me një Urë të re mbi Drin, kalohej në fshatin Selane, Dohoshisht e deri në Peshkopi.

Ishte fjala në respekt të kuotës 485 m të lartë të Digës, pikërisht kjo zgjidhje, që flitet më së shumti dhe sot. Në përbërje të një grupi të përbashkët të instancave të Partisë e Pushtetit të Dibrës e përfaqësuesve të Ndërmarrjes Kombëtare Rruga-Ura Tiranë, ing. B. Mata ndihmues në këtë grup pune, tregon se kur ing. Dhori Guri u pyet, se ku do ishte niveli i përmbytjes, ai kishte thënë se "Ura e Topojanit e sotme do të mbetej 1 m nën pasqyrën e liqenit ujëmbledhës".

Këtij projekti të shqyrtuar gjerë e gjatë me centralizmin maksimal të asaj kohe ishte vendosur, që t'i thuhet jo. Pasi rezultonte një zgjidhje, që nuk e përligjte veten, në një këndvështrim e analizë të gjerë e afat gjatë.

Para dy vjetësh projekti është nxjerre nga sirtarët dhe pa asnjë transparencë qeveritare, po serviret se është gati për të filluar vënien në jetë të tij. Popullit të Dibrës krejt kalimthi i është thënë, se po mendohet për ndërtimin e një Hidrocentrali Hidroelektrik në një, dy apo dhe tri variante dhe kaq. Gjithçka tjetër është lënë në terr! Pyetja e parë që të lind është pse ndodh kështu? Kur ne kompleks dëmi, që i shkaktohet vendit e popullit të Dibrës është shumë i lartë dhe kurrë i kthyeshëm. Dëmi është i natyrës historike, kulturore, ekonomike, mjedisore, klimatike, gjeostrategjike e drejtime të tjera më të imta. Ndikimi i vërtetë do të duhet kohë të dihet, mirëkuptohet e provohet kohë pas kohe në të ardhmen. Duket një çudi e shkallës së pabesueshme, se si mund të ndërtohet një digë kaq e lartë që grumbullon një sasi shumë të madhe uji, në një zonë me potencë të një shkalle kaq të lartë lëkundjesh tektonike e tërmetesh me fuqi shkatërruese. Kush janë ata studiues e projektorë që i lëshuan hi', me një mendjelehtësi e mungesë përgjegjësie të pashpjegueshme mendimit shkencore të kolosëve të tillë si Profesor P. Radovicka, e të tjerë?

Ndërsa armët me fuqi të madhe vrasëse e dëmtimit masiv sofistikohen dita ditës dhe madhësia fizike nuk është trend i të ardhmes së tyre, ndryshe po ndodh me këtë mega projekt, vrasësin Skavica! Ajo është planizuar e projektuar të jetë gjigante se dhe detyra e saj është të dëmtojë rëndë jo vetëm qëniet humane, po më shumë, kodër, mal, fushën disa mijëra hektarëshe të Dibrës prodhuese, mijëra banesa e ndërtime publike, shumë rrugë, ura, qindra e qindra investime të fermerëve të tregut, ku është mundur të vihen në jetë kapitale të shtrenjta dhe të akumulara më shumë shpirt, djersë e kohë të cilat sa kanë filluar të kthejnë fitimet e veta. Kjo gjendje zbulon dhe një pabesi e mënyrë gati diktatoriale qeverisje. Me një studim të plotë dhe transparent kjo katastrofë mbi investimet shume largpamëse, punë e djerse do të ishte parandaluar e kursyer për tjetërkund. Mjafton të përmendim vetëm themelin bujqësor, që kjo digë e varros përjetësisht: Fusha e Draj dhe Zall-Reçit, Fusha e Zalldardhës dhe e Lugjej-Topuze, si dhe tokën më të mirë në të dy anët që nga rrjedhja e mesme e deri në Dri e Veleshicës, Ranat e Mustafe e Kodër-Leshe, gjithë Fushë-Alia, Laçes, tokat më jetëdhënëse të Blliçes, Fusha e Kastriotit (Torviolli i famshëm), Zbineci i përmendur, Fusha e Kandrit, zemra e veshka e tokës bujqësore të Dibrës- Fusha e Vakufit e Rreth Kale, dhe më kryesorja hambari-Fusha e Brezhdanit, Ushtelenxës dhe Çetushit.

Në krahun e majtë të rrjedhjes së Drinit, vazhdohet me varrosjen e tokave më prodhuese të Kodër-Leshe e Arrasit, Zallin e Sinës të përmendur, tokat me jetëdhënëse te Vajmëdhenjtë, Fusha prodhuese e Muhurit, Fusha e Katundit të Ri (Myzeqeja e Vogël e Dibrës) tokat më të mira të Hoteshit, Selane-Dohoshishtit, Fusha e Gradecit, Boçevës, Vojnikës, Podgorcës, Allabegisë, Spasit, Reshanit, Fusha e Dibrës së Madhe buzë Drinit, një pjesë të fushës së Shupenzës e Fushën më pjellore të Dibrës Gjoricës, shumë toka pjellore të Grykës së Drinit përtej Kufirit Politik me Maqedoninë e Veriut, e tjerë e tjerë. Duhen bërë evidentime e përllogaritje në norma e koeficiente ekonomike e shkencore (si ekonomisti Dali Horeshka ndërmori të bëjë kohët e fundit), për mijëra ha tokë bujqësore, tokë me frutikulturë e për frutikulturë, pyje-kullotash, nga ekspertë që e njohin mirë e shkencërisht vendin ku jetojnë, punojnë e paguhen. Është po kaq e rëndë tronditja e pariparueshme e jetës së mijëra familjeve e banorëve dibranë, që shkulen përdhunisht nga trojet e tyre shekullore. Janë shumë fshatra që fshihen nga faqja e dheut e historisë demografike të Dibrës. Një ndër to e totalisht dhe fshati Katund i Ri, vendlindja dhe vendbanimi i familjes e fisit të autorit të këtij shkrimi, argumenti e proteste.

Është koha më e duhur për t'i dalë zot, vendit të tyre me argumente sa më shkencore, për ta ndalur këtë ndërmarrje para-funerale të Dibrës. Kjo mbrojtje duhet të bëhet nga të gjithë, si përgjegjësi e tyre për Dibrën që duan, nga specialistët dhe ekspertët e të gjitha fushave të zhvillimit. Zërat e parë të prof. Adem Bungurit, Murat Koltrakës, Mustafa Tolës, ambientialistit të shquar Xhemal Mato, gazetarëve Abdurahim Ashiku e Bujar Karoshi, i të ndjerit Haki Kola, që tani janë bërë shumë, duhet të shtohen më shumë e shumë të tjerë. Pasi duket nuk qenë e janë mjaft vetëm të mësipërmet, si argumente të bollshme e shumë bindëse. Qeveritë autokrate, dritë shkurtra, oligarke e të korruptuara është shumë zor të munden në pangopësinë e tyre! Nuk është nxjerrë mësim vallë nga dështimi me Sopanikën Çidhnake?

U zgjata pak për të provuar, se është shumë e vërtetë, thënia qarkulluese kudo, që me Skavicën e për shkak të saj, nuk ka më Dibër.

(Vijon në faqen 6)

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë. Komentet ose opinionet tuaja botohen bazuar mbi lirinë e gjithësecilit, pa qëllim fyerje apo denigrim të individëve apo grupeve të ndryshme shoqërore dhe politike. Për të botuar opinionin/komentin tuaj mund të na shkruani në <rrugaearberit@gmail.com>

debat



Tri arsye pse jam kundër ndërtimit të HEC Skavica

Megjithëse rajoni i Dibrës ka ende një potencial të madh për hidrocentrale të pashfrytëzuara, është e nevojshme të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i situatës, duke marrë parasysh kostot dhe përfitimet në krahasim me opsionet e tjera të energjisë. Qeveria duhet të ulet në një tryezë të rrumbullakët me të gjithë palët e interesuara, edhe dibranët, identiteti, historia, kultura dhe shtëpitë e trojet e të cilëve rrezikohen të zhduken përgjithmonë. Të gjithë palët e interesuara duhet të vendosin nëse ia vlen të vazhdohet të investohet në hidrocentrale, apo nëse është më mirë të zgjedhësh lloje të tjera të energjisë – duke shmangur kështu ndikimet sociale, mjedisore dhe financiare që vijnë nga digat e mëdha.

Nga **FERZILETA GJIKA***

New York, 4 nëntor 2021 - Gjatë viteve të fundit, rezistenca e komunitetit dibran ndaj ndërtimit të digës së madhe të Skavicës, është intensifikuar dhe është bërë gjithnjë e me e koordinuar. Në disa rajone, si në Fushe-Alie, Luzni, Kastriot etj., rezistenca lokale është bërë më e organizuar dhe më efektive. Në fakt, forcimi i lidhjeve ndërlokale kontribuon në shpërndarjen e informacionit dhe burimeve njerëzore dhe materiale për të mbrojtur të drejtat e popullit dibran, me të drejta të plota të banorëve vendas.

Unë jam lindur dhe rritur në fshatin Fushë-Alie. Vendlindja ime rrezikohet të mbulohet me ujë nga hidrocentrali i Skavicës. Bashkë me to zhduken varret e të parëve tanë, kultura, historia dibrane dhe kombëtare , dinjiteti, tradita dhe e drejta humane për të pasur tokën dhe shtëpinë që ne trashëgojmë. Sot i bashkohem thirrjes "Po Dibra, Jo Skavica", e cila është kundër ndërtimit të HEC Skavica dhe që do të jetë hidrocentrali më i madh, jo vetëm në Shqipëri por një nga hidrocentralet më të mëdha në Europë.

Ndërkohë që SHBA ka ndaluar me ligj ndërtimin e hidrocentraleve të mëdha, siç është ai i Skavicës, dhe shteti federal merret vetëm me mirëmbajten e hidrocentraleve ekzistuese, është e pakuptueshme se si është përfshirë një kompanie amerikane në ndërtimin e HEC Skavica. Gjithashtu, ndërsa Komisioni Europian, përmes Kornizës së Investimeve në Ballkanit Perëndimor (WBIF),është tërhequr nga financimi i hidrocentralit, Bashkimi Europian dhe organizmat e saj nuk po kërkojnë ruajtjen standardeve mjedisore në këtë rast, ngjashëm me rastin e Lumit Vjosa.

Cilat janë arsyet e ndërtimit të një hidrocentrali të madh në Shqipëri? A është kjo e vetmja rrugë për të siguruar energjinë elektrike në vend?

Energjia hidroelektrike ka qenë një burim i zhvillimit në shumë vende europiane dhe ende përfaqëson një pjesë të madhe të pjesës energjetike të rajonit. Por, a është kjo alternativa më e mirë për shqiptarët dhe aq më tepër për popullin e Dibrës?

Në përgjigje të vendimit të fundit të qeverisë shqiptare për të ndërtuar digën më të madhe në vend në rajonin e Dibrës, e njohur si diga e Skavicës, po shpjegoj se çfarë do të thotë të vazhdosh të nënshkruash kontrata ndërtimi për digat e mëdha në Shqipëri dhe konkretisht në Dibër.

Ajo që vijon janë tri arsye pse duhet t'u themi "jo" digave më të mëdha:

1. Sot ekzistojnë alternativa më të mira sesa ndërtimi i hidrocentralit të madh të Skavicës dhe duhet të merren parasysh në planifikimin e projektit.

Përpara se të zgjedhë një burim alternativ energjie, qeveria shqiptare duhet të hartojë një plan strategjik që analizon nevojat për energji dhe mënyrën më të mirë për t'i arritur ato. Në këtë analizë, duhet të merren parasysh të gjitha opsionet. Është shqetësuese që kjo nuk ndodh tashmë.

Për shembull, në rastin e digës së Skavicës, që mendohet të jetë më e madhja në Shqipëri dhe kështu sjell dëmtime serioze sociale dhe mjedisore, qeveria shqiptare ka vendosur të mos kryejë një vlerësim paraprak të alternativave. Edhe pse ligjet mjedisore ekzistojnë dhe vlerësimi është rekomanduar nga ekspertë të shkencës, gjeologjisë dhe mjedisit. Ky hidrocentral ka më shumë efekte negative sesa përfitime. Qeveria shqiptare nuk ka marrë parasysh asnjë nga këto rekomandime. Diskutime dhe analiza të mirëfillta janë një standard ndërkombëtar që institucionet e mëdha financiare duhet ta zbatojnë kur investojnë në projekte të këtij lloji.

Burimet e tjera të energjisë – që vijnë nga era dhe dielli - janë provuar të jenë ekonomikisht konkuruese, mund të ndërtohen më shpejt dhe nuk përkeqësojnë klimën në vend. Sasia e energjisë elektrike e prodhuar nga era është rritur me shpejtësi vitet e fundit, kjo falë avancimit të teknologjisë, e cila ka ndikuar në uljen e kostos së prodhimit të energjisë elektrike nga era. Në të njëjtën kohë, prodhimi i energjisë nga era është inkurajuar, pasi rrit përfitimet tatimore shtetërore dhe federale për zhvillimin e energjisë së rinovueshme në vend. Shumë kompani private sot ofrojnë opsione të "çmimeve të gjelbra" që u jep mundësi klientëve për të blerë energjinë nga burime të rinovueshme, siç është era. Turbinat me erë nuk ndikojnë në ndotjen e ajrit ose të ujit, sepse nuk digjet karburant për të prodhuar energji elektrike. Janë shqetësuese emetimet e gazit serë në atmosferë, që vjen nga gjenerimi i lëndëve djegëse fosile dhe rritja e emetimit të metanit si rrjedhojë e ndërtimit dhe ekzistencës së hidrocentraleve.

Energjia diellore që vë në përdorim panelet diellore, vjen nga qendra e diellit dhe çliron energji në formën e rrezeve diellore. Sipas studimeve shkencore, më shumë energji nga dielli bie në tokë në një orë sesa përdoret nga e gjithë bota në një vit. Teknologjia e përdorimit të paneleve diellor shndërrojnë rrezet e diellit në energji të përdorshme për konsumatorët. Procesi i shndërrimit të dritës (fotoneve) në energji elektrike (tension) quhet efekti PV, teknologji e cila përdor fotone të dritës diellore për të goditur silikonin gjysmëpërçues për të prodhuar energji elektrike. Shumë kompani të energjisë elektrike përdorin PV teknologji për të rritur fuqinë e prodhimit të energjisë elektrike. Sistemet e PV konsiderohen si mënyra më e mirë dhe eficente për prodhimin e energjisë së rinovueshme për shkak të disponueshmërisë së bollshme për një kohë të gjatë të energjisë diellore falas (si lëndë e parë) në sipërfaqen e tokës.

Inovacionet në fushën e teknologjisë, po përqendrohen në mënyre aktive për materialet që kanë një efikasitet të lartë në prodhimin dhe ruajtjen e energjisë, teknologji inverter për konvertimin efikas të rrymës direkte në rrymën alternative, si dhe teknologjinë e baterive për sistemet e ruajtjes së energjisë më sistem PV (panel diellor) në shkallë të gjerë. Promovimi i politikave të sistemit PV (panel diellor) nga qeveria shqiptare, inkurajojnë zhvillimin e tregjeve të PV me potencial të lartë.

Energjia gjeotermale e baticës dhe e valës janë alternativa, potencialin e të cilave as që e kemi parë.

Promovimi i digave të mëdha vetëm vonon miratimin e zgjidhjeve të vërteta të energjisë së pastër, për të cilat Shqipëria dhe planeti kanë nevojë në mënyre urgjente. Shqipëria ka sasinë më të madhe dhe burimet më të larmishme të energjisë së rinovueshme në Europë. Burimet e rinovueshme të rajonit mund të sigurojnë pothuajse shtatë herë kapacitetin e instaluar në Europë, duke përjashtuar energjinë hidroelektrike.

Megjithëse rajoni i Dibrës ka ende një potencial të madh për hidrocentrale të pashfrytëzuara, është e nevojshme të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i situatës, duke marrë parasysh kostot dhe përfitimet në krahasim me opsionet e tjera të energjisë. Qeveria duhet të ulet në një tryezë të rrumbullakët me të gjithë palët e interesuara, edhe dibranët, identiteti, historia, kultura dhe shtëpitë e trojet e të cilëve rrezikohen të zhduken përgjithmonë. Të gjithë palët e interesuara duhet të vendosin nëse ia vlen të vazhdohet të investohet në hidrocentrale, apo nëse është më mirë të zgjedhësh lloje të tjera të energjisë – duke shmangur kështu ndikimet sociale, mjedisore dhe financiare që vijnë nga digat e mëdha.

2. Digat e mëdha që shkaktojnë dëme sociale dhe mjedisore nuk janë fitimprurëse.

Digat hidroelektrike në shkallë të gjerë kanë pasur - gjatë gjithë historisë së tyre - ndikime negative në grupet e popullsisë vendase, burimet natyrore dhe ekosistemet e tëra, duke çuar më tej rezistencën dhe protestën kundër tyre. Debati mbi digat e mëdha ndërlikohet më tej në vendet si Shqipëria, ku digat e mëdha kërkohen të përdoren si simbole të fuqishme të krenarisë kombëtare dhe nderohen si dëshmi e përparimit të një kombi, apo përkushtimit ndaj modernizimit. Për mua, digat e mëdha janë struktura betoni dhe shkëmbore që prodhojnë energji elektrike duke ruajtur ujin, rrezikojnë fqinjët me përmbytje dhe zhvendosin apo zhdukin komunitetet apo vendbanuesit. Megjithëse qeveria e sheh ndërtimin e digës së madhe së Sakavicës si monument të përparimit, unë e shoh si monument të korrupsionit politik kombëtar e ndërkombëtar, si dhe të pabarazisë sociale.

Është demonstruar në mënyrë të përsëritur se ndikimet sociale dhe mjedisore të hidrocentraleve janë më të mëdha se sa u menduan fillimisht. Përveç zhvendosjes së detyruar të popullsisë dhe kriminalizimit të atyre që i kundërshtojnë, digat e mëdha përmbytin tokat, zvogëlojnë rrjedhat e lumenjve dhe ndryshojnë ekosistemet e rajoneve fqinje, duke shkatërruar habitatet dhe duke kontribuar në zhdukjen e specieve. E gjithë kjo ndikon në jetën ekonomike, sociale, klimatike dhe mjedisit të komunitetit të Dibrës dhe të komuniteteve përreth, duke kufizuar aftësinë e tyre për t'u përshtatur me ndryshimet klimatike, që vijnë si rrjedhojë e hidrocentralit të ndërtuar përbri.

Në aspektin ekonomik kostot aktuale të ndërtimit të digave të mëdha janë shumë të lartë për të dhëne një përfitim pozitiv. Buxhetet dhe afatet kohore të projekteve të mëdha të digave janë vazhdimisht të nënvlerësuara ose kanë një kosto të fshehur që nuk dihet. Mirëmbajta e digave të mëdha, po ashtu kërkon një investim trefish në krahasim me koston që e ndërton.

Duke pranuar se kostot janë shumë më të mëdha se përfitimet, shumë vende europiane kanë zgjedhur të çmontojnë diga të mëdha. Kompanitë private i kanë hequr tërësisht projektet hidroelektrike, sepse nuk janë as ekonomikisht të qëndrueshme dhe as fitimprurëse. Qeveria e Shteteve të Bashkuara ka miratuar një politikë për të refuzuar çdo hua, donacion, strategji ose politikë që mbështet ndërtimin e digave të mëdha. Shteti federal merret vetëm me mirëmbajten e digave ekzistuese.

Që nga viti 1990, në SHBA janë çmontuar mbi 1700 diga të mëdha. Sipas Komisionit Botëror rë Digave *(The World Commission on Dams)*** një digë quhet e madhe kur lartësia e saj është mbi 15 metra mbi themelin ose

(Vijon në faqen 6)

Rruga e Arbërit nr. 183

debat

Qeveria e Shteteve të Bashkuara ka miratuar një politikë për të refuzuar çdo hua, donacion, strategji ose politikë që mbështet ndërtimin e digave të mëdha. Shteti federal merret vetëm me mirëmbajten e digave ekzistuese. Që nga viti 1990, në SHBA janë çmontuar mbi 1700 diga të mëdha. Sipas Komisionit Botëror rë Digave (The World Commission on Dams), një digë quhet e madhe kur lartësia e saj është mbi 15 metra mbi themelin ose rezervuari i saj është më shumë se 3 milionë metër kub. Vetëm heqja e katër digave në lumin Klamath në Kaliforni do të kushtojë 450 milionë dollarë, afërsisht sa shuma që planifikohet të ndërtohet Skavica.

Tri arsye pse jam kundër ndërtimit të HEC Skavica

(Vijon nga faqja 5)

rezervuari i saj është më shumë se 3 milionë metër kub. Vetëm heqja e katër digave në lumin Klamath në Kaliforni do të kushtojë 450 milionë dollarë, afërsisht sa shuma që planifikohet të ndërtohet Skavica.

3. Digat e mëdha kontribuojnë në ndryshimet klimatike.

Ndryshimet klimatike duhet të merren parasysh kur diskutohet rëndësia e hidrocentralit. Rezervuarët gjenerojnë sasi të konsiderueshme (1.3% nga njerëzimi) të efektit serë, veçanërisht metanin, i cili është 30 herë më efektiv në kapjen e nxehtësisë sesa dioksidi i karbonit. Po kështu, ndërtimi i digave rrezikon shtime të vlefshme të sasisë së karbonit. Për këtë arsye, duhet të bëhet një analizë e duhur e emetimeve të dioksidit të karbonit dhe metanit, përpara se të zgjidhet një projekt dige - një proces që zakonisht nuk ndodh.

Një aspekt tjetër për t'u marrë parasysh është që ndërtimi i digave të mëdha kontribuon në ndryshime klimatike të pakthyera. Reshjet ekstreme rritin sedimentimin, i cili mund të shkaktojë probleme strukturore dhe të zvogëlojë jetëgjatësinë e digës. Thatësirat, tani gjithnjë e më të shpeshta, mund t'i bëjnë digat joefikase.

Akoma më serioze është kërcënimi i



Pamje nga protesta në Peshkopi. Foto: ***facebook/bulqizaime***

digave të mëdha në rastet e motit ekstrem. Ne duhet të rimendojmë se si do të trajtohen evakuimet masive kur shirat e dendur kërcënojnë një shembje dige dhe përmbytje të pashmangshme. Keqmenaxhimi i mundshëm i digave të mëdha, si diga e Skavicës, mund të shkaktojë përmbytje të paprecedentë. Për këtë arsye, ndërtimi i një dige të madhe si diga e Skavicës në Dibër, rrit rrezikun e tejmbushjes, shembjes së digës dhe duhet njohur si një problem serioz. Me kalimin e kohës, diga e madhe si Skavicës mund do të fillojë të përkeqësohet dhe do të kërkojë investime të mëdha për të mbrojtur komunitetet që jetojnë në rrjedhën e poshtme.

Shqiptarët në New York, kanë hartuar një peticion, ku bëjnë thirrje institucioneve financiare në Shqipëri të mbështesin ndryshimin që ne, si qark i Dibrës, kemi nevojë. Ne u bëjmë thirrje atyre të ndalojnë investimin në diga të mëdha, të cilat janë demonstruar herë pas here se janë të rrezikshme për mjedisin dhe komunitetet lokale, të kushtueshme për vendet dhe të papërshtatshme për klimën tonë, që po ndryshon me shpejtësi, si dhe një vend i paqëndrueshëm nga ana e tërmeteve sizmike.

Është koha për një plan më të mirë energjie. Dhe është koha për të investuar në energjinë e rinovueshme, jokonvencionale, bazuar në vlerësime të plota, të pavarura dhe me cilësi të lartë të ndikimit social dhe mjedisor, planifikimi dhe zbatimi i të cilave respekton të drejtat e njeriut.

** Autorja është kandidate për doktore të shkencave në Graduate Center City University of New York. Aktualisht ajo mban titullin Adjunct Assistant Professor pranë CUNY (Universiteti i qytetit të New York).*

***"Dams and Development: A New Framework for Decision-Making," World Commission on Dams (November 2000)).*

(Vijon nga faqja 4)

DEBAT

Skavica vret, nuk kuron

Shqipëria e sotme është e madhësisë së Izraelit. Si mund të guxojmë të sillemi me tokën kaq të pakët bujqësore për frymë kështu!? Ndërsa në Izrael punohet me shkencë e thonj që shkretëtirën e Negevit ta kthejnë pëllëmbë pas pëllëmbe në tokë të kultivuar e prodhuese bujqësore. Në anën tjetër ky vend modern qëndron në ballin e botës, për sjelljen shkencore ndaj pasurisë kapitale jetëdhënë, ujit. Po kështu dhe për industrinë e gjithë infrastrukturën moderne të sistemeve ujitës e të vet ujitjes së bimëve. Le të lejmë pak mënjane rrahagjoksin për shpëtimin e hebrenjve, për të cilën kam dhënë dhe personalisht kontribut 27 vjet më parë. Kjo meritë e rrallë dhe e shquar ka zënë vend, si dhunti-lavdi historike e mikpritjes e besës shqiptare. Është koha të mësojmë nga përvoja e këtij shteti të Ri e modern për të zhvilluar vendin me gjithë resurse falë Zotit, vetëm në trendin shkencor me vepra dhe për çdo ditë.

Diga e Skavicës nuk duhet të ndërtohet sepse shkatërron shumë më shumë se përfitimet që sjell ngritja e saj.

Në protestën e 4 nëntorit 2021 të komunitetit dibran e më gjerë në Sheshin e lirisë, demokracisë e protestës, që mban emrin e norvegjezit të shquar Dag Hammarskjold, fare afër Pallatit të Qelqtë të Kombeve të Bashkuara në New York, u soll dhe një fakt i ri e argument bazik, që e kundërshton ndërtimin e HEC e Digën e Skavicës, si e jashtë kohe. Kandidatja për Dr. Shkencash në City University të Neë York-ut, Ferzileta Gjika, bijë e Fushë-Alies, pruri në vëmendje se, The World Commission on Dams (për digat), ka vendosur që të ndalohet ndërtimi i digave mbi 15 m të larta dhe kur ujëmbledhësi i tyre grumbullon më shumë se 3 milion metër kub ujë. Shteti Federal Amerikan për më tepër, që nga viti 1990 ka çmontuar mbi 1700 Diga të mëdha. Ndërkohë që Komisioni Europian përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) ka vendosur tërheqjen nga investimi për Skavicën. Çdo lloj vepre me përmasa mbi ato tregues i grupon në Diga të mëdha dhe nuk rekomandon ndërtimin e tyre. Pse kanë një impakt negativ e jo të pranueshëm në një mënyrë shumë komplekse në mjedis, në klimë, efektin serë, për rrezikun në shtimin e sasisë së karbonit dhe pasiguri të tjera të të ardhmes. Mbi këtë bazë njohje të çudit fakti, se si kompania amerikane Bechtel është bërë pjesë e kësaj sipërmarrje me dëm, kësisoj, shumë të madh. Nuk duam të besojmë, se është vënë në plan të parë apo është bërë pis në afera korruptive, siç qeveria "Rama" është bërë sot me fakte, e pabesueshme. Akoma nuk është shuar e larguar, flaka si atomike, as tymi e mjegulla e Gërdecit, klithshëm përgjakës dhe i padënuar, që la pas një bashkëpunim tjetër, jo i studiuar thellë gjithëanshmërisht.

Nuk është më një zbulim i ri, se për prodhimin e energjisë elektrike ekzistojnë e po shfrytëzohen prej kohësh burime shumë frutdhënëse alternative, më të dobishme e të pastra ekologjikisht, si energjia e fituar nga fuqia e erës dhe e diellit. Pikërisht aty ku mendohet të ngrihet një mal hekur-betoni në Skavicë, në opinionin tonë fillon një brez vertikal gjeografik-tokësor, Qafë-Draj-Baruc-Suka e Kalisit- Fushë e madhe (Kala e Dodës) për instalim-ndërtim pilotash, për fitim energji nga korenti i përhershëm gjithë vjetor i rrymës së erërave. Është tanimë një doktrinë e plotë shkencore e provuar në praktikën e gjerë botërore, se kjo alternative burimi energjie elektrike rezulton më efektive se çdo lloj tjetër burimi. Pa shkuar më tej e folur mbi argumentet që mbështesin prodhimin bërthamor të energjisë. Sa për dijeni, energjia elektrike në SHBA prodhohet nga burimet si vijon: 40% e saj nga gaz natyral, 19% nga qymyri, 20% nukleare, 20% nga burime të rinovueshme (prej saj 13% nga burime jo hidrike dhe vetëm 7% nga burime hidrike), ndërsa 1% nga burime të tjera.

Na gëzon fakti se lumi Vjosa dhe pellgu ujëmbledhës i saj, po fiton dita ditës një mbrojtje të lartë nga shteti shqiptar dhe deri opinioni mjedisor e artistik hollivudian. Është vlerë e pallogaritshme për vendin e popullin. Po a nuk të lind e drejta shumë më tepër se morale të pyesësh: Çfarë është kjo sjellje kaq e papërgjegjshme, për të mos i vënë emër tjetër me Drinin dhe luginën e tij, popullin që e banon, pasurinë ekonomike, historike, ekologjike, turistike të saj, e cila planifikohet të kryqezohet e varroset kështu? E admirojnë dhe luginen e Drinit hollivudiane të tjerë si Leonardo Di Capri (kemi një nderim të madh për to), Vjosën. Ç'është kjo sjellje me dy standarde? A nuk i ka dhënë akoma mjaft Drini Shqipërisë, saqë i gjithi ky lum po kthehet në liqen, e bashkëjetuesit e përjetshëm të tij, një herë Kukësi e tash dhe Dibra duhet të kthehen në muhaxhirë me përdhunë "demokratike"? Është vendlindja e Heroit Kombëtar dhe treva ku u zhvilluan 19 nga 26 betejat famëmedha të Gjergj Kastriotit në krye të dibranëve e shqiptarëve në mbrojtje të trojeve arbërore. Rezultatet dhe lavdia e tyre vunë dhe kufirin perëndimor të Perandorisë Obskurantiste Osmane të Lindjes. Planifikohet të përmbytet një nga rajonet më të pasura me site arkeologjike të historisë së Dibrës e Kombit. Ky projekt i padrejtë e antinjerëzor mund të varrosë përjetësisht qindra e qindra mijë varre dibranësh, dibranesh, që me kaq shumë sakrificë e kanë mbajtur shqiptare këtë tokë. Mjafton të përmendim epopenë e kryengritjen e dibranëve, që e mbuluan me gjak këtë tokë të shtrenjtë më 1913-tën, kur ato me një vetmohim të pashoq mundën ushtrinë serbe shumë herë më të shumtë në numër e armatim. Aty në Shumbat ra dhe dibrani Osman Paci me gjoks mbi mitrolozin shfarosës serb.

Ka dhe një "argument", që me gjysmë goje përmendet na favor të varrosjes së jetës së Dibrës. Shpëtonka nga përmbytja e herë pas hershme Fusha e Shkodrës! Është një hipoteze që nuk qëndron, zotërinj qeveritarë të vendit e ju o popull fisnik e mbretëror i Shkodrës. Dibranët, si askush, luftuan krah jush e shqiptarëve kudo, që populli heroik i Shkodrës dhe trojet e tyre shekullore të mos mbeteshin nën pushtetin e sundimin sllavo-malazes. Dibranët kanë varret e tyre në trojet shkodrane, ashtu si dhe një grup luznakësh me trimin dhe luftetarin si ai, Xheladin Seferin.

Qeveria Rama dhe çdo tjetër, edhe ju znj. ambasadore J. Kim, duhet të jeni dhe zëri mbrojtës i shumë mijëra dibranëve shqiptaro-amerikanë të Amerikës, pronave dhe varreve të tyre dhe vet Dibrës, pjesë e rëndësishme e Kombit shqiptar, që Sakavice-Diga të mos ngrihet, po dhe Shkodra të mbrohet e Dibra të mos shuhet. Të dyja i kanë dhënë kaq shumë Shqipërisë e Kombit dhe meritojnë po kaq shumë.

Ndihmojeni Shkodrën, me ndihmën shkencore, mundësisht dhe financiare me kthim të Hollandës mike, botërisht të njohur në këtë fushe, tani së fundi mike dhe e kryeministrit Rama e kandidatit për të tillë Basha. Fusha e Shkodrës mund të mbahet e kulluar e të mbrohet nga ujërat e tepërta, po pa e varrosur Dibrën. Një punë që ju lë kryelartë e të mirëpërmendur në histori. Qofte dhe diktatura e varfër dhe e izoluar nga bota e zhvilluar, pati mundur ta beje atë mjaftueshëm, po dhe duke mbrojtur Dibrën dhe dibranët nga gjëma që i rrezikon sot.

Ju deputetet: Lulzim Basha, Ulsi Manja, Lavdrim Krrashi, Xhelal Mëziu duhet ta udhëhiqni Parlamentin shqiptar, se e keni detyrë, e keni mundësinë të të jeni zëri mbrojtes i Dibrës dhe dibraneve, shpëtues të tyre. Ose nënshtrojuni qeverisë "Rama" për një projekt që dëmton më shumë se vetëm Dibrën?

Të gjithë ju udhëheqësit vendorë, bashkë me gjithë dibranët që dëmtohen drejtëpërdrejtë ose jo, vëllazërisht e jashtë politikës, qëndroni bashkë e shpëtojeni Dibrën, gjakun e të parëve, pronën, tokën dibrane, historinë e varret tuaja. Hidheni këtë hap të madh në kohë paqeje për veten tuaj, të fëmijëve e brezave pa mbarim, që do të na zëvendësojnë. Jepnii një mësim Qeverisë, se me popullin tënd, në demokraci nuk mund të sillesh si me skllevërit.

Kjo vepër do të jetë hiç me pak se e barasvlefshme me atë të gjyshërve tanë që u ngritën për të vdekur me 1913 dhe fituan atë që ndryshe, mund të vritet e varroset sot. Përgjithmonë.

** Ish-drejtor i Bujqësisë dhe Ushqimit të Dibrës.*
New York, 15 nëntor 2021

Një digë e vetme e madhe, është një katastrofë e paripareshme



Gjithmonë jam udhëhequr nga parimi se një gjë që nuk e do populli, është vështirë të bëhet. Dhe është më mirë të mos bëhet.

Një dige të vetme e madhe, për mua, është një katastrofë e pa riparueshme në jetë të jetëve. "Qeveria, Vjosën po e ruan, ndërsa Dibrën (Drinin) po e rruan", ishte komenti që bëra para disa ditësh tek një portal që lavdëronte "Vjosën e Egër" dhe e konsideronte fitore mosndërtmin e H/C-ve në të.

Me llogari të përafërta mendoj se kushton disa herë më tepër pasuria që dëmtohet se vlera e ndërtimit të H/C-it. Për dëmet e tjera që shkaktohen në fushat e arkeologjisë, historisë, mjedisit, sigurisë kombëtare etj. etj, nuk po ndalem pasi ato i kanë trajtuar në detaje kolegët e nderuar.

I nderuar z. Ashiku, duke ju falënderuar për rolin që po luani si një katalizator për ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e popullatës, në atë që besoni dhe mendoni se është më e mira për Dibrën dhe dibranët, në lidhje me H/C-in në fjalë... vlerësoj angazhimin tuaj fisnik, si dhe të prof. Bungurit e shumë të tjerëve.

* * *

Përshëndetje Vesel!

Unë në vitin 1989 kam bërë një shkrim për mineralet jo metalorë të Dibrës, shkrim ku ministri i atëhershëm i ndërtimit u detyrua të dalë në TVSH me një pllakë mermeri në dorë e të flasë.

Do të desha që si specialist të më përshkruaje se cilët minerale jo metalorë dhe metalorë mbyten në luginën e Drinit dhe e humbin mundësinë të zgjohen ndonjëherë.

Faleminderit!

* * *

Përshëndetje i respektuar z. Abdurahim Ashiku!

Së pari, ndjesë për vonesën.

Sa më kërkuat, po ju përgjigjem më poshtë:

Siç edhe mund ta dini, unë jam në përfundim të librit tim shkencor, "Gjeologjia dhe Mineralet e Dibrës", ku brenda librit ka dhe një kapitull të gjatë për "Rrezikun Gjeologjik të Dibrës", rrezik i cili lidhet, edhe me problematikën e ndërtimit të kësaj vepre, që është bërë këto kohë tema e ditës për dibranët.

* * *

Ju e dini tashmë se unë jam shprehur publikisht në shtyp rreth ndërtimit ose jo të ***H/C të Skavicës***, të cilin ne e quajmë **H/C i Tejdrines**, për një arsye të thjeshtë. Vendi ku ne propozonim digën nuk ndodhet aty ku janë bërë studime gati 50 vjeçare në kohën e monizmit, pra në Skavicë, por 2 km më poshtë sipas rrjedhjes së lumit, në Tejdrine, aty ku Përroi i Tushes takohet me lumin e Drinit të Zi, dhe jo me digë që sjellë kuotë përmbytëse 443 m mbi nivelin e detit, por me digë që sjellë një liqen, pasqyra e të cilit do ishte 367 m mbi nivelin e detit. Kjo për shumë arsye, pasi diga në Skavicë duhet të ndërtohet në formacione karbonatike dhe rreshpore të cilat, sipas nesh, kanë probleme jo të vogla ***tektonike dhe të Karstit***, si

> Skavica me një digë të madhe, ka për të dal në rendin e ditës për tu ndërtuar nga qeveritë Shqiptare, në bashkëpunim me firma të huaja apo vendase, ndaj e mendoja variantin me disa diga të vogla (dy ose tre), si kundërvënie të studimeve "efiçente", që ngulmojnë në ndërtimin e një dige të vetme e të madhe, që për mua, është një katastrofë e pa riparueshme në jetë të jetëve. "Qeveria, Vjosën po e ruan, ndërsa Dibrën (Drinin) po e rruan".

përcaktuese të sigurisë së digës. Për këtë digë të vogël, që nuk do përmbyste as Fushë Alien, kemi bërë një studim bashkë me një koleg timin, profesor i shquar i Gjeologjisë Shqiptare, në lidhje me sigurinë tektonike të pellgut ujëmbajtës të rajonit të rezervuarit dhe të digës së Tejdrines (Skavicës).

Studimi është kryer me kërkesën e një firme të huaj, e cila na kërkoj sigurinë e pellgut ujëmbajtës të liqenit të ardhshëm me kuotë më të lartë së **367 m** të pasqyrës së liqenit të ardhshëm, apo të ***"Hurdhës së Skavicës"*** siç Ju e keni emërtuar, konkretisht për kuotën **380 m** mbi nivelin e detit, gjë që ne nuk e pranuam, dhe këtu u ndërprenë marrëdhëniet me firmën në fjalë.

Unë jam i ndërgjegjshëm se edhe për kuotën 367 m (digë me 67 m lartësi) kemi patur mjaft kundërshtarë, duke filluar me ju z. Ashiku, vëllain tim Munir Hoxha, profesorin e mirënjohur Adem Bunguri dhe, sa e sa të tjerë. Këto kundërshtime i kam konsideruar normale dhe si një debat frutdhënës në dobi të gjetjes së më të mirës dhe, më të dobishmes. Gjithmonë jam udhëhequr nga parimi se një gjë që nuk e do populli, është vështirë të bëhet. ***Dhe është më mirë të mos bëhet.***

Midis të tjerave, unë kam shkruar se herët apo vonë, ***Skavica me një digë të madhe***, ka për të dal në rendin e ditës për tu ndërtuar nga qeveritë Shqiptare, në bashkëpunim me firma të huaja apo vendase, ndaj e mendoja variantin me disa diga të vogla (***dy ose tre***), për të cilat ju jeni në dijeni, si kundërvënie të studimeve "***efiçente***", që ngulmojnë në ndërtimin e një dige të vetme e të madhe, që për mua, është ***një katastrofë e pa riparueshme në jetë të jetëve.*** "***Qeveria, Vjosën po e ruan, ndërsa Dibrën (Drinin) po e rruan***", ishte komenti që bëra para disa ditësh tek një portal që lavdëronte ***"Vjosën e Egër"*** dhe e konsideronte fitore mosndërtmin e H/C-ve në të.

A ka specialist që e garantojnë një digë me kuotë mbi 367 m? Këtë nuk e di, por di se gjatë 50 viteve janë bërë shumë studime komplekse gjeologjike për Skavicën, si shtetërore ashtu dhe nga kompani private vendase dhe të huaja. Në mendje të ndryshme, ka mendime të ndryshme rreth problemeve të mprehta të trajtimit gjeologo-tektonik të rajonit në fjalë, i cili kërkon studime mjaft të detajuara dhe me mjaft përgjegjësi. Unë mendoj se e njoh gjeologjinë e rajonit në fjalë, ndaj jam habitur shumë, kur e kam dëgjuar kuotën **443 m** mbi nivelin e detit (kuptohet të pasqyrës së liqenit të ardhshëm), ***tek ligjëronte aso kohe drejtori Bened Beci***, me një gëzim që i lexohej në fytyrë, pa folur këtu ***për shokimin*** që pësova kur kam dëgjuar në një studio televizive, disa vite më parë, për kuotën **485 m**, nga goja e një specialisti të moshuar me emrin Luigj Pjetri, i cili fliste me pasion aq të madh, a thua se H/C-i do të ndërtohej në trojet e veta dhe do të përmbyste vetëm tokat e veta! Dua të theksoj kushtin që vendosëm për kuotën që ne propozuam. Nëse nuk janë dakord banorët e pellgut që përmbyten të mos ndërtohet hidrocentrali, plus të kërkohej edhe dakordësia e banorëve në buzë të liqenit të ardhshëm, të cilëve do ju ndryshoj mënyra e jetesës nga ndryshimet e gjithanshme që shkakton vepra në fjalë, edhe nëse studimet mjedisore do ti jepnin dritën jeshile. Dua të nënvizoj faktin që sot në botë digat e larta nuk janë të rekomandueshme.

***

Tani të futemi në temë. Gjeologjia është një shkencë dinamike. Gjërat nuk mund të thuhen një herë e përgjithmonë. Pellgu i kuotës 443 m, nuk përmban pasuri minerale metalore të zbuluara, por nuk përjashtohet se studimet në të ardhmen do të zbulojnë gjëra që sot na duken si të pa mundura. Në nivelin e sotëm të njohjes në pellgun që synohet të përmbytet me ndërtimin e digës **143 m** të lartë, duke e konsideruar kuotën e lumit në vendin e ndërtimit rrotull shifrës **300 m** mbi nivelin e detit, dhe pasqyrën e liqenit të ardhshëm **443 m**, mund të flitet për shenja të dokumentuara të ***mineralizimeve të Vanadit*** në formimet e vjetra paleozoike të cilat përhapen gjerësisht në rajonin që po flasim. Po ashtu nuk mungojnë dhe mendimet për mundësinë e takimit ***të mineralizimeve silikato-okside të hekurit*** në rajonin e Muhurrit, në thellësi mbi 100 m. Nga mineralizimet jo metalore bëhet fjalë për disa ***vendburime të Argjilave apo objekte Gëlqerorësh të Mermerizuar*** por që, nuk janë në shfrytëzim. Sigurisht në rajonin në fjalë ka edhe studime që flasin dhe ***për mundësitë e Naftë e Gazmbajtjes*** në strukturat gjeologjike në thellësi mbi 2500 m. Për mineralizime të tjera nuk e shikoj të arsyeshme të zgjatem.

Tani kam dhe një koment të fundit. Ata që kanë shpallur ndërtimin e Skavicës a i kanë bërë llogaritë me "***hanxhiun apo pa hanxhiun***"? Për kuotën që ato propozojnë me shumë pompozitet, **443 m** mbi nivelin e detit të pasqyrës së liqenit të ardhshëm, a kanë bërë ndonjë studim, veç atyre shkencore për sigurinë dhe aftësinë mbajtëse të pellgut dhe digës në lartësinë e propozuar?

Bie fjala, a kanë bërë studime të detajuara se sa tokë arë përmbytet, sa livadhe, sa kullota, sa pemëtore, sa pyje, sa shtëpi e bahçe, sa varre, sa shkolla e qendra administrative, sa bagëti, sa biznese, sa km rrugë, sa ura, sa linja të tensionit të ulët dhe të lartë, etj. etj. Sa rrugë të reja duhen bërë, sa ura dhe linja tensioni për tu përshtatur me realitetin e ri, ku do të zhvendoset popullata, etj. etj. ***Thembra e Akilit janë çmimet, sidomos për trojet dhe tokat bujqësore***. Me llogari të përafërta mendoj se kushton disa herë më tepër pasuria që dëmtohet se vlera e ndërtimit të H/C-it. Për dëmet e tjera që shkaktohen në fushat e arkeologjisë, historisë, mjedisit, sigurisë kombëtare etj. etj, nuk po ndalem pasi ato i kanë trajtuar në detaje kolegët e nderuar.

Dua ta mbyllë përgjigjen time, ***i nderuar z. Ashiku***, duke ju falënderuar për rolin që po luani si një katalizator për ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e popullatës, në atë që besoni dhe mendoni se është më e mira për Dibrën dhe dibranët, në lidhje me H/C-in në fjalë. Edhe pse unë kam shkruar për ndërtimin e H/C-ve të vegjël (*në pajtueshmëri e marrëveshje të plotë me pronarët e trojeve dhe studimet shkencore, ku në variantet e paraqitura nuk përmbyten as 8 % e tokës bujqësore dhe shumë pak shtëpi banimi*), ***vlerësoj angazhimin tuaj fisnik, si dhe të prof. Bungurit e shumë të tjerëve***, duke mos qenë kundërshtar i mendimeve më të avancuara se ato të miat, të cilat mund të shohin të ardhmen e Dibrës, ***më larg e më mirë se sa unë.***

Prof. asoc. dr. Vesel HOXHA

Tiranë, më 12 nëntor 2021

Rruga e Arbërit nr. 183

vëzhgim

E lënë në harresë nga të gjitha pushtetet, rruga ka izoluar krejtësisht banorët e Martaneshit.

Qafë Buall-Krastë, *16 km e* **"rrugës së vdekjes"**, *që po izolojnë Martaneshin*

E zhytur në pasuri natyrore krahina e Martaneshit ka ngelur peng i një rruge të gjatë prej 16.7 km. Njësia vendore akuzon firmën, që merret me mirëmbajtjen, se nuk bën as 10% të punimeve, duke e kthyer në një "rrugë vdekjeje", ndërsa ARRSh thotë se kjo është e vetmja formë mirëmbajtjeje. Bizneset e kësaj zone derdhin në arkën e shtetit dhe atë të bashkisë rreth 4.5 milionë dollarë në vit taksë dhe rentë minerare, por institucionet deklarojnë se nuk kanë lekë për rehabilitimin e saj.

***Nga* ARJETA CUKA**



Rruga Qafë Buall-Krastë

Anila Kunxhiu është në muajin e katërt të shtatzënisë, por çdo muaj udhëton drejt Tiranës për të bërë kontrollet rutinë. Në qytetin e Krastës, ku ajo jeton, nuk ka as gjinekolog dhe as spital për të ndjekur shtatzëninë, përveç një qendre shëndetësore.

E reja rrëfen për *Investigative Network Albania* se e kap paniku, sa herë duhet të udhëtojë drejt Tiranës, për shkak të gjendjes së mjerueshme të rrugës nga Krasta në Qafë Buall.

"Rruga është ankthi im i vazhdueshëm. Kam frikë se goditjet që merr mjeti nga gropat mund të më rrezikojnë fëmijën dhe akoma më shumë kam frikë, nëse, kur të vijë momenti i lindjes, mund të bllokohet rruga nga dëbora", - rrëfen e reja. Në këtë situatë ajo ka planifikuar që muajin e fundit të shtatzënisë ta kalojë te disa të afërm në Tiranë, ashtu siç bëri, edhe kur lindi fëmijën e parë.

Vetëm 16.7 km e gjatë, rruga Krastë-Qafë Buall, në afërsi të Bulqizës, është kthyer në makthin e banorëve të qytezës së vogël të Krastës. E hapur në vitet `80, atëherë kur industria e nxjerrjes së kromit e ktheu Krastën në një qytet, ku gëlonte jeta, mbi këtë rrugë nuk është vënë dorë që prej 40 vitesh. Si pasojë ajo është krejtësisht e amortizuar, me rrëshqitje dherash, gropa të mëdha, duke u kthyer në rrezik serioz për ata që kalojnë në këtë rrugë. Dhjetëra lapidarë që ndodhen përgjatë gjithë gjatësisë së këtij aksi rrugor, dëshmojnë se Qafë Buall-Krastë është kthyer në një "rrugë vdekjeje".

E lënë në harresë nga të gjitha pushtetet, rruga ka izoluar krejtësisht banorët e Martaneshit. Për shkak të amortizimit, një drejtuesi automjeti i duhen së paku 60 minuta për t`i përshkuar 16.7 km e kësaj rruge. E kur vjen puna te pacientët, çdo minutë është e çmuar.

"Transporti i një gruaje shtatzënë është vërtetë me rrisk, - thotë për *Investigative Network Albania* Vjollca Kuka, mami në qendrën shëndetësore të Krastës. - Rruga është e shkatërruar dhe duhen më shumë se 2 orë për ta dërguar pacienten në sallën më të afërt për lindje. Rrezikon të lindë në rrugë e, nëse ka komplikacione, atëherë jeta e nënës dhe e fëmijës është vërtet në rrezik", - përfundon ajo.

"Kemi pasur raste urgjencash dhe unë mund t'ju them se pa rrugë nuk mund të realizohet asgjë. Edhe pse me ambulancë e me staf te koka, ka pasur raste, kur jeta e pacientëve na është rrezikuar seriozisht për shkak të rrugës, shto këtu që rruga është gjithë gropa dhe nuk siguron një transport të qetë për një të sëmurë. Për ne mbetet *thembra e Akilit*", - pranon Bashkim Isaku, mjek në Krastë.

TË IZOLOHESH NGA RRUGA

Për shkak të braktisjes totale, Martaneshi është rrudhur në 2.500 banorë që çdo shërbim, përfshirë atë spitalor, duhet të zbresin ta marrin në qytetin e Bulqizës, njësi e cila e administron.

Banorët e thonë me bindje se rruga, jo vetëm po i izolon, por madje po pengon një zonë të madhe si ajo e Martaneshit nga e drejta për t'u zhvilluar dhe jetuar.

Kujtim Bala, shofer i licencuar për transportin e udhëtarëve nga Tirana në Krastë, rrëfen se për të aksi Qafë Buall-Krastë është më i vështiri.

"Kjo nuk mund të quhet rrugë, është krejtësisht e amortizuar. Në dimër situata është vërtet e frikshme, sepse edhe ngrin. Ka pasur plot raste, kur makinat edhe kanë dalë nga rruga... Gropat mbushen me dhé, në verë na mbyt pluhuri, në dimër bëhen shkak për spostim të makinave", - rrëfen ai.

Rruga Qafë Buall-Krastë është rikonstruktuar pjesërisht vetëm një herë në këto 30 vjet. Në vitin 2005 u niveluan dhe u asfaltuan 1.5 km rrugë me kosto 2.25 milionë lekë. Në këto kushte, ky aks rrugor është përfshirë në kontratë mirëmbajtjeje për 30 vjet.

Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër i bën me dije *Investigative Network Albania*-s se aktualisht ky aks rrugor mirëmbahet nga kompania "Udha" sh.p.k., me administrator Arben Çelën, kompani së cilës i janë besuar shumë rrugë të tjera në zonën e Matit dhe të Dibrës.

Kontrata e fundit me afat 6-mujor është nënshkruar në qershor të këtij viti dhe përfundon në janar të vitit 2022, me një kosto të mirëmbajtjes mujore, rutinë 607.620 lekë.

Në një vit mirëmbajtja e kësaj rruge kushton mesatarisht 7.3 milionë lekë të reja, ndërsa në 20 vitet e fundit për mirëmbajtjen e kësaj rruge janë hedhur rreth 146 milionë lekë të reja.

Investigative Network Albania mëson se për këtë segment rrugor Njësia Administrative Martanesh është ankuar pranë Ministrisë së Infrastrukturës për shkak të problemeve me mirëmbajtjen. Në një shkresë që mban datën 20 shkurt 2020, Njësia Administrative Martanesh i ankohet Ministrisë së Infrastrukturës se firma që ka për detyrë mirëmbajtjen, nuk i kryen punimet.

Njësia Administrative Martanesh e vë në dijeni Ministrinë e Infrastrukturës se përgjatë gjithë gjatësisë së saj "kjo rrugë është plot me gropa, nuk ka kanal anësor, dhe ai që ka qenë, nuk mirëmbahet dhe mbushet me ujë gjatë gjithë kohës; nuk ka sinjalistikë".

Vetëm 16.7 km e gjatë, rruga Krastë-Qafë Buall, në afërsi të Bulqizës, është kthyer në makthin e banorëve të qytezës së vogël të Krastës. E hapur në vitet `80, atëherë kur industria e nxjerrjes së kromit e ktheu Krastën në një qytet, ku gëlonte jeta, mbi këtë rrugë nuk është vënë dorë që prej 40 vitesh. Si pasojë ajo është krejtësisht e amortizuar, me rrëshqitje dherash, gropa të mëdha, duke u kthyer në rrezik serioz për ata që kalojnë në këtë rrugë. Dhjetëra lapidarë që ndodhen përgjatë gjithë gjatësisë së këtij aksi rrugor, dëshmojnë se Qafë Buall-Krastë është kthyer në një "rrugë vdekjeje".



Kujtim Bala, shofer

"Si pasojë, kjo rrugë çdo 1 km ka një lapidar", - ankohet Njësia Administrative Martanesh, duke ia faturuar numrin e lartë të aksidenteve gjendjes së rrugës.

"Kërkojmë nga ju që kontraktori i kësaj rruge të marrë masat e nevojshme për mirëmbajtje, pasi as 10 për qind e punës nuk investohet në këtë rrugë", - thuhet në këtë shkresë.

Në përgjigje të kësaj shkrese, ARRSh thotë se në mungesë të fondeve për investim, segmenti rrugor Qafë Buall-Krastë është përfshirë në kontratë mirëmbajtjeje, duke theksuar se kontraktori i mirëmbajtjes duhet të bëjë disa herë trajtimin e gropave me çakëll, si dhe pastrimin e kanalit kullues, pasi kjo rrugë përballet me trafik të mjeteve të tonazhit të rëndë, si dhe terren të vështirë malor.

Mirëpo situata vazhdon të jetë e njëjtë prej dekadash. "Gropat janë aq të mëdha, sa, kur bie shi, të duhet varkë për t'i kaluar. Gomat duhen ndërruar çdo 5 muaj. Thyhen gominat, balestrat... kostoja është shumë e lartë, plus që 16 km rrugë të duhen 60 minuta për t'i bërë, sigurisht nëse je shofer me eksperiencë", - thotë Zylf Bebja, shofer, i cili e bën pothuajse çdo ditë rrugën Krastë-Bulqizë.

Investigative Network Albania konstatoi gjatë një vizite në terren se në këtë aks rrugor hidhet çakëll, por pa u mbyllur dita çaklli del nga gropat, kjo pasi struktura e poshtme e rrugës është shkëmbore dhe e pjerrët dhe si pasojë nuk e mban mbushjen, duke u zhdukur si të mos ishte hedhur fare. Teknikisht, sipas eksperteve, çaklli nuk lidhet me asfaltin. Për këtë arsye, shumë herë akuzohet firma e mirëmbajtjes se nuk ka bërë asgjë. *Investigative Network Albania* kërkoi informacion nga Ministria e Infrastrukturës me një seri pyetjesh, nëse është mbikëqyrur situata e kësaj rruge, por deri në momentin e publikimit të këtij shkrimi nuk morëm përgjigje.

Nga ana tjetër, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër, e cila e ka në administrim këtë aks rrugor, thotë se, në kushtet kur nuk ka asfalt, kjo mbetet e vetmja zgjidhje.

"Ky aks prej vitesh është klasifikuar me asfalt të degraduar. Teknikisht nuk ka asnjë zgjidhje tjetër përveç mbushjes me stabilizant, pasi nuk mund të bëhen arnime të asfaltit në segmentet, ku nuk ekziston asnjë cm^2 asfalt", - thotë DRVSH në një përgjigje për *Investigative Network Albania*.

Shoferët e automjeteve pranojnë kotësinë e punimeve që kryhen në këtë rrugë. "Kanalet kulluese janë hapur, por nuk bëjnë asnjë punë, pasi janë të cekëta dhe uji rrëshqet mbi rrugë, duke marrë përpara çakllin. Muajin e fundit u vendosën disa barriera mbrojtëse, por paradoksalisht ato janë vënë vetëm në atë segment, ku rruga është e drejtë, aty ku punëtorët e kanë pasur më të lehtë dhe jo në kthesa të rrezikshme, ku në dimër akulli dhe gropat mund të na nxjerrin jashtë rruge", - thotë Kujtim Bala.

Të tjerë akuzojnë se, firma që e ka për detyrë mirëmbajtjen e kësaj rruge, në fakt shpesh bëhet vetë burim aksidentesh.

"Kjo rrugë është me një kalim. Firma e mirëmbajtjes e grumbullon materialin, me qëllim që ta ketë aty për ta përdorur muajin tjetër, në ato pak vende ku mund të ndërrohen mjetet, duke u bërë shkak për aksidente", - thotë Zylf Bebja.

Mungesa e rrugës po çon në braktisjen masive të çdo fshati dhe qytetit të Krastës. Selman Likafi, nëpunës i Gjendjes Civile, thotë se në vitin 1990 në Martanesh jetonin 13.000 banorë. Nga viti 1991-1997 janë larguar 4.500 banorë. Ndërsa sot në Martanesh jetojnë 2.500 qytetarë.

"Kanë ngelur vetëm dy kategori njerëzish: Ata që kanë ndonjë biznes privat dhe ata që s'kanë pasur mundësi ekonomike për të ikur", - thotë Dilaver Koxherri.

Miliona në buxhet, por nuk ka lekë për rrugë

Ndonëse Martaneshi sjell miliarda të ardhura për ekonominë shqiptare, në këmbim ka marrë harresën deri në braktisje nga të gjitha qeveritë.

"Ndihem në vështirësi të madhe për t'ju parë në sy dhe për t'ju folur, se ç'mund t'ju them unë në këto kushte!



Qyteti Krastë

Ç`mund t'ju them unë, që pavarësisht se nuk kam qenë asnjëherë përgjegjës përpara jush në kuptimin e kontratës elektorale, prapëseprapë ndihem keq, sepse ky është një realitet



Dilaver Koxherri, banor i Martaneshit

shumë dramatik", - deklaroi Edi Rama në vitin 2008, asokohe kreu i opozitës, gjatë vizitës së parë dhe të fundit në këtë zonë, ndërsa premtonte se "ky realitet mund të ndryshojë". (marrë nga gazeta "Zëri i Popullit", e enjte, 17 janar 2008, f. 10)

Gazeta "Zëri i Popullit", e enjte, 17 janar 2008, f. 10

I pasur me burime natyrore, në Martanesh ushtrojnë aktivitetin 70 subjekte minerare dhe 5 HEC-e, si dhe disa fabrika të përpunimit të kromit, të cilat derdhin çdo vit miliarda lekë në buxhetin vendor dhe atë qendror.

Sipas të dhënave të Bashkisë së Bulqizës, subjektet private, që ushtrojnë aktivitetin në Martanesh, kanë derdhur në buxhetin e kësaj bashkie 46.7 milionë lekë të reja për vitin 2020, ndërsa në vitin 2017 janë derdhur 62.9 milionë lekë të reja, tarifë vendore dhe taksë nga renta minerare.

Ndryshe nga Bashkia e Bulqizës, që deklaron 75 biznese në këtë zonë, që derdhin detyrime në buxhetin e shtetit afro 4 milionë dollarë në vit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve deklaron se në Martanesh ushtrojnë aktivitetin 22 subjekte. Këto biznese kanë derdhur në buxhetin e shtetit 60.4 milionë lekë për vitin 2020.

"Martaneshi përveç punësimit nuk ka përfituar asgjë nga kromi. Ndoshta ka ndikuar edhe aneksimi i kësaj krahine, sa në një rreth në tjetrin", - ankohet Dilaver Koxherri. Ligji iu jep të drejtën bashkive, që nga të ardhurat e pushtetit vendor, me miratim të Këshillit Bashkiak, të investojnë çdo lloj objekti që ka probleme emergjente, me impakt në komunitet, por edhe në ekonominë kombëtare.

"Martaneshi përveç punësimit nuk ka përfituar asgjë nga kromi. Ndoshta ka ndikuar edhe aneksimi i kësaj krahine, sa në një rreth në tjetrin", - ankohet Dilaver Koxherri. Ligji iu jep të drejtën bashkive, që nga të ardhurat e pushtetit vendor, me miratim të Këshillit Bashkiak, të investojnë çdo lloj objekti që ka probleme emergjente, me impakt në komunitet, por edhe në ekonominë kombëtare.

Bashkia e Bulqizës nuk iu përgjigj pyetjes së *INA MEDIA*-s, nëse kishte një projekt dhe një preventiv për kostot që do të duheshin për rehabilitimin e kësaj rruge, por ekspertë të ndërtimit përllogarisin që kostoja për ta bërë nga e para këtë segment rrugor është rreh 300 milionë lekë të reja, shifër kjo më e ulët se të ardhurat e një viti, që biznesi që ushtron veprimtarinë në Martanesh derdh si detyrim në buxhetin e shtetit.

Pavarësisht milionave që derdhen çdo vit nga bizneset e kësaj zone në arkën e bashkisë dhe atë të qeverisë, Bashkia e Bulqizës thotë se nuk mund ta marrë përsipër një projekt për riveshje të kësaj rruge, për shkak të kostos së lartë për buxhetin e saj. "Me gjithë dëshirën e madhe për të investuar në riveshjen me asfalt, e kemi patur të pamundur për shkak të mungesës së burimeve financiare, pasi kjo rrugë me një gjatësi prej 16.7 km ka kosto të lartë investimi", - i thotë *INA MEDIA*-s Bashkia e Bulqizës në një përgjigje zyrtare.

MARTANESHI, KRAHINA QË NDËRROI 5 HERË BASHKINË

Martaneshi, një krahinë e njohur sidomos për burimet minerare, nuk ka gjetur paqe me bashkitë që e kanë marrë në administrim.



Liqeni i Zi

Aktualisht, Martaneshi është pjesë e Bashkisë së Bulqizës dhe në përbërje të tij janë qyteti Krastë dhe fshatrat Gjon, Lenë, Peshk, Val, Staveç, Mëlçu, Ndërfushas.

Ky pingpong administrativ, sipas banorëve të zonës, ka qenë shkatërrues, pasi nuk ka pasur asnjëherë projekte të mëdha zhvillimore.

"Ndarja administrative e ka dëmtuar zhvillimin ekonomik dhe kulturor të zonës. Etnokultura e trevës sonë lidhet në hershmërinë e saj me etnokulturën e Çermenikës, Elbasanit dhe Tiranës. Ndërsa lidhja administrative pas Luftës së Dytë Botërore e zhvendosi këtë krahinë administrativisht nga Elbasani (1944) me Klosin (1945), më vonë me Librazhdin (1946), me Burrelin (1947) dhe në fund me Bulqizën (1996). Kjo solli pasoja rrënuese edhe në aspektin e zhvillimit të vlerave etnokulturore dhe ekonomike. Asnjëherë nuk u bënë projekte zhvillimore afatgjata për këtë zonë. Kjo është edhe një ndër arsyet kryesore të braktisjes masive të kësaj treve", - thotë Teki Kurti, historian.

Sipas tij madje kjo ka sjellë përplasje midis



Teki Kurti, historian

qeverisjes qendrore dhe asaj lokale për orientimin e projekteve zhvillimore.

"Ka pasur ndër vite një përplasje ndërmjet drejtuesve të pushtetit qendror dhe atyre të rretheve për zhvillimin e kësaj treve. Orientimet nga dikasteri qendror jepeshin për t'u zhvilluar kjo zonë me impakt ekonomik kombëtar, drejtuesit e rretheve (të degëve ekzekutive, deputetët dhe drejtuesit politikë) i refuzonin këto projekte dhe kërkonin që investimet të kalonin në zonat e tyre, duke e konsideruar të huaj Martaneshin", - thotë ai.

Me një sipërfaqe prej 162 km², Martaneshi, një ndër tri njësitë e qeverisjes vendore me sipërfaqen më të madhe gjeografike në Shqipëri, ndodhet në qendër të Shqipërisë dhe ka një nëntokë të "florinjtë". Miniera e kromit, "11 heronjtë e Batrrës", renditet e dyta në Evropë për prodhimin e këtij minerali dhe e gjithë kjo zonë siguron deri në 500.000 tonë krom në vit.


Me një sipërfaqe pyjore ndër më të mëdhatë, ku përllogaritet një volum prej

Shpresat janë të pakta edhe pas përfundimit të Rrugës së Arbrit, pasi Martaneshi është i privuar t'i gëzohet këtij investimi. Shkak është rruga. Nga Tirana në Qafën e Buallit mbërrin për 40 minuta, por nga Qafa e Buallit deri në Krastë duhen 60 minuta për të përshkuar 16.7 km rrugë të degraduar totalisht.

1.46 milionë metrash kub lëndë drusore, të mbushura me ah, bredh, pisha, panja, bli, arra, gështenja dhe bimë medicinale, ofron potenciale të jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit. "Edhe ky sektor kërkon infrastrukturë dhe mbështetjen e pushtetit vendor dhe atij qendror, por nuk ka rrugë", - thotë Dilaver Koxheri.

Në këtë trevë fle i pazbuluar një atraksion i mahnitshëm turistik. E shpallur zonë e mbrojtur, peizazhi Ballenjë-Bizë nuk është i vetmi ndër këto anë. Liqeni i Zi, Liqeni i Luleve, Liqeni i Sopajeve e plot pika të tjera janë potencial i jashtëzakonshme për turizëm, i cili në këtë zonë është fare pak i zhvilluar, sepse nuk ka rrugë!

"Martaneshi është atraksion natyror turistik. Është fare pranë Tiranës dhe mund të kthehet në destinacion gjithëvjetor. Megjithëse është klasifikuar ndër 16 zonat me përparësi për turizëm, aty nuk ka infrastrukturë hotelerie, pasi nuk ka rrugë", - thotë Rrahman Kasa, kryetar i Unionit të Turizmit në Shqipëri.



Harta e 16 zonave prioritare për turizëm

Rruga pengon zhvillimin ekonomik të kësaj treve me asete të pasura në xeherorë, shërbime blegtorale, si dhe mbledhjen dhe transportin e bimëve medicinale. "Megjithëse ne i derdhim rregullisht detyrimet tatimore, nuk marrim shërbime", - thotë Xhaferr Kunxhiu, sipërmarrës.

"Për Martaneshin nuk ka pasur dhe nuk ka një studim të mirëfilltë për lidhjen e kësaj treve me sistemin rrugor kombëtar. Për ultësirat në Martanesh, ku janë të vendosur fshatrat dhe banorët (600-800 m mbi nivelin e detit), nuk u hapën asnjëherë rrugë me plan, por u bënë disa rrugë të ish-kooperativave bujqësore që funksiononin si rrugë sezonale për makina të larta", - thotë historiani Teki Kurti.

Shpresat janë të pakta edhe pas përfundimit të *Rrugës së Arbrit*, pasi Martaneshi është i privuar t'i gëzohet këtij investimi. Shkak është rruga. Nga Tirana në Qafën e Buallit mbërrin për 40 minuta, por nga Qafa e Buallit deri në Krastë duhen 60 minuta për të përshkuar 16.7 km rrugë të degraduar totalisht.

"Ministria dhe ARRSh në mënyrë urgjente duhet të kryejnë një studim fizibiliteti për ndërtimin e një aksi të ri rrugor, që lidhet me ish-zonën historike të trevës, për ta lidhur për herë të parë me rrugë sipas standardeve bashkëkohore", - thotë Teki Kurti, i cili sugjeron se vetëm në këtë mënyrë kjo trevë do të lidhej më në fund me pjesën tjetër të Shqipërisë dhe do t`i hapte rrugën zhvillimit ekonomik dhe turistik të kësaj zone.

Marrë nga: https://ina.media/?p=3408

Rruga e Arbërit nr. 183

profil

Dy do të ishin kolonat, ku Gazmend Hajdaraga do të mbështetej dhe për të cilat ai do të punonte fort, arsimi dhe bujqësia.

Gazmend Hajdaraga *i Dibrës së Madhe*

Nga **OSMAN XHILI**

Ai tani po u drejtohet të tetëdhjetave, por pamja e fiziku i tij të japin përshtypjen e tre dekadave më pak. Ndoshta dhe faqet e një libri nuk do të mjaftonin për të treguar e përshkruar jetën e tij të gjatë, të mbushur plot e përplot me ngjarje, disa të bukura e të këndshme, të tjera të dhimbshme e të trishta.

Babai i tij, Miftari, ishte nip i Gropajve dhe më vonë i Qokeve të njohur të Kllopçishtit. Gjatë kohës së luftës së dytë botërore ai kishte një hotel të vogël në Zerqan, që aso kohe ishte nënprefekturë dhe një qendër e rëndësishme dije dhe ekonomie.Hotelin e dogjën dhe Miftari u largua për në Dibër të Madhe, me idenë për tu rikthyer më vonë.Dikush me përvojë në këto çështje e këshillon të mos kthehet, pasi pasojat mund të ishin fatale. Kështu, Miftari ju përvesh bujqësisë,një sektor që e njihte mjaft mirë.

Në vitet 1949-1952, u krijuan kooperativat e para në ish Jugosllavi dhe Miftari caktohet brigadier i vreshtarisë. Por kjo nuk zgjati shumë dhe fermerët u kthyen sërish në sistemin privat. Prodhimet e tyre taksoheshin dhe ata detyroheshin t'i paguanin shtetit grurë, misër, mish, qumësht, vezë, në bazë të një sistemi pikësh, me të cilat blinin mallra në dyqanet e shtetit. Familja e Miftarit punonte tre hektarë tokë, mbillte kultura të ndryshme bujqësore dhe mbante dy tre lopë.

RRUGETIMI NE SHTIGJET E DIJES

Lindur e rritur në një familje të tillë punëtore, Gazmendi do të shquhej më vonë, jo vetëm për punë, por dhe rezultate të shkëlqyera në mësime. Në vitin 1957, mbaron tetëvjeçaren në qytetin e tij të lindjes dhe për një vit, nuk shkon në shkollë të mesme, pasi asaj kohe nuk kishte një të tillë në Dibër të Madhe. Gjimnazi do të hapej këtu tre vjet më vonë, në vitin 1960. Do të ishte ky një kontribut i gjithë qytetarëve të etur për dije e arsim, por dhe i mësuesve që punuan gjashtë muaj, në mënyrë vullnetare, pa marrë paga nga shteti.

Në të tilla rrethana, Gazmendi vazhdon shkollën e mesme profesionale për agronomi në Tetovë, mësimet e së cilës zhvilloheshin në gjuhën maqedone. Dhe këtu rezultatet ishin të shkëlqyera. Sërish një shkëputje, tashmë dy vjeçare dhe djaloshi i ri kthehet në qytetin e lindjes, duke punuar ca kohë në komunë. Studimet e larta i kryen në qytetin e Zagrebit, pasi Shkupi ishte dëmtuar rëndë nga tërmeti i vitit 1963. Pesë vite studimi, ku nuk munguan rezultatet shumë të mira, që e kishin ndjekur në çdo hap. Para tij u hapën disa mundësi për të projektuar të ardhmen. Profesori, me të cilin kishte pasur temën e diplomës, i propozon të qëndrojë si asistent. Më tej hapat do ti ngjiste gradualisht në tempullin universitar të dijes, të bëhej doktor e profesor në shkencat agronomike. Një tjetër mundësi ishte të ingranohej në ministrinë e bujqësisë, në Shkup. Gazmend Hajdaraga nuk zgjodhi as njërën as tjetrën, por sërish u kthye në Dibër, për të kontribuar me dijet që kishte fituar deri atëherë.

DREJTOR I KOMBINATIT BUJQËSOR "PROGRESI"

Ky ishte emërtimi i një ndërmarrje bujqësore, shumë e madhe e asaj kohe. Kombinati Bujqësor "Progresi" zotëronte 400 hektarë tokë bujqësore, 7000 hektarë kullota dhe mbi pesë mijë kokë dhen. Gazmendi u emërua të punojë pikërisht në këtë kombinat. Dy vitet e para si punonjës i thjeshtë, por



që i shërbyen mjaft në njohjen e punëve e problematikave, në njohjen e njerëzve dhe karaktereve. Kjo ndërmarrje gjigante me 220 punonjës asaj kohe rezultonte me humbje të mëdha, si pasojë e një drejtimi jo korrekt. Dy vite më vonë, në vitin 1972 drejtor i këtij Kombinatit " Progresi" u emërua Gazmend Hajdaraga. Ishte një nder i madh dhe një përgjegjësi e madhe për të. A do të mundej ai të sillte një frymë dhe një model tëri drejtimi? A do të mundej ta përligjte emrin "Progres", që kishte ky kombinat bujqësor

Krahas disa drejtuesve të mirë dhe me përvojë, Gazmendi angazhoi dhe kuadro të rinj e të shkolluar, për ti dhënë gjallëri e vitalitet ndërmarrjes. Ai kërkonte tregjet, përpiqej të rriste sasinë e produkteve, por dhe cilësinë e tyre, në mënyrë që çmimet e shitjes të ishin sa më të larta. Në vetëm pak vite ai ngriti një mensë gjigante për gjithë punonjësit e "Progresit". Nuk e hapi këtë, deri sa u sigurua se i kishte mundësitë e mjetet për t'ua dërguar drekën punëtorëve, aty te parcela ku ata punonin. Të plotësuar nga ana fiziologjike dhe të kënaqur nga pikëpamja psikologjike, punonjësit u mobilizuan akoma më shumë, duke e ndjerë veten si një familje e madhe.

Gazmendi e shihte vërtet kështu kombinatin bujqësor, që drejtonte, si një familje e madhe. Hallet dhe shqetësimet e tyre ishin dhe të tijat. Krejt rastësisht në dyqanin e tij bujqësor në qendër të qytetit, u ndodh dhe një nga ish punonjësit e tij nga fisi Kukale. Ai tregoi se drejtor Gazmendi kishte ndërtuar mbi dhjetë banesa me kontribut vullnetar për punonjësit e tij, duke u përveshur dhe vetë si punëtor në punë të rëndomta.

Ndër kujtimet e tij të shumta, lidhur me punën si drejtor I kombinatit " Progres", në harkun kohor të 15 viteve, ai nuk mund të lejë pa përmendur mbjelljen e 50 hektarëve me vreshta, ngjitur me doganën e Bllatës. Ishte pranvera e vitit 1981 dhe deri në prill duhej të përfundonin mbjelljen e 25 hektarëve të parë. Ritmet e ditëve të para ishin shumë të ngadalta 300 deri 500 rrënjë në ditë. Jashar Kllopçishta,një nga punëtorët e vjetër, që nuk jeton më, i thotë i pezmatuar se nuk do ti arrinin objektivat. Drejtori energjik do bënte të pamundurën. Ai kap vetë veglat e punës dhe bën garë me punëtorët. Në ditët në vazhdim i bën kërkesë shkollës tetëvjeçare dhe asaj të mesme, duke u sjellë te parcela vaktin e drekës. Falë këtyre masave u arrit që fidanat të mbilleshin në kohë dhe të garantohej zënia e tyre gati 100 %.

Varieteti i rrushit të mbjellë ishte kryesisht Rieslig Italian, me një përqindje shumë të lartë sheqeri, deri 26 %.Që në vitin e parë të prodhimit u mblodhën 250 ton, që u dërguan

Nuk vonoi gjatë dhe populli i mrekullueshëm i Dibrës së Madhe i kërkoi sërish shërbimet e tij, por këtë radhë në një stad akoma më të lartë. E kërkuan që t'i përfaqësonte në foltoren e parlamentit të parë demokratik të Maqedonisë. Do të ishte zëri i tyre atje, veshi dhe syri i tyre, do të çonte atje hallet dhe shqetësimet e tyre. Plot 12 mijë vota mori në zgjedhjet e vitit 1990 dhe ishte kjo një votë plebishitare, një suport i madh, një besim i padiskutueshëm.

në qytetin e Manastirit për tu përpunuar. Çmimi i tij ishte mjaft i leverdishëm, duke sjellë mjaft të ardhura për punonjësit. Vitin tjetër u mbollën dhe 25hektarë të tjerë, duke shkuar në 50 hektarë në total, aq sa ishte objektivi.

BIZNESI PRIVAT, FARMACIA BUJQESORE.

Gazmendi kujton se pas vitit 1985 filloi një politikë e spastrimit të kuadrove, kryesisht të atyre shqiptar. Nuk i donin njerëzit e punës dhe profesionistët, donin servilët. Si dhe shumë të tjerë, ai largohet



nga puna si drejtor i kombinatit, ku kishte shërbyer për 15 vjet dhe fillon punë në komunë. Pas dy tre viteve lëvizje nga një vend në tjetrin, më 25 shkurt të vitit 1989, ai përfundimisht shkëputet nga puna e shtetit dhe hap të parën farmaci bujqësore në Dibër.

Në ata kohë, sapo ishte miratuar punësimi në sektorin privat të ekonomisë dhe Gazmendi ishte ndër të parët, që e hodhi këtë hap. Ishte i sigurt që do të kishte sukses, për shumë e shumë arsye. E ku pati shkuar deri atëherë e nuk shkëlqeu?A nuk kishte qenë model në shkollë e në studime?A nuk e nxori kombinatin "Progresi", nga humbjet e defiçitet, në një bilanc tejet pozitiv e me një model të përsosur drejtimi?A nuk kishte krijuar te shtëpia një bahçe model me mollë, vishnja, qershi, vreshtë e plot të tjera si këto? E përse të kishte frikë tani, aq më tepër që këtu rezultatet do të vareshin vetëm prej punës dhe sjelljes së tij? Gjatë punës së tij deri tani, ai kishte krijuar shumë njohje dhe eksperienca, që do ti shërbenin në këtë sipërmarrjen e re.

Vërtet nuk u gabua në parashikimet e tij. Nuk u lodh shumë për të krijuar klientelën, pasi ai e kishte ngjizur besimin dhe respektin e njerëzve, që kurse ishte drejtor dhe përvishte llërët, si një punëtor I thjeshtë. Qëkurse shihte disa familje që ishin ngushtë për banim dhe ai vraponte të gjejë rërën, lëndën, tjegullat dhe në përfundim lotë gëzimi i buronin nga thellësia e zemrës dhe shpirtit.

Ishin vite kur fermerët kishin shumë nevojë për farëra, për fidana, për konsulencë teknike e profesionale.Ai u shërbente, pa pushuar, gjithë ditën në këmbë, në lëvizje. Vinin shumë dhe që këtejkufiri nga Maqëllara, Peshkopia dhe më larg akoma. E ndihmonte e shoqja, e ndihmonte Aveniri, djali i tij, por dhe njerëz të tjerë i punësonte aty, që shërbimi ndaj klientit të bëhej sa më i mirë.

DEPUTETI I DIBRES

Nuk vonoi gjatë dhe populli i mrekullueshëm i Dibrës së Madhe i kërkoi sërish shërbimet e tij, por këtë radhë në një stad akoma më të lartë. E kërkuan që t'i përfaqësonte në foltoren e parlamentit të parë demokratik të Maqedonisë. Do të ishte zëri i tyre atje, veshi dhe syri i tyre, do të çonte atje hallet dhe shqetësimet e tyre. Plot 12 mijë vota mori në zgjedhjet e vitit 1990 dhe ishte kjo një votë plebishitare, një suport i madh, një besim i padiskutueshëm. Nuk u zhgënjyen, pasi e votuan sërish katër vite më vonë. Ai e ndjente peshën dhe përgjegjësinë e madhe të njerëzve, në emër të të cilëve, ai do të fliste në parlament. Dy do të ishin kolonat, ku ai do të mbështetej dhe për të cilat ai do të punonte fort, arsimi dhe bujqësia.

Bashkë me kolegët shqiptarë në parlament, dhe pse mund të ishin të partive të ndryshme, ai punoi fort, që shqiptarët e Maqedonisë të ishin më të ditur, më të shkolluar dhe të kishin në finale Universitetin e tyre. Së fundi populli dhe deputetet, si një trup i vetëm e morën atë që u takonte, Universitetin e Tetovës, për ta gëzuar në shumë e shumë breza.

Po kështu Gazmend Hajdaraga u angazhua fort në çështjet e bujqësisë, pasi bënte pjesë në komisionin e bujqësisë dhe ishte ekspert i kësaj fushe. Do të kërkonte fort që të shtoheshin fondet për bujqësinë, të shtohej ndihma e shtetit për fermerët, të mundësoheshin për ta tregje të jashtme me interes.

Kanë kaluar shumë vite që atëherë dhe Gazmendi është rikthyer tek dyqani i tij, te biznesi i tij familjar, te farmacia bujqësore. Jo se e bën për pak para që fiton aty, por i duket vërtet si një dritare komunikimi me njerëz, pa të cilët nuk e koncepton jetën. Të flasë me ta, ti përshëndesë e ta përshëndesin, ti respektojë e ta respektojnë dhe të pijë një kafe, apo çaj me mysafirë, në tavolinën bujare, tek dera e dyqanit të tij. Në dekadën e tetë, që po përmbyll jeta e tij, ne i urojmë dhe shumë vite të lumtura, bashkë me familjen, që i do dhe e duan aq shumë!

oftalmologji

"Laseri në Oftalmologji" i prof.Tonuzit, libri i parë në fushën e Oftalmologjisë në vendin tonë

Prof.asoc.dr.Ali Tonuzi - kirurgu vitreoretinal që kryen ndërhyrjet më të ndërlikuara në sy

Nga **Halil RAMA**



Libri "Laseri në Oftalmologji" është konceptuar të shërbejë si një bashkudhëtar i fuqishëm për oftalmologjistët klinikë dhe siguron një ilustrim të mirë të koncepteve bazë të terapisë së laserit për shoqërime okulare të ndryshme të lidhur me kapakët, kornën, kristalinin dhe retinën", - shprehet ndër të tjera prof.Zhugli

Pas tri dekadash pa ndërprerje në gazetari, me sytë mbërthyer nga ekrani i kompjuterit, konstatova dëmtimin e perdes së syrit, një patologji kjo problematike që konsiston në zvogëlimin e imazhit të gjërave të largëta dhe të larta. Në këtë gjendje, si çdokush tjetër i prekur nga kjo patologji, iu drejtova mjekut okulist. Dhe ai që bëri mrekullinë, duke më rikthyer dritën e syrit qe Prof.asoc.dr.Ali Tonuzi - Kirurg Vitreoretinal në Departamentin e Okulistikës të Spitalit Francez në QSUT (Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"). Për t'i shprehur mirënjohjen si shprehja më e bukur e karakterit të njeriut, hodha disa rreshta për profilin e tij në websitin e një portali të njohur, pa e ditur që pas atij statusi do të vërshonin mijëra falenderime për të. Janë këto vlerësimet më objektive nga "foltorja" më e besueshme, jo vetëm e pacientëve të operuar prej tij, por edhe e përfaqësuesve të elitës mjeksore. Njëri prej tyre, Dr.Nexhat Kala,- otorinologu i njohur, ish-nëndrejtor i QSUT dhe deputet i Kuvendit të Shqipërisë, këtë "dyndje" mirënjohjeje të pacientëve e shpjegon me nivelin e lartë profesional të okulistit të talentuar Ali Tonuzi, shpirtin human dhe reputacionin që ai e ka fituar me punën e përkushtimin qytetar, me sjelljen dhe shërbimin shembullor, pa i diferencuar në asnjë rast pacientët.

PROF. ZHUGLI: LIBRI I DR. ALI TONUZIT "LASERI NË OFTALMOLOGJI", VEPËR ME VLERA SHKENCORE

Prof.asc.dr.Ali Tonuzi, në mesin e moshës së tij ka arritur një karrierë të shkëlqyer akademike dhe profesionale. Jo vetëm si një okulist famoz (ndër të vetmit në rang vendi e rajoni që kryen operacione të shkallës së lartë), por prej dy dekash edhe si një ndër pedagogët më të mirë në Departamentin ORL-Okulistikë të Fakultetit të Mjeksisë në Universitetin e Mjeksisë Tiranë. Ai është përfshirë intensivisht në botën akademike pasi fitoi titullin "Doktor i Shkencave Mjeksore" (Maj 2002) dhe Prof. Asc në Tetor 2012. Produkt i punës së thelluar studimore shkencore është edhe libri i tij "Laseri në Oftalmologji" për të cilin prof.Sulejman Zhugli pohon se është teksti i parë që botohet në fushën e Oftalmologjisë në vendin tonë, llojet dhe përdorimet e shumta të tij në këtë fushë. Libri është shkruar thjeshtë, i ilustruar me shumë figura, duke e bërë tekstin shumë të kuptueshëm për të gjithë gjeneratën e oftalmologjistëve dhe më gjerë. "Ky libër është konceptuar të





shërbejë si një bashkudhëtar i fuqishëm për oftalmologjistët klinikë dhe siguron një ilustrim të mirë të koncepteve bazë të terapisë së laserit për shoqërime okulare të ndryshme të lidhur me kapakët, kornën, kristalinin dhe retinën",-shprehet ndër të tjera prof.Zhugli në paraathënien e këtij libri.

Padyshim që kjo karrierë e shkëlqyer profesionale dhe akademike e prof.asoc.dr.Ali Tonuzit ka patur si bazë studimet universitare me rezultate të shkëlqyera në Fakultetin e Mjeksisë, Tiranë, dega Mjeksi e Përgjithshme (1986-1991), për të vijuar me "Diplomë Kualifikimi", Specializim në Departamentin e Okulistikës, Tiranë (1992-1996) dhe në vitin 1997, ndoqi dhe përfundoi Shkollën Pasuniversitare (SHPU). Për të arritur në këtë stad kualitativ dhe akademik, prof.as.dr. Ali Tonuzi ka kryer disa trajnime dhe kualfikime, si: Kirurgji Okulare (Syrit) në Malaga - Spanjë; Specializim në Okulistikë (ORBIS) në Varna - Bullgari; për Kirurgjinë e Kataraktit pranë Universitetit Charles - Pragë, Republika Çeke; Program trainimi në Phacoemulsification, në Aravind Eye Hospital Coimbatore - Shteti, Tamilnadu, INDIA si dhe Felloëship në Menaxhimin Medikal & Kirurgjikal në Semundjet e retines dhe Vitrosit, në Aravind Eye Hospitals & Postgraduate Institute of Ophthalmology. India.

Si njohës perfekt i anglishtes e frëngjishtes në të lexuar, shkruar e folur, Prof.asc.dr. Ali Tonuzi, njëherësh ndër anëtarët më aktiv të Shoqatës së kirurgëve vitreoretinal të Indisë dhe Shoqatave Shkencore të Okulistëve të Shqipërise e asaj të Kosovës, është pjesëmarrës dhe referues dinjtoz në disa kongrese e konferenca Shkencore, kombëtare, rajonale e ndërkombëtare, si në Bern e San Galen - Zvicer, Romë - Itali, , Prague - Czech Republik, Morfild – Londër, Dubrovnik- Kroaci, Sarajevë – Bosnje Hercegovinë, Kerala – Shteti Tamilnadu India, Ljubljana - Slloveni, Thessaloniki - Greqi , Helsinki - Finland , në Prishtinë, Stugë. Etj.

Prof.asc.dr.Ali Tonuzi është autor i dhjetra artikujve dhe botimeve shkencore në revista e buletine shkencore të vendit e ato ndërkombëtare.

AKTIVITETI PROFESIONAL

Aktiviteti profesional i Prof.asc.dr.Ali Tonuzit konsiston në zbulimin për të parën herë të të sëmurëve me retinitis nekrotizant nga CMV dhe të sëmurëve me endoftalmit endogen nga HIV. Po ashtu, në trajtimin e endoftalmitit me vitrektomi dhe injeksione intravitreale; përdorimin e triamcinolonit në edemën makulare diabetike; përdorimin e avastines në edemën makulare cystoide; trajtimin bashkohor të degeneracionit makular senile të njome me Anti-VEGEF, Lucentesis dhe TPP, PDT; përdorimin e laserit në edemën makulare diabetike (Fokal laser); përrdorimin e laserit për fotokoagulacionin panretinal ne retinopatin diabetike proliferative si dhe trajtimin e okluzioneve venoze retinale me laser.

Specialistët e fushës i njohin prof,asc,dr. Ali Tonuzit meritën e trajtimit për herë të parë të të sëmurëve me dislokim të lensit në trupin vitroz me vitrektomi anteriore dhe fiksim skleral në dhomen e pasme; aplikimin e Barage laser për degeneracionet dhe çarjet retinale periferike për parandalimin e shkolitjes retinale, përdorimin për herë të parë të Ganciklovirit intravitreal dhe cor vitrectomi në endoftalmitin nga HIV- i dhe CMV; trajtimin kirurgjikal në sindromë Marfan dhe riaftesim të plote të të semurit me anë të fiksimit të inplantit në sklere dhe vitrektomi anteriore si dhe të Trans plana vitrektomi në hemoragjitë masive vitreale dhe rrethim me buckel në shkolitjet retinale dhe injeksion i vajit të silikonit.

Me këto ndërhyrje kirurgjikale të sukseshme ai është bërë nga kirurgët vitreoretinal më të njohur e preferuar nga pacientët, jo vetëm vendas por edhe nga shtetet e rajonit.

KIRURGU VITREORETINAL QË KRYEN NDËRHYRJET MË TË NDËRLIKUARA NË SY

Prof. asc. Dr. Ali Tonuzi - oftalmolog, kirurg i vitroretinës, që e ushtron profesionin prej afro tri dekadash, si dhe një nga pedagogët e mirënjohur të Univeristetit të Mjeksisë (udhëheqës shkencor i temave të disa doktorantëve) është ndër të rrallët që ka realizuar me sukses mijëra operacione të ndërlikuara.

Ai bën të ditur se prej vitesh Sherbimi i Okulistikës ofron me sukses një gamë të gjërë të ndërhyrjeve kirurgjikale në sy me teknika bashkëkohore dhe se prej vitit 2019 e në vazhdim është siguruar nga spitali e gjithë paketa e kataraktës që vazhdon të aplikohet me sukses në këtë shërbim. Ndërkohë, Qendra Shqiptare e Syve, drejtuar nga Prof.asc. dr.Ali Tonuzi, është ndër më profesionalet, ku përveçse vizitave të përgjithshme okulistike janë kryer dhe kryhen me sukses ndërhyrje të ndërlikuara, si kirurgji strabizmi; pterigium; kirurgji katarakte; kirurgji glaukome; lazer për retinën; kirurgji vitreoretinale; trajtim i syrit të verbër të dhimbshëm; proteza okulare; plastikë e syrit si dhe hapje e kanalit të lotit endoskopike (pa qepje).

Dr.Tonuzi gjatë karrierës së tij profesionale dhe akademike ka marrë disa vlerësime nga institucione e agjenci të specializuara, për nivelin e lartë profesional, përkushtimin dhe cilësitë njerëzore dhe si hartues i suksesshëm i një sërë leksionesh universitare në fushën e mjekësisë.

Përkushtimi, profesionalizmi dhe talenti i Dr.Ali Tonuzit është vlerësuar edhe nga shoqata Shqipëri-Italy. Kjo shoqatë i akordoi atij para disa ditësh një Mirënjohje në vlerësim të kontributit të shquar në fushën e mjekësisë dhe në atë të jetës akademike e universitare.

Dr.Tonuzi, 54 vjeç, ka tashmë më se çerek shekulli në shëndetësi. Në duart e tij kanë kaluar me dhjetra e dhjetra mijëra pacientë të cilët i kanë besuar dritën e syve këtij mjeku okulist të talentuar, ku prej shërbimit të marrë kanë qenë mjaft të kënaqur. Për tri dekada këtu në Shërbimin e Okulistikës të Spitalit Francez në QSUT ai ka dhënë provat e një mjeku mjaft të aftë dhe ambicioz në profesion.

Në kohët që jetojmë kemi nevojë për njerëz të mirë të mençur, vizionarë që të nderojnë jo vetëm një punë ku marrin një rrogë mujore, po shumë më tepër. Kohët që po jetojmë na bëjnë që ta kthejmë dhe më shumë syrin nga mjeku, nga humanizmi i tij. Për ta bërë më saktë portretin e tij do të citoja fjalët e një pacienteje. "Sa hyn dhe shikon Dr. Aliun, të rregullohen vetë sytë e s'ke më nevojë për syze." Në këtë përditshmëri ai mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësues i elitës intelektuale shqiptare. Kjo sepse ka qenë njësh me pacientin, i shkrirë në nevojën e tij duke iu gjendur sa herë i lypte nevoja. Vlerësimi për dibranin e mirë dhe të zotin, Prof.asc.dr.Ali Tonuzin për çfarë ka dhënë në profesionin e tij si mjek dhe si profesor është i merituari dhe të tilla vlerësime nuk duhet të mungojnë për profesionistët.

Urim për 100 vjetorin!









Nadire Kërkuti, e lindur me 28 Nëntor të vitit 1921, i mbushi plot 100 vjet.
E lindur në Dibër të Madhe në familjen Kolari dhe, më vonë, e martuar te gjyshi ynë, Lutfi Kërkuti, ku bashkë Zoti i bekoi me mbi 60 familjarë, nga të cilët 4 djem, 3 vajza, 11 nipër, 10 mbesa, 14 stërnipër, 20 stërmbesa, 4 kastranipër, 2 kastrambesa dhe 2 binjakë në pritje nga nipi i sajë.
Nana Xhixhe, siç është edhe e njohur në familjen tonë të madhe, njihet për mirëpritjen, bujare si dhe tepër qibare. Na rriti dhe drejtoji me aq mundësi sa kishte. Që nga viti 2012, Nadirja jeton në Amerikë nën mbikqyerjen e familjareve të saj, ku kohe pas kohe e vizitojnë dhe e respektojnë Nënën më të vjetër të familjes Kërkuti.
Nëna jonë e dashur, faleminderit për sakrificat tuaja!
Qofsh e lumtur për jetë!
Në emër të gjithë familjes tuaj "Gëzuar Ditëlindjen"!

Shënim: Për raste të veçanta, gazeta jep hapësira për mesazhe urimi ndaj familjarëve tuaj. Shkruaj: rrugaearberit@gmail.com

Pajtohu në gazetën **RRUGA E ARBËRIT**
pranë çdo filiali të **POSTËS SHQIPTARE**
në të gjithë Shqipërinë.
Një pajtim vjetor kushton 600 lekë.

POSTA SHQIPTARE

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank, Rruga e Arberit. Nr. llog. në lekë: 0010036640. IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640
PAJTIMET TUAJA JANË E VETMJA MBËSHTETJE PËR TË RUAJTUR LIRINË DHE VAZHDIMËSINË E GAZETËS!

LIBRA TË ZGJEDHUR

“Ngjizja e papërlyeme”, romani tetralogjik i Agron Tufës

Romani tetralogjik i Agron Tufës “Ngjizja e papërlyeme” është një sagë rrëqethëse e shoqërisë shqiptare në fillim të viteve ’60, fill pas prishjes me BRSS-në, që nis me zhburrnimin e bash-këshortëve shqiptarë, të cilët Partia i detyroi të ndajnë gratë e tyre ruse dhe të prishnin familjet e krijuara me to. Nis kështu izolimi, lufta e klasave dhe projekti i skllavërimit të plotë të individit. Në qendër të tetralogjisë është fati tragjik i aktores së re, Ljuba Borisovna, së cilës i pushkatojnë të shoqin inxhinier-gjeolog: ai ka shkruar një roman autobiografik “armiqësor”, dorëshkrimin e të cilit Ljuba e gatuan dhe e ha në kushtet e një tronditjeje të madhe dhe prej të cilit, paradok-salisht, mbetet shtatzënë. Shteti komunist nuk mund ta pranojë ekzistencën e rrezikshme të një mrekullie të tillë, të pashpjegueshme, në kulmin e propagandës kundër besimeve fetare. Partia ngarkon Sigurimin me rrjetin e agjentëve dhe informatorëve për të hetuar, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, porosit raporte shkencore ekspertësh të gjenetikës rreth kësaj dukurie të mbi-natyrshme. Hetimet vazhdojnë... një shkrimtar i ri i talentuar, Samuil Ismari, përpiqet të gjejë sekretin e mbijetesës si artist dhe të kthjellojë dilemat hamletiane, personazhe të tjera faustiane, si Nesho Dragoi, kolonel Zeno e Viktor Sallaku, hyjnë në kontratë me të keqen, qarqet krijuese diskutojnë rreth këtij misteri të shtatzënisë, ndërkaq që ligjet shpërfillëse të natyrës japin frytin e saj: lind fëmija i ngjizjes së papërlyeme, Romani, përmes të cilit, në ditët tona tashmë, shkarko-het dhe rrëfimi i këtyre historive.

E gjeni në çdo librari!
Çmimi: 1800 lekë




LIBRAT MË POSHTË I GJENI ME 20% ZBRITJE GJATË GJITHË MUAJIT DHJETOR
























Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë librarisë sonë në Tiranë në rrugën “Isa Boletini”, pranë kryqëzimit te Selvia; librari *“Art’s”* të Stacioni i Trenit në Tiranë; *FletaXXI* në Peshkopi ose porositeni te libraria e lagjes suaj.
Për çdo porosi në Tiranë ose në rrethe, kontaktoni në email:
mbbotime@gmail.com, Cel. 0686508441 (Whatsapp), 0692068603 (Viber). Posta brenda vendit është FALAS.

cyan magenta yelloë black

Rruga e Arbërit nr. 183

histori

Marrë nga libri "HISTORIA E DIBRËS" - Që nga lashtësia deri në mars 1939 i prof. dr. Kristo Frashëri. ISBN: 978-99956-04-82-0, Botimet M&B, Tiranë 2012

Dibra pas Pavarësisë Kombëtare (1912-1918)

Nga akademik **KRISTO FRASHËRI**

Popolli dibran e priti me entuziazëm shpalljen e pavarësisë kombëtare, për të cilën kishte luftuar shekuj me radhë. Por gëzimi nga vendimi historik i Vlorës u përzie me një ndjenjë të thellë zemërate kundër okupatorëve të rinj të atdheut. Për më tepër, atë e pushtoi një shqetësim i madh për fatin e mëtejshëm të trevës dibrane, të cilën e lakmonin dy nga shtetet fitimtare të luftës ballkanike – Serbia dhe Bullgaria.

Në të vërtetë, rreziku më i madh vinte nga Serbia, sepse kjo me anën e carit të Rusisë e kishte eliminuar Bullgarinë nga pretendimet kundrejt Dibrës. Veç kësaj, me përjashtim të Austro-Hungarisë, lakmitë serbe i përkrahnin edhe fuqitë e tjera të mëdha, të cilat do të caktonin në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, hartën e re politike të Ballkanit.

Serbia pretendonte se Dibra, ndonëse në shumicën dërrmuese me banorë shqiptarë, ishte një tokë "sllave" dhe se i takonte asaj si një e "drejtë" e fituar me luftë. Megjithatë, qeveria e Beogradit e kuptonte se pretendimet e saj shoviniste mund të përmbyseshin në rast se popullsia liridashëse dibrane do të rrëmbente armët kundër pushtimit serb. Prandaj ajo mori një varg masash për ta konsoliduar politikisht dhe ushtarakisht regjimin e okupacionit ushtarak në këtë trevë.

Pasi siguroi ushtarakisht pozitat e saj në Shehër, Serbia e shtriu administratën e saj në Topallti dhe në javën e parë të dhjetorit shtiu në dorë Peshkopinë. Që këtej ushtritë serbe u nisën drejt veriut për të nënshtruar malësorët e Reçit e të Dardhës që e kishin turpëruar në betejën e Kolesjanit. Si hap të parë menduan të arrestonin udhëheqësin e tyre Elez Isufin, i cili banonte në fshatin Sllovë. Elezi nuk u dorëzua, por së bashku me djemtë e tij, u arratis. Për hakmarrje, serbët arrestuan tërë familjen e tij shumëfrymëshe dhe e internuan në Lumë. Elezi, i tronditur nga arrestimi i grave dhe i fëmijëve, pranoi të dorëzohej dhe premtoi se do të rrinte i mënjanuar me kusht që të lihej i lirë dhe të mos i merreshin armët e trupit. Serbët pranuan me shpresë se, po të mos e bënin dot për vete, do ta kishin më lehtë ta zhduknin fizikisht me tradhti.

Pushtimi serb i çoroditi patriotët dibranë si politikisht, ashtu dhe organizativisht. Duke mos e duruar dot zgjedhën e re, shumë prej tyre ikën në drejtim të Vlorës, para dhe pas ardhjes së ushtrive serbe. Kontaktet telegrafike me qeverinë e Ismail Qemalit u prenë, kurse mesazhet e rralla që sillnin nga Vlora korrierët trima, vinin me shumë vonesë. Nga izolimi i plotë prej botës së jashtme, filluan të qarkullonin një mori lajmesh të pakontrolluara, disa nga të cilat i fabrikonte qëllimisht vetë administrata serbe. Synimi i propagandës së Beogradit ishte të krijonte bindjen në popullsinë dibrane se çdo rezistencë ishte e kotë, mbasi fati i trevës së tyre ishte caktuar përfundimisht nga Fuqitë e Mëdha në favor të Serbisë. Popullsia nuk u trondit nga propaganda serbe, por disa krerë filluan të lëkundeshin dhe menduan t'i rregullonin, para se të ishte vonë, marrëdhëniet e tyre me pushtuesin e ri. Duke shpresuar në ndihmën e tyre, komanda serbe kërkoi ta shtrinte autoritetin e vet në Malet e Dibrës. Aty nga mesi i janarit 1913, reparte ushtarake serbe tentuan të depërtonin në Grykën e Vogël. Përgjigjja nuk vonoi. Malësorët rrëmbyen armët dhe u dolën para reparteve të huaja. Komandanti serb i Dibrës i pezulloi menjëherë luftimet dhe thirri me të shpejtë nga Sllova Elez Isufin, të cilit i kërkoi të ndërhynte pranë kryengritësve për t'i bindur që të hiqnin dorë nga rezistenca. I zënë ngushtë, Plaku i Sllovës pranoi të takohej me kryengritësit, por, kur shkoi tek ata, i inkurajoi që ta vazhdonin rezistencën. Prej andej ai u kthye në fshatin e vet. Nga frika se mos përhapej gjithandej zjarri i kryengritjes, ushtritë serbe u tërhoqën nga Gryka e Vogël. Disa ditë më vonë, një repart serb arriti në befasi në Sllovë dhe rrethoi kullën e Elez Isufit. Së bashku me trimat dhe familjarët e vet – gjithsej shtatëdhjetë vetë – Elezi e çau rrethimin dhe doli në mal. Kulla u dogj, por tashmë Elez Isufi u bë flamurtari më i dëgjuar i rezistencës antiserbe në Dibër.

Serbët nuk i trazuan përkohësisht dibranët, për të mos shkaktuar ndërlikime sa kohë nuk ishin caktuar akoma kufijtë midis Shqipërisë dhe Serbisë. Madje, gjatë muajve të parë të vitit 1913, u duk sikur në Konferencën e Ambasadorëve po triumfonte projekti i Vjenës, sipas të cilit treva dibrane së bashku me Shehrin i liheshin Shqipërisë. Por në mars gjendja ndryshoi. Në vazhdim të pazarllëqeve imperialiste, fitoi këmbëngulja e Rusisë për t'ia dhënë Shehrin Serbisë. Fitorja që korrën u dha kurajë serbëve të kërkonin me këmbëngulje të ashtuquajturin "kufi strategjik" me Shqipërinë, në bazë të të cilit Serbia duhej të merrte krejt trevën e Dibrës. Në përputhje me këto pretendime, Beogradi, ndërsa i tërhoqi ushtritë e veta nga viset e ndryshme të Shqipërisë, vazhdoi t'i mbante të okupuara viset dibrane edhe pas vendimit që morën Fuqitë e Mëdha më 29 korrik 1913.



Suksesi i shpejtë që korrën kryengritësit dibranë dhe shtrirja e zjarrit të kryengritjes shqiptare si në Maqedoninë perëndimore, ashtu dhe në viset e Kosovës, qe një grusht i rëndë për qeverinë e Beogradit. Flamuri kombëtar i Skënderbeut, i cili valoi në të gjitha viset e çliruara, e diskreditoi thellë politikën serbomadhe të Pashiçit. Viset e çliruara u pastruan kudo nga administrata serbe.

Shkëputja e Shehrit nga trungu i Shqipërisë dhe pretendimet e mëtejshme të qeverisë së Beogradit shkaktuan te dibranët një pezmatim të përgjithshëm. Pakënaqësinë e tyre e acaroi në kulm shantazhi ekonomik dhe presioni terrorist që tani filluan të ushtronin shovinistët serbë për t'i detyruar dibranët që të prananin bashkimin me Serbinë. Ashtu si dikur turqit, ata arritën derisa t'i ndalonin malësorët dhe fusharakët që të frekuentonin tregun e Dibrës. Dibranët që shiheshin me armë në krahë arrestoheshin ose vriteshin në vend, po ashtu edhe ata që udhëtonin për në Shehër për të blerë sendet më të nevojshme (drithë, kripë, vajguri, etj.). Rritja e vazhdueshme e emërimit kundër pushtuesve serbë dhe përpjekjet që bënte qeveria e Vlorës për të plotësuar çlirimin e atdheut, e çuan popullsinë dibrane, në kryengritjen e armatosur, e cila shpërtheu në shtatorin e vitit 1913.

Shkëndijën e vet kryengritja e mori nga urdhri i rreptë që dha komanda serbe për të ndaluar malësorët të kullosnin bagëtitë e tyre në fushën përtej Drinit. Të revoltuar nga kjo masë arbitrare që çonte në keqësimin e mëtejshëm të gjendjes së tyre ekonomike, malësorët e Luznisë vendosën ta mbronin bashkërisht me armë, kullotjen e bagëtive të tyre në fushë. Më 19 shtator 1913, pas ndërhyrjes brutale të ushtarëve serbë, filloi krisma e armëve. Serbët lanë nja dhjetë vetë të vrarë – luznakët vetëm dy (Mehmet Ademin dhe Xhaferr Iljazin). Mbarë malësorët dhe fusharakët dibranë u ngritën në këmbë për të protestuar. Komanda serbe u përgjigj duke djegur Peshkopinë, Pleçën, Dohoshishtin, Deshatin, Maqellarën, Allajbegin dhe duke arrestuar brenda në Shehër dyzet e tetë vetë, pesë nga të cilët u ekzekutuan menjëherë. Si zakonisht Dibra lëshoi kushtrimin. Me mijëra malësorë të Dibrës së Poshtme rrëmbyen armë dhe u grumbulluan në Peshkopi. Të nesërmen, më 22 shtator 1913, u ngrit Topalltia. Po atë ditë, malësorët së bashku me fusharakët sulmuan në mënyrë të rrufeshme Shehrin, cili mbrohej nga katër batalione serbe. Sulmi qe kaq i rreptë sa ushtria e armikut u shpartallua brenda disa orëve. Për më tepër, ajo la në duar të shqiptarëve rreth 400 robër, të cilët u trajtuan në mënyrë njerëzore. Me hyrjen e kryengritësve në Shehër, të gjithë dibranët e burgosur u liruan. Në qytetin e çliruar të Dibrës u ngrit flamuri kombëtar shqiptar.

Ditën e nesërme, më 23 shtator, me materialin luftarak që u zu në Shehër, kryengritësit shqiptarë të ndarë në dy pjesë, ndoqën ushtritë serbe, njëra palë nëpër grykën e Drinit, në drejtim të Ohrit, pala tjetër, nëpër grykën e Radikës, në drejtim të Gostivarit. Në të dy drejtimet marshimi i dibranëve shërbeu si sinjal për përhapjen e kryengritjes në mbarë popullsinë shqiptare të viseve të aneksuara nga Serbia. Në pellgun e Ohrit, me shqiptarët u bashkuan edhe fshatarët maqedonë, të cilët ishin gjithashtu të pakënaqur nga aneksimi serb.

Sapo mori njoftim mbi shtrirjen e kryengritjes jashtë Dibrës, komanda serbe në Ohër, Strugë dhe Starovë arrestoi me dhjetëra shqiptarë, nga të cilët tetë veta në Ohër u varën me tel telegrafi ose u therën me bajonetë. Të tjerët qëndruan në burg derisa pas dy ditësh kryengritësit shqiptarë çliruan gjithë pellgun e liqenit të Ohrit. Ushtritë serbe nuk qenë në gjendje ta ndalnin marshimin e kryengritësve as nga ana e Radikës. Gjatë tërheqjes së tyre nga Kërçova ata dogjën tetë fshatra shqiptare me rreth 1850 shtëpi, vranë të gjitha gratë dhe fëmijët që gjetën në këto fshatra, kurse 250 burra që hasën në fshatin Zajar, i morën me vete. Shtrirja e kryengritjes në këto vise, i detyroi serbët të tërhiqeshin edhe nga Fusha e Pollogut. Gjatë javës së fundit të shtatorit shqiptarët çliruan Mavrovën, Gostivarin dhe Tetovën.

Suksesi i shpejtë që korrën kryengritësit dibranë dhe shtrirja e zjarrit të kryengritjes shqiptare si në Maqedoninë perëndimore, ashtu dhe në viset e Kosovës, qe një grusht i rëndë për qeverinë e Beogradit. Flamuri kombëtar i Skënderbeut, i cili valoi në të gjitha viset e çliruara, e diskreditoi thellë politikën serbomadhe të Pashiçit. Viset e çliruara u pastruan kudo nga administrata serbe. Në çdo qytet u ngrit administrata shqiptare e drejtuar nga një këshill, e cila u zgjodh me të shpejtë nga radhët e parisë vendase. Në Dibër, kryetar i Këshillit Administrativ u zgjodh Sherif Langu. Me sytë e drejtuar nga Vlora, patriotët dibranë shpejtuan t'i jepnin pushtetit të ri, një karakter krejtësisht kombëtar dhe demokrat. Me kujdes të veçantë, ata u përpoqën të konsolidonin fitoren e arritur në pritje të vendimeve që do të merrte qeveria e Ismail Qemalit.

Por fitorja nuk vazhdoi gjatë. Qeveria serbe, e tronditur në kulm nga shpërthimi dhe shtrirja e rrufeshme e kryengritjes, dërgoi përforcime të reja ushtarake të pajisura me armatime të rënda dhe me urdhrin kategorik që ta shtypnin atë me terror të shfrenuar. Ofensiva serbe filloi më 1 tetor 1913 nga Tetova në drejtim të Dibrës dhe nga Resnja në drejtim të Ohrit. Terrori që shpërthyen shovinistët e Beogradit – djegiet në masë të fshatrave shqiptare, vrasja e mijëra fshatarëve të pafajshëm, mënyra barbare e ekzekutimeve në vend, përdhunimi i grave apo vajzave të pambrojtura dhe masakrat e përbindshme që kryen mbi gratë, fëmijët dhe pleqtë e shumtë – qenë aq të pashembullta, sa revoltuan edhe mjaft oficerë apo ushtarë serbë. Përballë epërsisë ushtarake të armikut, kryengritësit shqiptarë, pa armatimet e nevojshme dhe pa organizmin e duhur, u detyruan të tërhiqeshin. Nga njëra anë Tetova, Gostivari, Kërçova dhe Mavrova, nga ana tjetër, Resnja, Ohri, Struga dhe Pogradeci, ranë në duart e ushtrive serbe.

Për t'i shpëtuar terrorit serb, me mijëra shqiptarë të këtyre viseve, braktisën shtëpitë e tyre dhe vrapuan drejt perëndimit, disa nga të cilët prunë në Dibër edhe lajmet rrëqethëse të masakrave të armikut. Përshtypje të thellë la sidomos terrori që kryen ushtritë serbe në Reçan pranë Gostivarit, ku pasi pushkatuan 75 burra, dogjën të gjallë me tepër se 200 gra dhe fëmijë të mbyllur prej tyre në dy shtëpi të fshatit. Përshtypje la po ashtu barbarizma që ato kryen në fshatin Simnicë, ku gratë, para se të pushkatoheshin, u përdhunuan në mënyrë çnjerëzore prej ushtarëve serbë. Së bashku me lajmet mbi mizoritë serbe, në trevën dibrane u përhap edhe paniku. Sidomos nga frika e çnderimit të grave dhe e masakrimit të fëmijëve, me mijëra familje dibrane, duke parë afrimin e ushtrive serbe, lanë fshatrat e tyre dhe pa vënë re as laçkë, morën rrugën nëpër Çermenikë drejt Elbasanit ose në për Mat drejt Tiranës. Mungesa e organizimit dhe përhapja e panikut e dobësuan rezistencën shqiptare, gjë që e shpejtoi përparimin e ushtrive serbe. Më 5 tetor 1913 Shehri ra. Pasi dogjën dy lagje të jashtme të qytetit (lagjet Hame dhe Krifon), ushtritë serbe u vunë zjarrin fshatrave të afërta – Vojnik (44 shtëpi), Koniarë (20 shtëpi), Sollokiq (10 shtëpi), Spas (32 shtëpi), Bllatë (66 shtëpi), Majtarë (28 shtëpi), Reshan (10 shtëpi), Allajbegi (82 shtëpi), Maqellarë (40 shtëpi), Gllobocisht (38 shtëpi), Kolloçisht (32 shtëpi), Çernen (28 shtëpi). Kolona të tjera serbe iu turrën nga të dy anët Gollobordës, ku dogjën Trebishtin (650 shtëpi), Borovën (90 shtëpi), Sebishtin (121 shtëpi), Ostrenin e Madh (152 shtëpi), Ostrenin e Vogël (95 shtëpi), Radovishtën (40 shtëpi), Vladimericën (60 shtëpi), Tushepin (45 shtëpi), Ostyishanin (51 shtëpi), Xhepishtin (0 shtëpi), Okshtunin (120 shtëpi), Klenjën (120 shtëpi), Steblevën (177 shtëpi), Zabzunin (150 shtëpi) dhe Leserin (25 shtëpi). Pastaj forcat e armikut depërtuan nëpër Grykën e Madhe dhe më tej nëpër fushën e Bulqizës derisa dolën në Qafën e Buallit, në kufi me Matin.

Me gjithë pushtimin e Dibrës së Epërme, malësorët e Dibrës së Poshtme nuk u demoralizuan, përkundrazi u përgatitën për rezistencë. Elez Isufi, i cili ato javë ndodhej në zonën e Shkodrës për të luftuar kundër ushtrive serbe e malazeze që mbanin të okupuara viset veriore, u thir menjëherënga malësorët e vet për të luftuar së bashku me ta. Por Elezi nuk arriti në kohë, sepse ngjarjet rrodhën me shpejtësi. Në fillim të nëntorit 1913, ndërsa ushtritë serbe filluan marshimin e tyre nga Shehri drejt Peshkopisë, të tjera reparte serbe, duke ardhur nga veriu përmes Lumës, i sulmuan befasisht malësorët prapa krahëve. Edhe këtu pa armatime dhe pa organizim, malësorët, të ndodhur midis dy zjarreve, u thyen. Megjithatë në Dibrën e Poshtme, nën kontrollin serb, hyri vetëm pjesa e saj lindore.

Një bilanc jo të plotë të mizorive që kryen serbët në trevën dibrane gjatë fushatës që ata ndërmorën në vjeshtën e vitit 1913 është renditur në një raport hartuar nga një ambasador i huaj, të cilit nuk i thuhet emri. Themi jo të plotë, mbasi në raport nuk përmenden mizoritë e kryera në krahinën e Gollobordës.

veprimtari

Lura dhe njerezit e saj kanë luajtur një rol të rëndësishëm në të gjitha epokat historike të Shqipërisë. Është Lura e "300 duvakëve", është Lura e dom Nikoll Kaçorrit dhe rolit të tij në shpalljen e pavarësisë

Lura po vendoset në vendin që i takon **në historinë** dhe kulturën shqiptare

Nga prof. dr. **ADEM BUNGURI**

Sot është një ditë e veçantë për Lurën, hyjneshën tonë të bekuar nga Zoti dhe të nderuar nga Presidenti I Republikës me titullin e lartë "Nder i Kombit". Lura për të cilën at Gjergj Fishta shkruante se "kush nuk ka pa Lurën nuk njeh Shqipërinë", Lura që me bukuritë e saj natyrore, tërhoqi vëmendjen e Ms. Edith Durham, që e cilëson atë si "një fushë e bukur, që kurrë nuk kishte parë në asnjë vend të Ballkanit". Është Lura e dom Nikoll Kaçorrit, N/Kryetar i Qeverisë së pare shqiptare të Ismail Qemalit, Lura e luftës së Qafë Gëlqeres (Lan-Lurë), e 100 viteve më parë, kur bashkë me luftëtarët dibranë të Çidhnës, Reç e Dardhës dhe Ujë-Mujës thyen forcat serbo-jugosllave dhe ndaluan daljen e tyre në Adriatik. Bajraku i Lurës është i njohur në historinë e Shqipërisë për trimërinë, qëndresën, bujarinë si edhe për modelin e përkryer dhe të rrallë të tolerancës fetare.

Lura të befason dhe të mrekullon me bukuritë magjepse të natyrës së saj, me pishat qiellgërvishtëse dhe liqenet e magjishëm.

Lura ruan një trashëgimi të pasur arkeologjike, historike, kulturore dhe shpirtërore dhe ka patur një rëndësi të veçantë gjeo-strategjike në të gjitha periudhat historike. Të dhënat arkeologjike mbi Lurën, kanë dëshmuar banimin e kësaj zone në periudha të rëndësishme prehistorike dhe historike, duke filluar që nga Bronzit i Vonë, shek. XII-IX para Kr.

Prof. Eqrem Çabej duke u marrë me etimologjinë e fjalës "Lurë", mendon se ky emër është një toponim i formuar me lëndë vendi, vjetërsia e të cilit shkon deri në shek. VI pas Kr.

Prof. K. Frashëri beson se emri "Lurë" përfaqëson emrin e dikurshëm antik të së ashtuquajturës "Iliria e shkretuar" dhe



"Nderi i Kombit" vjen per Lurën në një moment të rëndësishëm kthese, dhe na kujton e detyron të gjithëve të punojmë më shumë për Lurën, për ta rikthyer atë në vendin që i takon në historinë dhe kulturën shqiptare, për ta bërë atë një "Zvicër" të vogël brenda Shqipërisë.

mendon se rrjedh nga emri i fortesës së shek. VI pas Kr. "Illyrin", e rindërtuar nga Justiniani në Epirin e Ri.

Gjatë periudhës së vonë antike, në Lurë ndërtohet nga Bizanti kalaja e Tytyrës, që ruan emrin e saj siç përmendet nga burimet (Tythyra-Prokopi Cezaresë). Që nga periudha antike, Lura ka shërbyer si një rrugëkalim i rëndësishëm strategjik për lidhjet Dibrës me Mirditën dhe pellgun Lezhë-Shkodër.

Në periudhën mesjetare, Lura ishte një prapavijë e sigurtë e Skënderbeut, dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetje të luftës së tij epokale. Gjetja e zgjyrës së hekurit në qytetin e Livadhit të Xharrit, hedh dritë mbi ekzistencën e metalurgjisë lokale dhe punimit të metaleve dhe konfirmon legjendën, sipas të cilës "në Lurë farkëtoheshin armët e ushtrisë së Skënderbeut". Ndërkaq, "Fusha e Pelave" në rolin e një grand hipodromi, konfirmon stërvitjen aty të kalorësisë së ushtrisë së Skënderbeut.

Lura dhe njerezit e saj kanë luajtur një rol të rëndësishëm në të gjitha epokat historike të Shqipërisë. Është Lura e "300 duvakëve", është Lura e dom Nikoll Kaçorrit dhe rolit të tij në shpalljen e pavarësisë, është Lura e Ibrahim Gjoçit dhe Hakik Menës, është Lura e trimërisë dhe e Gjok Doçit.

Lura në këto 30 vite ka qenë pothuajse e braktisur. Por tani ka një lëvizje për ta rikthyer nderin dhe dinjitetin e saj në vendin që i takon. Ka një përpjekje të të rinjve për ta pyllëzuar dhe një lëvizje për ta gjallëruar ekonominë dhe turizmin në këto treva.

"Nderi i Kombit" vjen per Lurën në një moment të rëndësishëm kthese, dhe na kujton e detyron të gjithëve të punojmë më shumë për Lurën, për ta rikthyer atë në vendin që i takon në historinë dhe kulturën shqiptare, për ta bërë atë një "Zvicër" të vogël brenda Shqipërisë.

** Fjalë e mbajtur më 16 nëntor 2021, në ceremoninë e dekorimit të krahinës së Lurës me titullin e lartë "Nderi i Kombit". Titulli është i redaksisë.*

Ky ambasador, thuhet në raportin e tij, e vizitoi vetë trevën e Dibrës pasi u shtyp kryengritja e shtatorit 1913 dhe fill pasi qeveria e Beogradit shpalli gjoja amnistinë për pjesëmarrësit e kryengritjes në tetor 1913. Këtë dokument ambasadori ia përcolli më 19 dhjetor 1913 qeverisë së njërës prej fuqive të mëdha. Dy ditë më vonë, më 21 dhjetor 1913, raporti i këtij ambasadori u botua në përkthimin italisht në gazetën italiane "Corriere delle Puglie". Në këtë raport janë regjistruar si emrat e fshatrave të djegura, ashtu edhe ato të banorëve dibranë të masakruar barbarisht nga ushtritë serbe. Përmenden vetëm krimet e kryera në fshatrat e trevës dibrane që ata shkelën gjatë operacionit ndëshkimor në shtator 1913. Të dhënat që përmban raporti i përmendur deri sot nuk janë vënë në dyshim. Si rrjedhim, ato konsiderohen të vërteta. Madje, dyshohet se numri i dibranëve të vrarë gjatë këtij operacioni mund të ketë qenë më i madh. Sidoqoftë, edhe kjo listë mjafton për t'u bindur mbi mizoritë e kryera nga ushtritë serbe.

Lista e krimeve fillon me fshatin Klos të Matit, pikërisht në hyrjen e trevës dibrane. Pastaj vazhdon në Dibrën e Epërme: Valikardhë, Pilat, Krajkë, Sergjen, Sopot, Shehër, Gjoricë, Homesh, Shupenzë, Hokshatin, Topojan, Kovaçishtë, Gjoricë, Golevishtë, Kërçishtë, Bllacë, Zogaj, Maqellarë, Pocest, Kërçishtë e Poshtme, Çernen, Bllatë, Spas, Gllobocishtë, Poçistë, Obok, Pesjak, Erebarë, Vojnik, Allajbegi, Dovalan, Çakë, Kovaçisht, Majtar, Bllatë e Epërme, Bllatë e Poshtme, Leshan.

Në Dibrën e Poshtme: Bardicë, Zimur, Staravec, Bahutaj, Tomin, Dohoshisht, Zagrad, Bellovë, Grazhdan, Muhurr, Luzni, Cetush, Brezhdan, Ushtelenzë, Deshat, Sohodoll, Borovjan, Rashnopojë, Cerjan, Pilaf, Pilaf Mëhallë, Pollozhan, Gliçë, Limjan, Peshkopi, Trepçë, Çidhën, Sinë, Venishtë, Trojak, Dupjak, Sllatinë, Velesh, Kallë, Sllovë, Dardhë, Reç, Shumbat, Palaman.

Raporti i ambasadorit të huaj përfundon me këtë sintezë: "Kështu vazhdon historia e masakrave të tmerrshme me një listë rrëqethëse që krijon martirologu i popullit të ri shqiptar dhe nga njoftimet e plota të masakrave të kryera në vende të tjera të Shqipërisë Veriore. Bëhet fjalë për skena kusarie të egra, për akte hajdutërie mizore, për vepra të vazhdueshme shfarosjeje dhe vdekjeje. Shumë u dogjën, të tjerë u therën, të gjithë u desh të shkonin drejt vdekjes më të tmerrshme.

"Nga pasojat e kërdisë kuptohet se populli shqiptar, i etur për liri, me dëshirën për t'u ndriçuar nga një diell i ri i shndritshëm qytetërimi, për një periudhë të shkurtër kohe u përgjysmua në një nga krahinat e tij më të banuara dhe më të pasura. Fshat që natyra e shpërbleu me një pjellori të lakmueshme, u shkretua plotësisht dhe kështu tani përpara syve të vizitorit shtrihen zona të tëra plotësisht të zhveshura, të shkrumbuara nga zjarri shkretues, të shkatërruara nga vepra e pamëshirshme e armikut".

Raporti shton:

"Sipas shumë shqiptarëve, qëllimi i serbëve ishte që të shkatërronin me anë të sundimit të terrorit tyre gjithë popullin shqiptar që banonte në territorin që Serbia donte ta bënte të vetin, për t'u treguar përfaqësive të Fuqive të Mëdha të drejtën e aspiratave të saj dhe mosqenien e çdo të drejte, privilegji nga ana e Shqipërisë. Kështu, Serbia donte të tregonte se në territorin e Shqipërisë Veriore nuk kishte banorë shqiptarë ose se ata ishin të pakët".

Nga frika e një kryengritjeje të re shqiptare, autoritetet serbe shpallën një gjoja amnisti për pjesëmarrësit e kryengritjes, në të njëjtën kohë nevoja që kishin për një situatë të qetë në këto anë, i nxiti qeveritarët e Beogradit që ta detyronin me anën e terrorit popullsinë dibrane të shpërngulej nga vatrat e saj. Nga frika e shpërthimit prej Beogradit të një vale të re gjenocidi me mijëra familje të tjera u larguan nga treva e Dibrës dhe si muhaxhirë morën rrugën drejt Shqipërisë qendrore.

Sipas vlerësimit që jepnin qarqet shqiptare të kohës, numri i muhaxhirëve shqiptarë të shpërngulur nga viset e pushtuara prej serbëve arriti në fund të vitit 1913, në afërsisht 35 mijë vetë, nga të cilët rreth 20 mijë ishin dibranë. Shumica e tyre u vendos në Elbasan dhe në Tiranë, ndërsa të tjerët u shpërndanë në Çermenikë dhe në Mat. Muhaxhirët dibranë u pritën kudo me ngrohtësi nga popullsia vendase, e cila me gjithë varfërinë e saj të thellë, e ndau me ta bukën e gojës. Por vendi nuk kishte rezerva ushqimore, madje parashikohej që në Çermenikë dhe në Mat, tragjedia e shpërnguljes të kthehej në një kalamitet ekonomik, të pllakoste zia e bukës.

vijon në numrin e ardhshëm

Veprimtaria jubilare për 100 vjetorin e fitores së Dibrës ndaj pushtuesve serbë më 1921

Më 20 tetor 2021, në një nga sallat e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë në Tiranë u mbajt një tubim organizuar nga Unioni i Shoqatave të Bulqizës (Bulqizë, Grykë e Vogël, Grykë e Madhe, Gollobordë e Martanesh). Veprimtaria kushtuar 100 vjetorit të luftës 9 vjeçare të Dibrës(1912-1921) u mbyllën me një sesion Jubilar me tematikë historike.

Morën pjesë qytetarë nga Bulqiza, intelektualë e studiues të historisë nga trevat e Dibrës, Bulqizës, Gollobordës e Martaneshit.

Eva Gjura moderoi punimet e sesionit Jubilar.

Referatin: "Lufta e dibranëve ndaj pushtuesve serbë u shtri në çdo krahinë me qëndresë popullore heroike, që arriti të çlirojë Dibrën nga pushtuesit" e mbajti prof. as. dr. Bajram Xhafa.





Pas referatit u mbajtën disa trajtesa si:

1."Taktika e luftës popullore që u zbatua në vitet 1912-1921 e mposhti ushtrinë sërbe më të armatosur dhe me organizim shtetëror" u trajtua nga Gjeneral (R) Bardhyl Hoxha bashkëautor me z.Sakip Cami.

2."Për qendresën e Buqizës për mbrojtjen nga pushtuesit sërb (1912-1921" foli z.Bashkim Lami.

3.Doktor Adriatik Balla foli "Për rolin e Bulqizës në thyerjen e planeve serbe në vijën strategjike gjatë luftës Dibrës(1912-1921)".

4 Z.Ilir Puca kumtoi "Për organizimin e Grykës Madhe në luftrat me pushtuesit serb".

5."Për qendresën e Grykës së Vogël ndaj pushtuesve serb 1912-1921" foli z. Zabit Lleshi.

6.Mr.sc.Rezana Hysa paraqiti trajtesën:"Veprimtaria patriotike e Mersim Demës në vitet 1912-1915".

7.Prof.Asc.Dr. Teki Kurti foli "Martaneshi, vatër e rezistencës dhe qëndresës në luftë për liri dhe pavarësi Kombëtare".

8."Nëpërmjet një video nga Londra, Mehmet Hasani u paraqit me trajtesën"Golloborda dhe qëndresa e saj në vitet 1912-1921".

Për realizimin me sukses të kësaj veprimtarie ndihmoi shtëpia botuese "Print Al" me administrator Arjan Lamin, i cili përgatiti banerat me foto të patriotëve dibranë, të vendeve ku u zhvilluan luftimet e vullnetarëve dibranë kundër ushtrisë serbe etj.

Po kjo shtëpi botuese botoi edhe një libër të veçantë me të gjitha materialet e paraqitura në sesionin shkencor.

Sponsorizues të kësaj veprimtarie ishin trashëgimtarët e patriotit Mehmet Duriçi nga Bulqiza. Ato kishin sjellë nga Bulqiza një grup të rejash të veshur me kostumin kombëtar të zonës së Bulqizës. Këngëtari dibran Dritan Jashari, këndoi për të pranishmit këngë dibrane për Elez Isufin e Mersim Demën.

Takimin e përshëndeti edhe prof. Enver Hysa. Ai vlerësoi punën organizative, të ligjëruesve, të gjithë ata që ndihmuan për realizimin e kësaj veprimtarie mbresëlënëse me karakter atdhetar.

Korresp. "Rr.A."

Rruga e Arbërit nr. 183

Ulem nën hijen e disa lisave të vegjël, që dikush i ka shpëtuar nga sëpata, për t'u shërbyer njerëzve. Mrekulli.

përshkrim

Udhëtim përgjërues peizazheve të Pasmarit

Nga **SELMAN MËZIU**

Pasi lë udhën automobilistike Muhur-Peshkopi zbres aty ku dikur ka qenë një liqen. Në disa harta, dhe në kujtesën e brezave të viteve '70 ai ka mbetur ngjyrë kaltër me një digë me gjatësi 244m. Ku fëmijët e atyre viteve, edhe mësonin notin. Ndërsa në gushtin e vitit 2021 ai nuk jeton. Fatkeqësi natyrore?Ndonjë tërmet që plasariti kupën e liqenit me lartësinë mbi det 428m? Apo kuçedrat i piu ujin?

Vështroj me kujdes, si natyralist, si botanist e inxhinier pyjesh, duke kërkuar t'i bëj autopsinë në dritat e kohës. Në pjesën horizontale, pra fundore, ndodhen disa shelgje. Ato janë shkurre lagështidashëse. Edhe në sipërfaqet e pjerrëta kemi shkurre trup shkurtra, por me kurora të gjëra. Trashësia e trupit madhësia e kurorës e biomasa e saj të tregojnë se këtu më shumë se 20 vjet ky liqen është tharë. Edhe bimësia barishtore, veçojmë bargjakun e shelgjeve janë lagështi dashëse në qendrën e ish liqenit pastaj në ngjitje ato fillojnë e thahen. Gjithmonë duke u ngjitur fillojnë kulumbriat, ferrmanat, kumbullat e egra etj. Me sa duket uji i liqenit ka shteruar pak e nga pak ndoshta për nja hark kohor edhe mbi 30 vjeçar. Syri i kaltër këtu rrëzë kodrës sa Pasmarit, në juglindje është qëruar, si ai gjarpri kur mbështjell me trupin e vetë gjahun e duke e shtrënguar e mbyt atë plotësisht, kuptohet veprimet e njeriut e politikat e ndjekura. Në shpatin lindor të tij duken blloku i varrezave të vakufasve. Bashkësi të pa jetë, të pa funksion. Trishtuese.

Lind pyetja, nga çfarë burimesh ujore furnizohesh? Shpjegimi. Njëri vinte nga motopompat të vendosura në shtratin e Drinit me lartësi 382 m. Pikërisht te Kepi i Mane në perëndim të Pasmarit. Ndërsa tjetri vinte nga gjurra e Kumbullës, Gjarec e fshatin Vakuf ku përdorej për ujitje dhe tepricat derdheshin në liqe. Tjetra nga shirat e shpatinave të Pasmarit dhe lagjeve e tokave të vakufasve. Kjo e fundit ka ardhur duke u pakësuar, për rrjedhojë të ngrohjes globale ndërsa të tjerat u zhduken si vepra të komunizmit pas viteve '90 nga fshatarësia përqark.

Filloi të ngjitem shpatit të butë për nga pjerrësia, ndërsa bari i thatë i shumëllojshëm më kërciste poshtë kamëve. Duken aty këtu me lulëza të bardha karrota e egër. Iu afrohem dy mollave me kurora asimetrike. Trupë shkurtra me diametër 12 cm. Njëra kishte një degë të trashë, të tharë, të prerë e lëvore zhveshur. Ngjante shumë me një njeri me dorën cung. Pra të prerë në mes pëllëmbës së dorës dhe bërrylit. Kjo ishte





Vështroj me kujdes, si natyralist, si botanist e inxhinier pyjesh, duke kërkuar t'i bëj autopsinë në dritat e kohës. Në pjesën horizontale, pra fundore, ndodhen disa shelgje. Ato janë shkurre lagështidashëse. Edhe në sipërfaqet e pjerrëta kemi shkurre trup shkurtra, por me kurora të gjëra. Trashësia e trupit, madhësia e kurorës e biomasa e saj të tregojnë se këtu më shumë se 20 vjet ky liqen është tharë.

më fatkeqe,sepse e përshkon një zgavër deri poshtë te rrënjët. Era e veriut iu kishte tharë edhe një numër degësh. Disa molla të rralla kishin shenjat e vrimave të krimbave dhe me shumë njolla. E gjelbërta e gjetheve ishte si e zbehtë. Ato i kishin shpëtuar sëpatave, zjarrit, veprimeve barbareske para jomë shumë se gjashtëmbëdhjetë vjetëve. Tani dergjeshin të vetme në këtë hapësirë të trishtuar, të helmuar nga mosha e tyre, klima dhe njeriu që i ka braktisur.

Ngjitem në Rrafshën e Fierit, siç e kanë emërtuar fshatarët e Kishavecit dhe Rrethkalasit. Nga këtu në lartësinë 442m,më shpalosen peizazhe të shumta me kodra, kodrina, rrafshina lugina të thellësive e formave të ndryshme, magjishëm, poshtë tyre dallohen, lakoret ngjyrë blu të ujërave të lumit Drin, duke e ndarë luginën e Drinit të Zi në dy pjesë pothuajse të barabarta.

Përmes qylymit me fiera të zvenitura, dallohet një udhë e hollë këmbësore, ku toka është e lëmuar, e thatë, anash së cilës ka aty këtu ferrmana e trungje mollësh me lartësi e trashësi të ndryshme, të prera, të djegura ose të shkulura. Peizazhe që të shoqërojnë pa ndërprerje në këtë udhëtim përgjërues, pezmatues, revoltues.

Ndërkohë ndodhem në udhën këmbësore që lidh, bashkon, fshatin Kishavec (vendi i kishave S.M) me atë të Rrethit të Kale emër i ardhur nga fisi Kale që pothuajse nga shekulli i pesëmbëdhjetë banonte në Gjerdhin e Epër ose ndryshe Çurket e Epëra. Pikërisht këtu me lartësi 438 m fillon Lugu i Madhi cili zbret drejt pasqyrës kaltroshe të Drinit në krahun veriperëndimor.

Më parë se të filloi ngjitjen, ndodhem para një kanali gjashtë metrash, me gurë dhe çimento, është pjesa e një kanali që merrte ujit nga motor pompat e vendosura në ujërrjedhjen e Drinit për t'iu dhënë jetë e gjelbërim hapësirave prej 1,7 km² të mbjella me mollë në brezare përgjatë shpatinave dhe në rreshtat e rrafshinave qendrore në formën e një amebe të Pasmarit.

Kërkoi me kujdes të fiksoi gjithçka në këto hapësira të bezdisshme, ku përzihet vdekja, vyshkja me disa relikte të gjelbra të mbetura nga kasaphanat e më shuma se njëzetë vjetëve. Ato kanë prodhuar mollë me



njolla në kurorat e çapëluara, por çuditërisht në formë flamuri. Rezultat i erërave veriore e mbetjes të vetmuara, pa si motrat, të pa mbrojtura, të rëna në luftërat me sëpata, pse jo dhe motosharrave dhe kazmave.

Zbres poshtë një shpatine veshur me barëra të thata ku ngrihet një shtëpi trekatëshe. E vetme. E rrethuar me tela me gjemba. E bardhë me shkëlqim, që të vret në shpirt. Ajo ngrihet në bardhësinë e mbytur të barërave e të ndonjë druri që ka mbetur në kam, si skelet prehistorik. Është ndërtuar nga Ardia Xhelal Pira që punon si kurbetli në Amerikë. Dëshirë për t'u kthyer, apo për të patur një strehë, kur të vijnë si mysafir në dheun e baballarëve. Dëshmi e një drame të hidhur. Pamje që të trishton. Peizazh i vdekur, i mbushur vetëm me ndjenja atdhedashurie, që fluturojnë sipër reve ose dallgëve oqeanike. E ato përplasen në muret e kësaj kulle me oborrin mbuluar me bar të thatë. Dikur këtu ka qenë një lis gjigant. Quhesh lisi i Ali Tahirit (Ali Pira S. M). Edhe ai ka ardhur si legjendë në kohët tona. Plleshmëri legjendash këto troje.

Ndërsa vështrimi më rrokën gjurmët e brezareve, këtyre shpateve që zbresin turrshëm mbi shtratin e përroit të Gjelagjoshit. Në mes tyre jeshillëk i zbehtë, fierash e ferrmanash, sikur të ishim mbjellë nga njeriu. A mendoni se i mbolli fshatari kishavecas? Në një farë mënyre po. Atij si gjithë shqiptarëve ju prishën mentë dhe shkatërruan gjithçka të mbjell që nga viti 1964 me duart e tyre pjellor me kallo të brishta. Përbri tyre u harlisën bimësi e re, molë starking, ranet etj. Kush t'i beson tani këto? Asnjeri.

Pasi kaloj shpatin, ku dëgjohet nën kam, vetëm kërcitja e barit të thatë, ndalem te një kodër në formën e një gjuhëze që zbret aty ku bashkohet zhavorrishtja e përroit të Gjelagjoshit me shtratin, po me këtë përbërje të Drinit. Një lule e madhe ngjitur me tokën me petla me gjemba e me një sy të verdhë, më tërhoqi shikimin, quhet Ushonjëz pa Kërcell. Tregues i tokave të thata, por që dhuron bukuri, si rrallë bimë, lulëzuar në Gusht. Në mbarim të saj kemi Arrat e Gjuri e Rizvan Pirës dhe një lug që del befasisht e quhet Lugu i Loshës.

Pikërisht në zbritje takoi një grup ferrash, dardhë të egër, fidana dushqesh dhe frashër e shkozë. Gjurmë rrethuese muresh. Por shumë pak të dallueshme. Gurë gëlqeror të cilët nuk gjenden në këto anë. Këtu diçka me mure ka qenë ndërtuar. Por se çfarë nuk mund ta përcaktojmë. Duhet të bëhen disa prova gërmimesh, për të pohuar diçka. Ndoshta dikush do të tregoi kujdes për të zbuluar pjesëza të historisë në këto peizazhe me relieve të ëmbla.

Shohim te Lugu i Madh, një djalosh me nja tufë delesh. E quanin Gani Bilbil Pira. Të vetmin bari me dele. E pyetëm rreth toponomistikës. Ai na tregoi disa emra. Ndërsa unë vështroja rrugën automobilistike prej 1140 m që vazhdonte poshtë e lartë luginës. Përfshi me shikimin tim shpatet e saja me njolla bimësie të pa dobishme.

Shikohen në shpate përroska, rrjedhojë e gërryerjeve në faqet e pjerrëta, pa bimësi shkurrore e barishtore. Më zgjon kureshtjen një pamje me një lloji bari kërcell gjatë,me kallëza me ngjyrë kafe të çelur 3-4cm, në një sipërfaqe prej 40 m². Me ndihmën e akademikut Jani Vangjeli i gjej emrin: Belish leshatark. Nuk e kam takuar asgjëkundi. Tregues i një toke të thellë me lagështi pse jo me burime uji.

Duke u ulur poshtë në krahun e majtë, ndodhet Guri i Vashës. Pranë tij një burim uji I ftohtë, sigurisht i pijshëm. Mësuesi im I vitit 1971-'72 Xhelal Meta, më ka treguar se para vitit 1967 këtu bëheshin pelegrinazhe. Vajzat të veshura bukur vinin nga fshatrat përqark, grupe, grupe. Aty gjenin gjilpëra, lanin duar, sy dhe kam, në ujin e burimit dhe i luteshin gurit për fat e mbarësi në jetë. Kjo ishte traditë e lashta e ndjekur, e të gjitha cucave të banorëve për rreth.

Ngjitem në pjesë qendrore të Pasmarit. Hedh vështrimin në të dy anët e e kësaj rrafshine që zgjatet e zgjatet deri në një kodër ku arrin lartësia mbi det prej 453 m, që është edhe më e larta. Kërkoi të gjej prejardhjen e emrit. Pasmarit-pas murit- pas-marinajt. Cilat janë shkaqet e emërtimit? Motivet e vënies së tyre? Di se këtu ka qenë një post turke. Na vitin 1910 trimi Liman Berisha nga Fushë Muhuri sulmoi karakollën e turqve këtu, ku i mbeti në betejë e sipër qeleshja e bardhë. Ushtarët turq erdhën nëpër fshat duke pyeture kujt është kjo kësulë e përgjakur. Një shprehje e urrejtjes popullore kundër sundimit të tejzgjatur turk.

cyan magenta yelloë black



Në këtë kodër në Lugun e Keq, dhe të Lepurit që shtrihen në zbritje përgjatë gjitha relievit të saj janë zhvilluar luftëra kundër pushtuesve turq e serb ndër shekuj. Sepse kjo ka një pozicion të tillë strategjik, të admirueshëm për krahinën e Muhurit, dhe gjithë luginën e Drinit të Zi. Ndërsa ka shërbyer si bazë ushtarake për disa pushtues. Kuptohet kjo ka qenë e veshur me bimësi të ndryshme, shkurre e dushqe. Ka pasur disa burime uji. Quhesh Lugu i Keq se kur ka patur pyje, dëgjoheshin cicërima të shumta zogjsh. Deri në muzgjet e vona.

E ndërsa mbledh me vështrimin tim peizazhet majë malesh kodrinash e shtratin e gjerë të Drinit të zi, veshur me ngjyrën e argjend ta shelgishteve, zhavornajave të bardha e kordelen blu të ujit të lumit Drin, që e përshkon plotë lakore. Këto hapësira gati të pafundme në drejtim verior e jugor,nuk ka se si të mos therin thellë në shpirt, mbytja e tyre, zhdukja në fundin e një liqeni me pamje xholi të frikshëm e plote trishtesë, me emrin Liqeni i Skavicës. Këto peizazhe, mbushës depo mollësh e hambar misëri e fasuleje, do të mbyten. Tokat do të shterpëzohen. Peizazheve do t'iu duken brinjët e thyera me shumë plagë me pamje të dhimbshme, rrëqethëse.

Kështu mendueshëm hedhë hapat me përtesë, zbres udhës automobilistike që të shpien te rrafshina ku do të ngrihet një shtyllë elektrike tridhjetëmetërshe pothuajse buzë Drinit. Si motrat janë ngritur shpateve të pjerrëta të Pasmarit që shikojnë nga krahu perëndimor. Janë shfaqur shenjat e para të gërryerjeve në sheshet e tyre dhe udhën e makinave. Me kalimin e viteve do të sjell gërryerje të fuqishme në kohë e hapësirë. Plagë të shumta do t'iu hapen. Fatkeqësisht. Askush nuk kujdeset. Askush nuk e përfytyron.

Ulem nën hijen e disa lisave të vegjël që dikush i ka shpëtuar nga sopata, për t'iu shërbyer njerëzve. Mrekulli. Nga këtu vështroi lagjen Vajmdhej në formë gjysëm hane të ndezur. Buzëdrinit, me arat që jeshilojnë nga misrat, kopshtijet, pemët frutore, ngjitur me shtratin e tij. Nga ana veriore po në gjysëm hane drapërore, shtrihet fshati Rreth Kale me lagjet Doçe, Mane, Dishe, Sine, Kulle dhe Lace etj. Në mes gjelbërimit dallohet si zgavër e ndonjë dinosauri gjigant, një shtëpi dy katëshe, që i kanë mbetur vetëm muret rrethuese me dritare katrore si sy të nxjerrë kupthin, në mes gjelbërimit të pa anë. Plagë të tilla në fshatrat përqark janë të shumta.

Zbres me vështrimin tim drejt ranave të këtij fshati, prodhuese me bollëk të misrit e fasuleve, kufizuar me shelgje e marinat me zhurishtet e shtratit të Drinit. Befas m'u kujtua një bisedë me Xhemal Islam Mëziun ku më tregonte: ''Ishte 23 gusht 1957, dibranët festonin ne mes pyjeve me shelgje e verrinj, këtu. Sakaq u ndezën llambat e para elektrike. Ato i prodhonte hidrocentrali në grykën e lumit Murra. Dinamoja prodhonte korrent nga ujët e Vijës së Zallit,duke kaluar nëpër tuba dhe goditur fletët e çelikta. Ajo u ndërtuar rreth fillimeve të shekullit të njëzetë. Hidrocentralit të vogël ka vite që nuk i gjendet as nami as nishani. Çuditërisht një lloj si dhe peizazheve me molla të kodrës gjoks gjerë të Pasmarit.

14. 11. 2021

MULLIRI



Fotografia nga: Sadrian RAMA

Nga dr. **BESNIK RAMA**

Për të shkuar në mulli, pasi të dilje nga fshati, duhej të merrje një të tatëpjetë që kishte vetëm dy segmente pak të rrafshëta. Vajtja në mulli ishte një nga kënaqësitë fëminore.

Gëzimi fillonte të pakën një ditë para kur në shtëpi bëhej gati drithi që duhej bluar dhe na dërgonin në lagjen tjetër te shtëpia e të zotit të mullirit, që të pyesnim do të kishte shumë radhë apo jo në mulli të nesërmen. Ktheheshim me një frymë dhe fjala e parë që u thoshim, ishe: Do vijmë edhe ne në mulli. Na tërhiqte shumë ai mjedis buzë zallit me ujë të zhurmshëm. Rrjedhën e ujit e dëgjonim që nga kodrina e lartë nga zbrisnim. Kjo na e shtonte padurimin për të ecur më shpejt, gati me vrap. Veçse, kur i afroheshim mullirit, nuk ecnim para; si me marifet, i hapnim rrugë nënës apo gjyshes.

E di që jeni gati të pyesni: Çne gjithë ky zell e ky gaz për të shkuar në mulli? Bëni durim. Gjyshet e gjyshërit dhe nënat na vinin në gjumë duke na kallëzuar përralla çdo natë. Një pjesë e atyre përrallave lidhej me mullirin.

Arsye tjetër që ta tërhiqte shumë ai vend, ishte natyra e bukur e asaj pjese buzë zallit ku ishte vendosur mulliri. Arsye tjetër ishte se ndërronin mjedis, dilnim nga lagjja, nga fshati, nga monotonia e përditshme. Arsye mbi arsyet ishte fantazia që na ngjallnin përrallat, bindja se një ditë prej ditësh do të takonim në mulli personazhet e përrallave që kishim për zemër, si, fjala vjen, shtojzovallet, të cilat na dilnin në ëndërr jo pak herë.

Sapo zinim vend pranë vartës së mullirit, pasi trembnim frikën brenda vetes, rrinim gjithë sy e veshë. Rikujtonim ngjarjet e përrallave dhe soditnim cep më cep mullirin duke pritur kot të na shfaqeshin xhindet (dhe vetvetiu ngjiteshim pas gjyshes), e bukura e dheut (hop, buzëqeshnim), shtojzovallet (ngriheshim se mos i shikonim vërtet në hatullat e mullirit), vajza e bukur jetime (e dërguar nga njerka që ta hanë xhindet), e bija e njerkës (në kërkim të fatit ,siç i buzëqeshi jetimes) etj. A i dilnin mullisit? A bisedonin me të? Si nuk kishte frikë ai, sa herë e zinte nata vetëm? Me se ushqeheshin? Si e përballonin dimrin? Në cilat hatulla rrinin shtojzovallet dhe në cilat xhindet? Apo kalonin natën në mulli cila palë vinte e para? Apo e bënin me radhë? Gjithë këto fantazi na ndërpriteshin sa hap e mbyll sytë, sapo ndonjë hardhucë ia fuste vrapit nëpër trarët mbi kryet tona. Trembeshim se mos binte mbi ne. Na dridhej gjithë trupi kur kalonte me shpejtësi ndonjë nga minjtë e mëdhenj të mbingopur me miell.

Natyra përreth mullirit ishte një botë më vete. Në të dy krahët ishte livadh. Ai buzë zallit thuajse i rrafshët, ndërsa tjetri i pjerrët, mbjellë me pemë të ndryshme: mollë, kumbulla, kajsia, qershi, arra, thana, të cilave u rrinin kacavarur hardhitë e rrushit gjithfarëlloj. Prapa mullirit gjarpëronte jazi, hendeku i vogël që sillte ujin në mulli për të rrotulluar mokrën. Jazi nuk ishte i thellë, megjithatë, të rriturit kujdeseshin që të mos kalonim përbri tij vetëm. Kishin frikë mos pengoheshim e na merrte rryma. Të rriturit nuk e dinin se vetë ne kishim më shumë frikë nga jazi.

Sa herë ndodhte të dilnim për luleshtrydhe, ndërkohë që bluhej drithi, ne peshonim me trup nga e kundërta e jazit, se shtegu ku vinim këmbët, ishte shumë i ngushtë. Por na ndodhte më keq seç e mendonim. Rrëshqitnim nga pjerrësia dhe këmbët na binin në jaz, lageshim deri nga mesi e mezi ngriheshim të qullur në rrugicën e ngushtë, ose na ngrinte "roja" që na vite pas, duke mos kursyer "këshillat" për të mos lëvizur vetëm. Një peizazh argëtues ishin shelgjet e vjetra që, nga mosha, ishin përkulur e rrëzuar mbi zall dhe ngjanin si ura për të kapërcyer nga njëra anë në tjetrën.

Ndodhte që trungjet e shelqeve t'i shtronin kalimtarët, sepse, për të shkuar në fshatrat e tjera pas kodrinës së lartë gati sa një mal, duhej të kapërceje zallin patjetër. Në verë ishte shumë e lehtë kjo, sepse zalli gati shterej, se një pjesë e ujit të tij merrej në disa segmente për ujitje. Në vjeshtë e dimër, moti me shira e dëborë bënte të vetën: e frynte zalli dhe nuk guxonte njeri t'i futej në këmbë se e merrte bashkë me gurët e drurët që i rrokulliste nga mali. Në pranverë, ne i shkelnin shelgjet disa herë dhe nuk linim degë e gjethe pa soditur në kërkim të ndonjë foleje me vezë apo zogj. Nëse nuk gjenim aty (sa e sa të tjerë mund të kishin bërë të njëjtin kërkim para nesh), i futeshim shpatit plot lisa e thana, të sigurt se nuk do të dilnim pa sukses.

I zoti i mullirit quhej Bale, një burrë shtathollë, i mprehtë në fytyrë, me mjekrën që e hiqte rrallë. Tek ai, thinjat e kokës plotësoheshin nga ato të fytyrës. Nga veshja dukej i varfër (se kush ishte i pasur në ato vite, sidomos në fshat!), por ishte shumë fisnik. Fliste shumë ngadalë e me zë të ulët, edhe pse mulliri, kur ishte në punë, bënte një zhurmë shurdhuese, uji lëvizte mokrën, kurse fleta e drunjtë që me krak-krak-un e saj tregonte ritmin e rrotullimit të mokrës. Nuk jam shumë i zoti të ndaj: Mullisi ishte personazh i vërtetë e i plotë i përrallave, apo e kishin futur në përralla gjyshet tona. Portreti i tij ngjante si dy pika uji me mullixhinjtë e përrallave.

Balja punonte privatisht, e kishte mullirin të tijin. Kur nuk kishte për të bluar, pushonte mullin, por vetë nuk pushonte. I gjente punë vetes. Sa herë e gjenim duke përgatitur bishta veglash bujqësore, duke mbledhur kumbullat e rëna përtokë, ose duke gdhendur me çekiç e daltë mokrën e re. Nuk pashë qoftë dhe një herë që të merrte lekë për bluarjen e drithit. Atij që bluante, i mbante ujem miell të bluar ose drithë në një masë të caktuar për çdo kosh mulliri.

Gjithë sa përshkrova, janë vetëm copëza të asaj moshe fëmijërie të kaluar në fshat. Edhe kur të mos jetë mulliri aty, imazhi i tij është i gdhendur në kujtesën tonë, se atë botë të pasur e ruajmë siç e jetuam, kur e jetuam, me të mirat e me mungesat që kishte.

Rruga e Arbërit nr. 183

"Faik Shatku, sëbashku me figurat dhe personalitetet e tjera juridike të kohës, do të mbahen mend si juristët e parë të cilin njihnin më së miri praktikën juridike të së drejtës së krahasuar dhe legjislacionet evropiane të kohës"

veprimtari

"Historia Shatku", dokumentari historiko-biografik prezantohet në Muzeun Historik Kombëtar

Presidenti Ilir Meta nderoi z. **Faik Shatku - Dibra** me ***"Dekoratën e Artë të Shqiponjës"***, **Dalip Rusin** dhe **Ali Pustinën** me titullin ***"Kalorës i Urdhërit të Flamurit";* Ibrahim Jegenin** me titullin ***"Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut";*** si dhe **Hasan Bakiun** dhe **Gëzim Ostreni** me titullin ***"Për Merita të Veçanta Civile".***



Nga **TOFIK JEGENI**

Në kuadër të Ditës së Pavarësisë dhe Flamurit Kombëtar, shoqata "Bashkësia Dibrane", në bashkëpunim me Radio Televizionin Publik Shqiptar, promovoi me ditën e mërkurë me datë 23 nëntor 2021, në sallën kryesore të Muzeut Historik Kombëtar, dokumentarin premierë historiko-biografik, kushtuar disa personaliteteve të periudhës së Republikës dhe Mbretërisë Shqiptare, me skenar dhe regji nga gazetari Genc Ymeraj, me titull: "Historia Shatku".

Të pranishëm në aktivitet ishte Presidenti i Republikës së Shqipërisë, shkëlqesia e Tij, z. Ilir Meta.

"Është shumë e rëndësishme ruajtja dhe promovimi i vlerave dhe kontributeve atdhetare dhe patriotike të qarkut të Dibrës si një ndër krahinat me kontribute të jashtëzakonshme në ruajten e integritetit, sovranitetit por edhe të shtetformimit të Shqipërisë. Padyshim familja Shatku dhe përfaqësuesit e saj ashtu si dhe shumë familje të tjera të shquara dibrane kanë një kontribut të rëndësishëm në të gjithë këtë histori", tha Presidenti i Republikës në përshëndetjen e tij.

Më pas Presidenti Meta dekoroi, me dekorata dhe tituj, disa personalitete dhe figura patriotike.

Faik Shatku u dekorua pas vdekjes me "**Dekoratën e Artë të Shqiponjës**", me motivacionin: ***"Në shenjë vlerësimi për kontributin e tij të dalluar për shtetin Shqiptar, në plejadën e pare të fillimit të shekullit XX. Në një serë detyrash, si përfaqësues i Këshillit të Shtetit, në jetën Parlamentare, në çështjet e arsimit kombëtar, si dhe pjesëtar në komisionet për hartimin e korpusit juridik funksional i cili mban gjallë edhe sot, vlerat e traditës juridike Shqiptare."***

Me titullin "**Kalorës i Urdhërit të Flamurit**" u dekorua **Dalip Rusi** (pas vdekjes), me motivacionin: ***"Në vlersim të kontributit shumë të çmuar dhe patriotik, si pjesë dhe organizator i Kuvendit të Pejës dhe Kryengritjeve patritike të Dibrës dhe trevave të saj, për liri dhe deri në shpalljen e pavarsisë kombëtare."***

Me titullin "**Kalorës i Urdhërit të Flamurit**" u dekorua pas vdekjes edhe **Ali Pustina**, me motivacionin: ***"Në vlerësim për rolin dhe kontributin e tij si organizator dhe pjesëmarrës i kryengritjeve antiosmane e antiserbe gjatë shekullit XX, në Dibër dhe trevat e saj. Përfaqësues i grupit që përkrahu lëvizjen kombëtare për liri e pavarësi. Anëtar i Klubit patriotik "Bashkimi Dibran";***

Me titullin **"Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut"** u nderua **Ibrahim Jegeni** (pas vdekjes), me motivacionin: ***"Në shenjë vlerësimi për kontributin e tij, si pjesëmarrës dhe organizator i shumë aktiviteteve patriotike dhe kombëtare, pjesë e klubit "Bashkimi Dibran", lëvizje e cila ndikoi në gjallërimin e ndjenjës dhe vetëdijes kombëtare."***

"Për Merita të Veçanta Civile" u nderua **Hasan Bakiu** (pas vdekjes), me motivacionin: ***"Në vlerësim të kontributit të shquar në përpjeke për zgjimin kombëtar përmes librit dhe dijes, si dhe një ndër personalitetet e njohura, i cili hapi dhe librarianë e parë në Tiranë. Anëtar i klubit patriotik "Bashkimi"***

Një vlerësim nga Presidenti i Republikës ishte edhe për z. **Gëzim Ostreni**, i cili u nderua ***"Për Merita të Veçanta Civile",*** me motivacionin: ***"Në vlerësim pë kontributin e tij tepër të spikatur dhe të vyer, si drejtues i mjaft veprimtarive dhe studimeve shkencore ne fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare dhe si pedagog i shkencave strategjike. Hartues i disa traktateve shkencore mbi genocidin serb dhe maqedonas, tek Shqiptarët e trevave Shqiptare, e në veçanti në Dibër të Madhe."***

Të pranishëm të tjerë në aktivitet ishin, Ministri i Drejtësisë, i Republikës së Shqipërisë, z. Ulsi Manja, i cili foli mbi figurën dhe personalitetin e ish-Ministrit të Drejtësisë së periudhës së Mbretërisë Shqiptare, Faik Shatku.

"Nuk është e rastit që sot jemi mbledhur në këtë aktivitet jubilar, mbi promovimin e dokumentarit dhe librit, kushtuar disa personaliteteve të familjes Shatku, ku unë do të spikasja figurën dhe personalitetit e një prej plejadës së juristëve të parë, të cilët studiuan jashtë atdheut, e pas diplomimin u rikthyen në Shqipëri, të japin kontributin e tyre, në shtetin e porsa ngritur Shqiptar. Një ndër to ishte dhe Faik Shatku i njohur disa here në shkresat zyrtare e dokumentet e kohës dhe si Faik Dibra", tha në fjalën e tij Ulsi Manja, Ministri i Drejtësisë.

"Faik Shatku, sëbashku me figurat dhe personalitetet e tjera juridike të kohës si: vëllezërit Ivanaj, Milto Tutulani, Agjah Libohova, Dhimitër Berati, Mehdi Frashëri, si dhe Thoma Orollogaj, do të mbahen mend si juristët e parë të cilin njihnin më së miri praktikën juridike të së drejtës së krahasuar dhe legjislacionet evropiane të kohës. Ishte ky hapi më i rëndësishëm që ato hodhën me kalimin nga sistemi otoman i jurisprudencës në sistemin romano-gjermanik, ku sundoi fryma perëndimore e kuadrit ligjor, e cila vlerësohet dhe sot nga kritikët ligjor dhe juristët e dalluar".

Duke folur për Faik Shatkun, Manja tha se "si jurist i njohur, këshilltar i ministrit të Drejtësisë, sekretar i përgjithshëm, e më pas ministër i Drejtësisë, Faik Shatku u mor gjerësisht me përthithjen e legjislacionit modern europian dhe përafrimin e sistemit gjyqësor shqiptar me ato të tipit francez, italian dhe gjerman".

"Rol të rëndësishëm në zhvillimin e drejtësisë penale shqiptare kanë luajtur dhe lidhja e një sërë marrëveshjesh e konventash kundër kriminalitetit, ekstradimit, dhe përmirësimit të sistemit penitenciar në Shqipëri, në atë kohë. Ndërsa përsa i përket parandalimit të kriminalitetit në shoqërinë e kohës, i përmbahej formulës shërim dhe parandalim, si dhe drejtësi restauruese."

Manja përmendi edhe personalitete të tjerë dibranë të kohës, të cilët patën ndikim në jetën politike të kohës.


"Duhet vlerësuar edhe kontributi i ligjvënësve dibranë në jetën parlamentare, e senatorëve të viteve 1920-1940 me figura dhe personalitete të spikatura të jetës politike të vendit si: Jashar Erebara, Fiqiri Rusi, Abdurahman Dibra, Hafiz Xhemali, Qamil Pepa, Ymer Strazimiri, Faik dhe Izet Shatku Dibra etj."

Manja ftoi familjarët e figurave dhe personaliteteve të shquara të jurispundencës shqiptare, që vitin pasardhës, në kuadër të 110 vjetorit të shpalljes së pavarësisë dhe fillesave të shtetit Shqiptar, të pasqyrojnë në hollin e muzeut të Ministrisë së Drejtësisë më shume me materiale dhe dokumente arkivorë e historikë.

Në prezantimin e dokumentarit ishin të pranishëm edhe përfaqësues të familjes Rusi, me titullarin e kësaj familje, i cili kishte ardhur enkas nga Amerika për këtë event, Turan Rusi, përfaqësues nga familjet Pustina, Jegeni, Bakiu, Fagu etj.

Folën gjithashtu, Akademik prof. dr. Beqir Meta si dhe historiania e njohur, prof. dr. Nevila Nika.


Shoqata "Bashkësia Dibrane", vlerësoi në fund të aktivitetit me "Mirënjohje" gazetarin dhe skenaristin e RTSh, z. Genc Ymeraj, për dokumentarin, si dhe për frymën e mesazhit kombëtar, shoqëror dhe historik.



Në foto: Qeveria shqiptare e kryesuar nga Koço Kota me anëtarët e saj: Faik Shatku, Ekrem Libohova, Abdurrahman Dibra, Musa Juka, Kol Thaçi, Rrok Gera dhe Seit Toptani.

Me rastin e përvjetorit të lindjes

Naimi poet



Poezia e Naimi ka aromën e Dibrës, është ushqyer me urtësinë e saj e cila shpaloset me fjalë-sintezë duke të kumtuar mendime me vlerë, për të sotmen dhe të ardhmen. Poezia e tij na sjell heronjtë, bëmat e tyre, pa retorikë dhe efekte të jashtëme, por si një konceptim i vetë jetës tonë, këtë na e dëshmon më së mirë edhe Naim Plaku në poezitë e shumta të tij.

Nga **SHAQIR SKARRA**

(vijon nga numri i kaluar)

Autori e tejshtrin botë-vështrimin e tij në hullinj të njohur historikë dhe përjetimesh, por mënyra se si ai vështron në këta hullinj është befasuese; duke sjellë tablo dhe gjendje sa realiste aq dhe trillere, që të rrëmbejnë e të bëjnë për vete me fuqinë emocionale që mbartin. Ky shpalim i poetit sjell me vete një aromë të veçantë jete, risinë e riciklimit të bukurisë, si një kumt ndjellës drejt harmonisë dhe përsosmërisë, në kufijtë mes realitetit të rëndomtë që ushtron presion dhe ëndrrës së kulluar, si produkt i mirëfilltë i kërkimit në shpirtin e idealitetit dhe iluzionit.

Kjo shfaqje e tij në mejdanin e vështirë të letrave shqipe, ngjan dhe përjetohet si një ngjitje plot mundime në një terren vargmalesh të larta, të thepisura, plot humnera dhe rreziqe.

Monopatet, kreshtat dhe shpatet e frikshme që vetë zgjodhi të udhëtojë, janë një sfidë e vërtetë plot magji, pabesi, heroizëm dhe natyrisht edhe ankth të mistershëm... Magjike pse janë vise dhe oaze brilante, nga ato që vetëm përfytyrimi dhe imagjinata, kanë viston dhe fatalitetin, kanë atë lejen heretike për t'i eksploruar.

Ndërsa ankthi si një kalë besnik, zbritur prej mitologjie, me një ngarkesë të rëndë, shoqëron çdo shfaqje si qortim, dyshim, mëdyshje a dilemë, ku verbale e ku ndjesore, ku tërthorazi e ku drejtëpërdrejt. Mbi këto binarë, mbi këtë kuotë e sheston poezinë dhe ngjitjen e vet Naim Plaku. Tre vëllimet e dëshmuara (të botuara), pa llogaritur ato mijëra e mijëra vargje që ndodhen të pabotuara në arkivin e familjes, dimensionojnë sadopak, ku me një fjalë, ku me një figurë, ku me një shprehje apo një rresht.

Vetë treva prej nga ku vjen, poeti Naim Plaku, siç është Dibra, u lodhën së bredhuri cep më cep kësaj treve, shtegtarët e parë që alternuan zërin me fshikullimën e erës dhe jehonat e lugjeve, krojet e zanave, ashtu siç shprehet vetë Naimi në vëllimin e tij të fundit me folklor nga Dibra, ku zë fill tradita e bukur folklorike, gojore e popullit tonë. Prandaj, jo rastësisht Naim Plaku është një nyje që ndez zërin e tij në shtratin e gojëtarisë dhe folklorit, me poezinë moderne shqipe. Pikërisht më së shumti dhe në këtë shtrat vjen dhe prurja e tij.

Natyrshëm diku, në këtë komunitet është pashaportizuar edhe poeti Naim Plaku. Kësisoj, jo pak motive dhe aspekte të poezisë së tij, folklorit, legjendave dhe miteve shpesh janë kthyer në motive ngacmuese, në kolonat mbajtëse, mbi të cilat Naimi ngre lart poezinë e tij të veçantë.

Motivet folklorike më së pari rezultojnë si një shtysë, mbi të cilat udhëton vetë fantasia poetike e tij. Që të jesh vetvetja në këtë trajtë, është paksa e vështirë, madje një vështirësi e gradës së lartë. Që në fillim tek libri "Fllad e frullizë" Naimi na grish për të udhëtuar në kohë. Libri është shkruar me mjaft ngrohtësi. Në të gjitha poezitë e tij spikat më së shumti mendimi i cili i bindet arsyes.

Sado që në këto momente humbet emocioni por përfitohet diçka tjetër, mendimi filozofik, mbështetur në jetën e zakonshme, çka duhet për të kontrolluar edhe emocionin. Ai shpesh është edhe i trazuar, si rrjedhojë e një analize të hollësishme të vetë rrethanave dhe përvojave njerëzore, por mjaftohet me tematikën e madhe e të larmishme që rrok, si dikur kur Naimi nisi të hapte brazdat e para të poezisë shqipe.

Ai ka shkruar për figura të mëdha të historisë, që nga shekulli i XV e deri në vitet e Luftës Nacional-Çlirimtare, apo edhe për "Heronjtë e Punës", të cilët dhanë jo pak nga vetja e tyre për progresin e shoqërisë tonë. Tek poezia "O mirë se na erdhe", poeti shkruan: "Ky libër, këto fletë, më ngjajnë mua me një fletë të humbur a një qytet".

Duket se vetë poeti meditonte për poezinë e tij në vite, disi i distancuar nga vetë produkti i tij dhe rreket ta gjykojë bashkë me lexuesin, me paanësi "fshatin apo qytetin", mëhallën me bëma e bubullima. Por kjo është një gjendje që e tejkalon shpejt. Vargjet që pasojnë sjellin atmosferë tjetër.

Naimi me vargje të kursyera, hedh në telajon e tij gjithë peisazhin e Dibrës.

Duke shfletuar poezinë e tij faqe më faqe, shikojmë se si poeti shpalos bukur epikën e tij, në poezitë e bukura tekste këngësh, atë epiko legjendare të Dibrës gjatë viteve 1912-1920, e cila flet për luftën heroike në mbrojtje të vatanit ku shkëlqeu heroizmi me tërë madhështinë e vet. Poeti shkruan me metafora vargjet:

"Dridhen malet, jo nuk tunden kullat.
N'log t'burrnisë po maten burrat.
Se lshojnë pllamën, pa i ndrue ksulat!

Lëshon Korabi gurë e kepa,
Po knon Drini kangët e veta:
-Kanë hyp shqipet nëpër kreshta!

-Kadal hasëm se ktu ka burra,
Na knojnë pushkët nëpër kulla,
Ta shtrojmë vendin pllambë e plumba!.. .

Poeti deklaron me mjaft solemnitet në vargun e fundit, duke dëshmuar njëkohësisht fitoren, sepse Dibra, e në përgjithësi populli ynë, kurrë nuk ka qenë agresorë, por gjatë historisë së tij të vjetër e të re i është dashur të mbijetojë fort.

Naim Plaku e motivon fitoren e popullit të tij me atë qëndresë heroike, që kur me vargje brilante, ndërtuar kryesisht me mjaft metafora, jep mobilizimin e malësorëve trima në shtatë e shtatëdhjetë, siç ishte dhe vetë shprehja në ato vite të zjarrta lufte. Naimi zgjon emocione të rralla me vargjet:

"Miku i shpisë e la konakun,
Dhandri i ri kapi bajrakun,
Nusjaa e re hoqi dullakun.
Plaka n'votër e theu furkën,
Fmija i djepit rokën pushkën,
Gratë n'llogore pjekin bukën..."

Miku, dhëndri, nusja ngrihen mbi të jashtëzakonshmes, sepse situate është jo e zakontë, megjithatë ato janë fort të besueshme, brenda kontekstit historik shqiptar, me shembuj të mëdhenj të heroikes në shekuj.

Ai ishte jo vetëm me rrënjë të fisme e të njohura mirë në Dibër por edhe vetë me tipare të tilla, që me një vështrim të kujdeshëm të poezisë së tij, do t'i gjesh të shpalosura të gjitha këto tipare aty. Ai ishte dhe mbeti ndër ato burra të mençur që fliste pak dhe ndonëse poezia e tij më së shumti është epike shpalos atë heroikë, që në fakt ka njerëzoren, urtësinë.

M'u kujtua një detaj gjatë një bisede, nga ato biseda të shumta që kam bërë vetë me Naimin. E dija se nëna e tij ishte vajza ma e vogël e heroit legjendar të Dibrës në luftën disavjeçare kundër hordhive serbe, Elez Isufit. Kur ia thashë Naimit, ai foli fare pak:

-Po, nëna ime ka qenë e bija...

E pashë njëherë në mimikën e syve si për ta vërtetuar plotësisht këtë. Ai aq foli. Unë përsërita edhe njëherë pyetjen time. Ai aprovoi:

-Po, po. Pastaj shtoi:

-Më thoshte shpesh herë nëna, se gjatë tre viteve nuk e pashë tre herë babanë tim.

-Lum si ti Naim, fola si nën zë. Pastaj se si më erdhi nga ky konstatim i imi. Njerëz me përmasat e heroit legjendar Elez Isufi, i takojnë mbarë kombit dhe jo vetëm Dibrës.

"Ç'është ky varg i gjatë, i zi,
Midis resh e bubullimash?!
-Jo s'ka vdekur, por rri shtrirë,
Ky vigan në shtrat martinash!

Syri shkrep dritë e stuhi,
Me barot plagët i mbushi,
Thërrasin malet për t'ju pri:
- Jo, nuk vdes Elez Isufi!"

Profilin njerëzor të Naim Plakut e takon në shumë nga poezitë e tij. Tek u njoha me komunikimin e tij të drejtëpërdrejtë me lexuesin, në hyrje të librit "Në qiellin e mjegulluem të poezisë", përfitova një gjendje, pse të mos them, disi të ndryshme nga herët e tjera, më bëri të mendoj paksa trishtueshëm, aq sa pyeta veten time: Mos është shenjë lodhje kjo e poetit? Në fakt, ishin vitet e fundit të jetës, por siç shprehej vetë, në mes miqve e shokëve, kur thoshte se "këmbët më janë ndalë, por koka jo. Jam në më të mirën moshë për të krijuar". Dhe në fakt, kështu ishte. Ai nuk rreshti asnjëherë, paçka se vdekja mjaft tekste këngësh, poezi dhe prozë ia la në gjysmë.

Kujtova lëndën e shumtë poetike. Me qindra e qindra tekste këngësh, këngë epike, lirike, besimi dhe fëmijësh, të cilat të gjitha ishin në harmoni të plotë me muzikën. Këto tekste kanë shërbyer si një ushqim shpirtëror për njerëzit anekënd vendit tonë. Dhe, se ç'më vinte ta kundërshtoja, qoftë edhe njëherë të vetme mendimin e tij. "Ndoshta e ke dëgjuar një zë që dridhet e këputet në telat e çiftelisë", si për të dalë nga ai trishtim i lehtë, mendova për poetin e madh. Ai është një lis, që sado i rrahur prej stuhive të kohës, qëlloi me rrënjë të forta në thellësi të tokës dhe nuk e shkulën dhe dogjën as rrufetë, që binin prej qiellit(jo, prej tjetrit).

Duke patur parasysh dimensionet e poetit, si njeri dhe krijues, natyrshëm shtrohet pyetja: Një poet, a duhet të analizohet me mëdyshje? Cilës së vërtetë i duhet qëndruar, realitetit apo imagjinatës? Dhe përgjigja bëhet e rëndësishme, kur ke të bësh me poetin Naim Plaku, një njeri me mendje të hollë, me vullnet të hekurt, me shpirt të pastër e jetën e tij të shenjtë.

Kësisoj, të shkruash për poezitë e Naimit, është një detyrim. Nga ana tjetër është njëkohësisht edhe përgjegjësi e madhe, sepse do të duhet të meditosh gjatë për rrethanat që ka shkruar dhe që kanë përcaktuar vetë Naimin si poet. Ai të impresionon sikur të flasësh për herë të parë për poezitë e tij. E, megjithatë, këto që thamë, poezia e tij, tematika e saj, është e konturuar fuqishëm, ku spikat prej shumë vitesh angazhimi i tij intelektual, gjithmonë në dobi të progresit të vendit tonë.

Të bëhet se deviza e gjithë krijimtarisë së tij ndër vite, është një koncept filozofik i vërtetë, i cili udhëheq të dëgjosh zërin e ndërgjegjes.

Ai ka besuar gjithmonë te vetja dhe e vërteta. Arsenali i dijeve të tij si dhe mirësia kanë qenë gjithmonë tek ai virtyte në në funksion dhe shërbim të të tjerëve.

Poezia e Naimi ka aromën e Dibrës, është ushqyer me urtësinë e saj e cila shpaloset me fjalë-sintezë duke të kumtuar mendime me vlerë, për të sotmen dhe të ardhmen. Poezia e tij na sjell heronjtë, bëmat e tyre, pa retorikë dhe efekte të jashtëme, por si një konceptim i vetë jetës tonë. me gjasë heroikja nuk u zvetënueka kurrë, këtë na e dëshmon më së mirë edhe Naim Plaku në poezitë e shumta të tij. Poezia është ajka, maja dhe perla e krijimtarisë shpirtërore. Ajo nuk ka shterruar dhe nuk shterron kurrë, por vazhdon të gurrojë gjallërisht vazhdimisht si uji i ftohtë i bjeshkëve tona.

Personazhi heroik në poezi, që në poezitë e Naim Plakut janë të shumtë, ose heroizmi i vetë personazheve, jo e bërë artificialisht, por si një produkt i logjikshëm, por edhe i ndjerë që ndërtohet në mënyrë të natyrshme, pa sforco. Ja si shprehet poeti për poezinë në një parathënie të vëllimeve të tij: "... Jo, jo. Ajo do të vazhdojë të jetë e pranishme gjatë. Ajo ngahera ka frymëzuar, e mbase do të gjenerojë frymëzimin tek poetët, sepse poetët orientojnë shoqërinë drejt horizonteve të reja. Poetët janë paraprijës të agimeve zbardhëllim, janë muza dhe shpirti i ëndrrave shpresërim, janë fryma dhe muzikaliteti i fjalës shenjtërim, janë koloriti më i ndritshëm i qënësisë tonë qytetërim!". Naim Plaku krijoj poezi në një kohë kur vetë poezia ishte një mënyrë për të lëvizur jetën dhe për ta ruajtur atë të thjeshtë, të pastër e të bukur.

Rruga e Arbërit nr. 183

profil

Biri dhe burri i Dardhës. Elez Rasha pati merita të veçanta. Ai krijoi e la gjurmë të çmuara në jetë. Gjurmët e tij të çmuara nuk rrinë në një vend. Ato lëvizin dhe ecin e vijnë drejt nesh.

Elez Rasha, burri i mençur i Dardhës

Nga **SHAQIR ÇERPJA**

Sa herë kujtoj, mendoj, meditoj a shkruaj dhe sa herë të flitet a të këndohet për patriotin e shquar dhe luftëtarin e paepur të çeshtjes sonë kombëtare, trimin e trimave, gjeneralin me shajak, Elez Isufin, mua, në mendje më vjen dhe kujtimet m'i zgjon, m'i ndez e m'i freskon edhe një emër tjetër, një Elez tjetër, një bir e burrë Dardhe, Elez Rasha. Dhe, jo vetëm për emrin e njëjtë, por për karakterin, vlerat dhe virtytet e tij të spikatura, për burrërinë e tij. Se, Elez Rasha ishte njeri dhe burrë me shumë personalitet dhe autoritet shoqëror. Ai ishte me shumë zë dhe emër, jo veç në Dardhë, por edhe jashtë saj. Elez Rasha u lind në fshatin Lashkizë të Dibrës, në fund të shekullit të 19-të, në vitin 1899, tamam në kohën kur po takoheshin e po ndaheshin shekujt. U lind, u rrit dhe u burrërua në një truall dhe vatër patriotike, ku historia flet me vepra e veprat flasin në këngë e me këngë. Ishte i lart, jo vetëm në trup e shtat, por në vepra vlera. Ishte burrë me trup të bëshëm, shtatlartë, por elegant, me sy e vështrim të mprehtë, me zemër të bardhë, i çiltër dhe me shpirt fisnik.

Ai lindi dhe ishte me fat, sepse natyra i bëri dhuratë mençurinë. Kishte intelekt natyral të hollë, ... të hollë si mendja e Elez Rashës... Ishte i thellë në mendime, i kthjellët në gjykime, i arsyeshëm në arsyetime, i saktë në argumente, i prerë në vendime, korekt në veprime dhe këmbëngulës dhe i përkushtuar për të vërtetën, për t'a kërkuar, për t'a gjetur, për t'a thënë dhe për t'a mbrojtur të vërtetën. Maturia ia ushqente tolerancën. Ishte orator i fjalës dhe debatues i zjarrtë, përherë i armatosur me argumenta. Megjithëse ishte mjeshtër i përkthimit dhe interpretimit të alegorisë dibrane, në të shumtën e rasteve ishte i drejtpërdrejtë në komunikimin në mexhelise e kuvende burrash. Falë intelektit natyral dhe zgjuarsisë e mençurisë së tij, ai, që në moshë të re ishte jo vetëm i pranuar, por i dëshiruar, i kërkuar dhe i mirëpritur në ambiente burrash, në mexhelise dasmash e vdekjesh, festash e gëzimesh. Dëgjonte, kuptonte, mësonte dhe njihte shumë mirë historinë dhe traditën, jo vetëm të Dardhës e Dibrës por edhe më gjërë e më larg. Dhe, ditët e muajit shkonin e vinin, koha ecte dhe ai rritej e burrërohej duke u zhvilluar, duke u mençuruar. Kishte mësuar shumë, kishte fituar njohuri për shumë fusha të jetës dhe ishte shumë i ditur. Dhe u rrit e u bë burrë i mençur i Dardhës. Dhe, me mençurinë e tij, mençuronte dhe mençuroi edhe të tjerët, fëmijët, familjen, fisin, fshatin, ... Elez Rasha, në jetën e tij rreth 80 vjeçare (1899 - 1977), jetoi në disa kohë, në disa periudha historike, njohu disa pushtues e pushtime, mori pjesë në disa luftëra dhe luftime. Gjithmonë në krahun çlirimtar, përkrah Elez Isufit, Suf Xhelilit dhe patriotëve të tjerë dibranë. Është



jo vetëm e treguar gojarisht nga bashkëkohës e bashkëluftëtarë, por edhe e shkruar më parë, se më 1 gusht 1921, në luftën qëndrestare të Misim Ahmetit, në Majë të Karmës, kundër mercenarëve të Beogradit, Elez Rasha, bashkë me Imer Topuzin, ishin ndër të parët që erdhën në ndihmë dhe iu bënë krah e luftuan përkrah Misim Ahmetit dhe luftëtarëve të tjerë. Pavarësisht diferencës në moshë me Elez Isufin, për shkak të karakterit dhe burrërisë, Elez Rasha ishte dashamirës, shok, mik, bashkëkohës, bashkudhëtar dhe bashkëluftëtar me Elez Isufin e Suf Xhelilin.

Dhe, shpeshherë shkonte tek shtëpia e Elez Isufit, ku qëndronte gjatë, jo vetëm me ditë, por edhe me javë. Edhe në luftën e Peshkopisë, në dhjetor 1924, ku u vra Suf Xhelili dhe u plagos Elez Isufi, Misim Ahmeti, etj., (Elezi vdiq pas dy javësh), në atë luftë ishte edhe Elez Rasha. Edhe pas vrasjes së Elez Isufit e Suf Xhelilit, përsëri, Elez Rasha nuk i ndërpreu mardhëniet, por mbajti dhe ruajti lidhjet me Cen Elezin dhe familjen e tij të madhe. Por dhe shtëpia e Elez Rashës në Lashkizë, derën e mbante të hapur e sofrën e mbante të shtruar, ku vinin dashamirës, shokë, miqë dhe udhëtarë. I tërhiqte bujaria dhe shpirti fisnik i Elezit dhe familjes së tij. Kishte dhe mysafir që i sillte rruga, rastësia. Midis shumë rasteve, tregojnë se një mesditë vere, katër mirditor me katër mushka të ngarkuara me misër në Dibër, duke kaluar rrugës, afër shtëpisë së Elezit, një thes ngec në një dru dhe griset pak. Mirditorët thirrin në kullën e Elezit dhe kërkojnë një gjilpërë me pe për të qepur thesin e grisur. Elezi del dhe i fton të hyn brenda e të pushojnë. Urdhëron djemtë e tij të shkarkojnë dhe të

Elez Rasha gjithmonë është vlerësuar dhe respektuar nga të gjithë, jo vetëm nga njerëzit: dashamirës, miq e shokë, por edhe nga organet shtetërore e shoqërore të kohës. Në festën e festimet e Jubileut të 50 vjetorit të shpalljes së pavarësisë, ishte i përzgjedhur, i caktuar dhe ftuar, si përfaqësues i Dibrës në festën e flamurit në Vlorë, bashkë me Imer Topuzin nga Dardha e disa të tjerë nga Dibra.

ushqejnë kuajt e miqëve mirditorë dhe, pastaj menjëherë i udhëton përsëri djemtë që të marrin veglat dhe të shkojnë të pastrojnë, të lirojnë të hapin dhe të zgjerojnë rrugën. Pasi hanë drekë, pinë kafe e bëjnë muhabet, i mbajti dhe për darkë. Dhe, thesin e grisur ua zevendesoi me thes të ri. Dhe, katër mirditorët u bënë dhe mbetën miq të Elez Rashës. Me shumë mençuri dhe tolerancë kërkonte, krijonte dhe gjente rrugë e mënyra për të zgjidhur probleme edhe të ndërlikuara, jo vetëm të familjes e fisit të tij, por edhe të fshatit, mëhallës etj. Tregojnë shumë raste ku Elezit kishte zgjidhur paqësisht probleme dhe mosmarrveshje të vështira. Dhe midis shumë rasteve të tilla, tregojnë se disa vite pas çlirimit të vendit, pushteti komunist nxiste zhvillimin e bujqësisë dhe inkurajonte hapjen e tokave të reja.

Disa familje të një fisi nga Mërskani kishin marrë lejë nga pushteti në rrethin e Dibrës dhe kishin filluar të hapnin tokë të re në Kunorë, shumë pranë arave, kullotës e staneve të Rashës. Gjithë fisi i Rashës u mërzit dhe revoltua, sepse ndonëse ishte lajthi, ajo ishte kojri e mëhallës së Majce dhe Mëhalla e Mërskanit nuk ishte pjesëtare e kësaj kojrie. Veç kësaj, kjo tokë e re, pengonte e bllokonte ballin e kullotës për bagëtitë e Rashës. Me ankesa në rrugë shtetërore ishte vështirë zgjidhja e këtij problemi. Por mençuria e Elez Rashës e zgjidhi problemin qetësisht e paqësisht. Elezi shkoi dhe takoi burrat nga Mërskani që po hapnin tokë të re në Kunorë. I përshëndeti dhe u ulën e pinë duhan e bënë muhabet, si gjithmonë, për hallet, punët, ...Elezi u nda paqësisht me ta, pa u shprehur asnjë ankesë a pakënaqësi për tokën që po hapnin. U kthye në shtëpi dhe nisi urgjent një nga djemtë e tij për Peshkopi që të merrte lejë për të hapur tokë të re në Kodër të Mërskanit, shumë pranë shtëpive të Mërskanit. (Rasha as nuk donte dhe as nuk kishte ndërmend të hapte tokë të re në Mërskan, por vetëm e nisi si lojë sa për të bind burrat e Mërskanit të hiqnin dorë nga hapja e tokës së re në Kunorë). Dhe me të marr lejën në Peshkopi, organizohet dhe të nesërmen fillojë punë duke shkulur dëllinja e duke hap tokë të re në Kodër të Mërsksnit. Burrat e Mërskanit e kuptuan lojën e zgjuar të Elez Rashës dhe shkuan menjëherë tek Elezi dhe i kërkuan marrveshje, ashtu siç e kishte menduar Elezi, që Mërskani të hiqte dorë nga hapja e tokës së re në Kunorë, ndërsa Rasha të hiqte dorë nga hapja e tokës së re në Kodër të Mërskanit. Dhe ashtu u bë. Problemi u zgjidh qetësisht e paqësisht, pa konflikt, pa acarim e pa mosmarrëveshje. Problemin e zgjidhi mençuria e Elez Rashës. Elez Rasha ishte i pranishëm kudo, në mexhelise burrash, në gëzime e festa, në dasma e morde, në kuvende e mbledhje shoqërore a shtetërore. Ishte i parë në rrjeshtin e burrave dhe i parë në krye të vendit në odat e burrave, se ai ishte burrë i zgjedhur në burrat e zgjedhur të Dardhës.

Kudo ku përfaqësonte fisin, fshatin a mëhallën, ai dinte të kërkonte, të argumentonte, dhe të mbronte interesat e tyre. Se fjala e tij kishte peshë e vlerë, fjala e tij dëgjohej, respektohej, vlerësohej, se kudo shkonte e kudo ishte, argumentet i merrte me vete, i mbante me vete. Elez Rasha kishte një familje të madhe, një familje shumë të organizuar, me shumë rregull e disiplinë, një familje e kulturuar, e përparuar dhe e emancipuar. Të pesë djemtë e tij u bënë dhe ishin shumë të zotët dhe të gjithë morën përsipër e kryen punë e detyra ndryshme shtetërore të zgjedhura për atë kohë. "Artistja e Merituar" dhe "Mjeshtre e Madhe" Liri Rasha kujton me mall dhe nostalgji gjyshin e saj, Elez Rasha dhe atë kohë të bukur e të lumtur, kur ajo ishte me gjyshin e saj dhe rritej me dashurinë, përkëdheljet, kujdesin, përkujdesjen dhe këshillat e tij. Ndërsa Muharrem Gjoka, nipi i Elezit, midis shumë kujtimeve, kujton e veçon vizitën e fundit në ditët e fundit të jetës së Elezit, kur Muharremi bashkë me xhaxhain e tij Mersim Gjoka, shkuan ta vizitonin Elezin, i cili ishte i shtrirë në shtrat, ishte shumë i sëmurë e shumë i lodhur nga sëmundja, por shumë i qartë dhe i kthjelltë në kujtesë dhe mendime. Elez Rasha gjithmonë është vlerësuar dhe respektuar nga të gjithë, jo vetëm nga njerëzit: dashamirës, miq e shokë, por edhe nga organet shtetërore e shoqërore të kohës. Në festën e festimet e Jubileut të 50 vjetorit të shpalljes së pavarësisë, ishte i përzgjedhur, i caktuar dhe ftuar, si përfaqësues i Dibrës në festën e flamurit në Vlorë, bashkë me Imer Topuzin nga Dardha e disa të tjerë nga Dibra. Biri dhe burri i Dardhës. Elez Rasha pati merita të veçanta. Ai krijoi e la gjurmë të çmuara në jetë. Gjurmët e tij të çmuara nuk rrinë në një vend. Ato lëvizin dhe ecin e vijnë drejt nesh. Dhe ne ecim e shkojmë drejt gjurmëve të tij, se duhet të mësojmë e të marrim vlera nga vlerat e tij, të mençurohemi nga mençuria e tij.

BOTIMET M&B

mbbotime@gmail.com
069 20 68 603 / 04 22 33 283

Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë librarisë sonë në Tiranë në rrugën "Isa Boletini", pranë kryqëzimit te Selvia ose mund t'i porosisni online.

Posta brenda vendit është FALAS

Dëshironi të **BOTONI PAK KOPJE LIBRI**,
por nuk mundeni sepse shtypshkronjat ju kërkojnë të paguani për një tirazh të madh...
Tani nuk është nevoja të prisni...
JU OFROJMË BOTIME NGA 1 KOPJE E VETME!
Njëlloj si në shtypshkronjë... Çmime të favorshme dhe shpejtësi!
Telefono: **068 65 08 441** ose shkruaj email: **mbbotime@gmail.com**

Na ndiqni:

RRUGA E ARBËRIT
https://www.facebook.com/gazeteerajonitteDibres

www.rrugaearberit.com

Bëj një abonim online ose në print...
Kushton vetëm 600 lekë në vit...
email: rrugaearberit@gmail.com

arsim

Në verën e vitit l922, zhvilloi punimet Kongresi Kombëtar i Arsimit ku u vendos që në çdo komune të hapet shkollë fillore e detyrueshme për të gjithë fëmijët e moshës 7 – vjeç, si për djem dhe për vajza, t'i jepet rendësi mësimit të gjuhës shqipe.

100 vjet Shkolla shqipe e Ploshtanit

Nga **ISMEN BRIKA**

Për zhvillimin e arsimit në Lumë e në veçanti për shkollën e Ploshtanit, kanë shkruar Prof. Shefqet Hoxha, 'Mësuesi i merituar' Isa Halilaj, anëtarët e Akademisë së Shkencave Shqiptaro-Amerikane, Xhavit Lashi, Fatos Daci, historiani Xhemal Domi, Dr. Shefqet Domi, Dr. Fejzullah Gjabri, Muharrem Mezini, Jahe Delia, Mevlan Lushi etj. Në mënyrë të veçantë e të detajuar, kanë shkruar kryesisht bashkëpunëtori i vjetër shkencor, Beqir Shehu, e mësuesi veteran Metush Skeja.

Unë si biri i këtij fshati, pa shume pretendime, në këtë shkrim po përpiqem të bëj një historik të saj, duke parashtruar disa fakte, konkluzione dhe argumente pa paragjykime, për zhvillimin e arsimit në Ploshtan, duke u shtrirë në kohë para vitit 1900 e deri me sot. Ploshtani është fshati më i vjetër në luginën e Drinit të Zi, me një zhvillim ekonomik, social-kulturor, me urbanizim antik e kulture te lashte Ilire. Ketë e gjejmë në gjetjet arkeologjike të mallrave të importit që ne kohën romake. Pranë rrënojave të Kishës së Ploshtanit në rrugën automobilistike që të çon në Caren, ka varre që sipas mësuesit Shehat Palushi, i përkasin periudhës para Krishtit.

GJETJET ARKEOLOGJIKE TË PERIUDHËS ILIRE NË FSHATIN PLOSHTAN!

Në lagjen Dode, në vendin e quajtur Llakace, janë gjetur ene qeramike ku sipas mësuesit Sulejman Istrefi, i përkasin periudhës së Ilirisë. Në kishën e Tallamazit, janë gjetur mozaik qelqi që i përkasin periudhës së Ilirisë. Në Fushë-Dardhë të lagjes Dode, duke punuar me traktor në vitin l968, u zbulua një qyp qeramike i përmasave të mëdha që përdorej për mbajtjen e grurit. Ne Fushë-Dardhë, por dhe në murin rrethues të varreve të fshatit Ploshtan, janë gjetur copa tjegulle e tulle, që kanë shkronja e shenja që i përkasin kohës se Ilirisë...! Sipas historianit Iljaz Kaca, në Fushë-Dode ka pasur stacion rrugor që përdorej nga tregtarët që lëviznin nëpër luginën e Drinit të Zi. Në këto gjetje, sipas studiuesit Adem Bunguri, janë vetëm disa anë të jetës rurale të periudhës qytetare ilire në Ploshtan.

Këto gjetje tregojnë se ka pasur zhvillim të mirë ekonomiko-shoqëror, si ne fushën e prodhimit e në kulturën e jetesës. Në Ploshtan gjejmë shkrime në objektet e kultit, në epitafet e ajetet në gurët e varreve, në damkat e deleve në rozetat e shkruara në gurët e dyerve të avllive. Pra mungesën e burimeve të shkruara në periudhën antike, e plotësojnë gjetjet arkeologjike që janë zbuluar në ketë fshat të lashtë prehistorik. Nga pikëpamja e kushteve ekonomike shoqërore, themi se më parë është zhvilluar edukata (edukimi tradicional familjar), e më pas arsimi. Ploshtanasit nuk i linin fëmijët jashtë edukatës, ata i mbanin afër, u mësonin mjeshtrin e punimit të tokës, u mësonin si i'u shërbehet bagëtive dhe si mbarështohen ato, u mësonin si mbahet llogaria, u mësonin kalendarin vjetor e atë fetar, u kultivonin dashurinë për prindërit, për të moshuarit, për të afërmit, për prindërit, për atdheun, gjuhën e kulturën. Rendësi u kushtonin kultivimit tek fëmijët, tiparet si; nderi, burrëria, dinjiteti, besa e besnikëria. Të gjithë pushtuesit shkatërruan çdo gjë në Ploshtan, por nuk shkatërruan gjuhën kulturën, traditat zakonet itifaket.

Turqit nuk na lanë gjë të shkruar për zhvillimin e arsimit, kulturës. Atë e gjejmë tek njerëzit që kanë shërbyer në komunë si mydyr, bimbash, myfti, miftare, kadi, kryetar zaptiesh, tregtar, zejtare, ushtarak etj., ku bashkëfshatarët e mi kanë shërbyer. Atë e gjejmë tek imamët, hoxhallarët, mezinët që kishin kulturë e dituri fetare, të cilët kanë shërbyer në xhaminë e fshatit Ploshtan, por dhe si vajë shëtitës në zonën për rreth.

PLOSHTANI, QENDËR KAZAJE DERI NE VITIN 1884!

Ploshtani ka qenë Qendër Kazaje, deri ne vitin 1884, qendër në krahinarie e nahije, qendër komune e lokaliteti. Punonjësit e kësaj administrate që kanë shërbyer në zonën për rreth, kishin karakter fetarë, por ishin të vetmet institucione, ku shkollohej rinia e fshatit dhe bazë për të shkuar për të studiuar në shkollat fetare në Prizren, Shkup, Stamboll, Damask, e deri ne Arabinë Saudite. Kur erdhën turqit në Ploshtan, ngritën administratën, banesat ku qëndronin ushtarët dhe oficerët për mbrojtjen, ngritën xhaminë, ngritën mejtepin, ngritën mensën ku do të hanin administrata, ushtria, nxënësit, të varfrit



e rrugëtarët. Ne xhaminë e Ploshtanit, ka pasur qytaphane deri në vitin 1920, kur u dogj nga shovinistët serbë, e ato pak libra që ngelën, i mori në ruajtje imami i fshatit, Molla Tofik Gjorllaku. Disa nga këto libra i ka edhe sot në bibliotekën e tij, imami i fshatit, Mevlan Gjorllaku.

Sipas historianit, Xhemal Domi, në Ploshtan e zonën përreth ka pasur shkolla turke, si: Mejtep, Sebjan Mektep, shkollë Ruzhdije, që financoheshin nga shteti turk, nga vakëfi i fshatit që kontrolloheshin nga pleqësi e këshillat lokalë.

Aty jetonin mësim hoxhallarë që kishin mbaruar shkollat në Prizren, Prishtinë, Shkup, Stamboll, Selanik, Damask etj. Në raste të veçanta, i sillnin mësuesit nga Shkupi e Prishtina, por më së shumti, ishin vendalinj. Në këto shkolla bëhej matematikë, histori, gjeografi, dituri, filozofi dhe gjuhe turke, persishte e arabe. Rendësi i kushtohej njohjes leximit te Kuranit te ajeteve te tij. Zbërthimi e komentimi tubet, vajzet, praktika e riteve, këshillimet morale bëheshin në gjuhën shqipe. Në mejtepe e sebjan mektepe, shkonin edhe vajza. Kontribut të veçantë në zhvillimin e arsimit të dijes e kulturës kanë dhenë ploshtanasit që punonin si ushtarakë, kadi, bimbash, kryetarë komune, në Prizren, Tetovë, Shkup, Stamboll, Bukuresht, Jenisheher, Izmir, Selanik, etj.

SULEJMAN LAÇI NGA BARDHOCI I KUKËSIT, HAPI NË VITIN 1902 SHKOLLËN NË PLOSHTAN-RADOMIRË

Kontribut të madh ka dhënë gjithashtu shoqata 'Bashkimi' qe me anë të Maliq Beg Bilalit, solli ne Ploshtan abetaren me shkronja latine, por edhe "Klubi Bashkimi" që u krijua në Ploshtan pas Kongresit të Manastirit. Kontribut të veçantë ka dhenë dhe këshilltari për arsimin në Prefekturën e Prizrenit, Sulejman Laçi nga Bardhoci i Kukësit, ku nga viti 1902 deri në vitin 1912, hapi në Ploshtan, Radomir, një shkollë. Në Ploshtan jepnin mësim Molla Gafurri Brika, Molla Tafik Gjorllaku e Molla Sadik Potja. Sipas Qamil Hoxhës, shkollën fetare në Ploshtan, nga viti l9l2 deri l920-ën, e ka mbajt hapur Molla Gafurr Brika me mundësitë ekonomike qe kishte ai vete. Sa me lart, nuk mund të themi se ka ekzistuar injorancë, pa dituria, se nuk ka pasur kush të lexojë, e si njësi matëse ka qenë "Rabusha", ku në Ploshtan zhvillohej tregti, shitej e blihej, jo vetëm mall me mall, por me lira e dinarë të kohës.

NGA PLOSHTANI KANË DALË DISA USHTARAKË DHE KUADRO TË LARTË

Nga Ploshtani ka pasur ushtarakë të larte si: Hysen Gjorllaku që ka shërbyer në Selanik nga viti 1830, Ismail Skeja, edhe ky para vitit 1850. Ali Gjorllaku, pas vitit 1900, Hisni Flisa, ushtarak në Edine në vitet 1912- 1940, Isak Male Çupi (Sert Baruti), 1910-1945, Idriz Vehap Brika, 1935-1952, Metali Skeja, Mjek Ushtarak në Bursa. Nga Ploshtani kanë mbaruar Medresen e shkolla kualifikimi për hoxhallarë, administratë, drejtësi 8 veta, si: Molla Tafik Gjorllaku, Molla Gafurr Brika, Molla Miftar Flisa, Afuz Vehxhi Skeja, Afuz Elmaz Skeja, Afuz Mustaf Gjorllaku, Haxhi Hasan Perzhilla, Haxhi Daut Flisa. Kanë mbaruar shkollë për Drejtesi, Abdulla Perzhilla dhe Bajram Gjorllaku. Një pjesë e mirë e të lartpërmendurve, aktivitetin e kanë ushtruar jashtë Ploshtanit.

Në Ploshtan, përveç këtyre shkollave që ka hapur turku, në vitin l9l7 kanë hapur një shkollë dhe austro-hungarezët, ku mësohej gjermanisht dhe si gjuhë e dytë, shqipja. Mësues në ketë shkollë ka qenë Ferit Nimani nga Kosova, me shkollë Normale. Krahas lëndëve të tjera, për herë të parë ju dha prioritet aktivitetit fizik e sportiv. Shkolla e detyrueshme për fëmijët nga mosha 7-vjeç. Po kështu lejoj të festohet 28 nëntori, dita e Pavarësisë së Shqipërisë. Ditë pushimi u la dita e premte dhe

Në tetor të vitit 2022 do të kremtojmë 100 vjetorin e Shkollës Shqipe të Ploshtanit. Kjo do të jetë një krenari e ligjshme për Ploshtanin dhe gjithë fshatrat e Kalasë Dodës, për të gjithë brezat që u arsimuan dhe u edukuan në bankat e kësaj shkolle. Do ishte mirë që intelektualët, studiuesit, historianët etj., të angazhohen në mbledhjen e kujtimeve, ndriçimin e historisë së shkollës Ploshtanit, si e para shkollë shqipe në nahijen Ana e Epër. Të gjithë së bashku të angazhohemi dhe të kontribuojmë për të festuar këtë jubile të 100 vjetorit të shkollës së Ploshtanit, sa më festive, dinjitoze dhe gjithëpërfshirëse.

lejoj të kryhen ritet fetare. Sipas Arif Zholit, që ka qenë nxënës bashkë me Rrahim Skejën dhe Hysen Izetin: "Nga fundi nëntorit, erdhi komandanti austro-hungarez, që kishte qendrën në Zhur, ku u prit me madhështi nga ushtarë e civilë, por dhe nxënësit e shkollës, ku recituam e bëmë ushtrime gjimnastikore. Ushtarakut të lartë i kërkuan që të mos paguhet taksa, se nuk ka pas prodhim, por ai jo vetëm nuk pranoj, po internoj disa bashkëfshatare".

NË TETORIN E VITIT L922, NË PLOSHTAN ERDHI HASAN PRISHTINA PËR TË HAPUR SHKOLLËN!

Në verën e vitit l922, zhvilloi punimet Kongresi Kombëtar i Arsimit ku u vendos që në çdo komune të hapet shkollë fillore e detyrueshme për të gjithë fëmijët e moshës 7 – vjeç, si për djem dhe për vajza, t'i jepet rendësi mësimit të gjuhës shqipe. Ploshtani ishte qendër komune e kategorisë së dytë për l6 fshatra dhe varej nga nënprefektura e Bicaj, prefektura e Kosovës. Në fund të tetorit l922, vjen në Ploshtan, Hasan Prishtina, për të hapur shkollat në ketë Komunë. Ai qëndroi dy netë tek Osman Lita, një natë tek Sheh Hajra dhe një natë tek Rufat Maliki. Mori takim me administratën e komunës, me pleqësinë e fshatit Ploshtan dhe me disa që kishin tituj fetarë si: Mullah, Haxhi, Afuz, Mezin e tjerë. Ketë e beri pasi në disa fshatra këta kishin qenë kundër, duke thënë se kemi shkollat tona, pra mejtepet. Ai u tha se mësuesin do e biem ne, do të keni në shkollë mësues besimi, shkolla do të financohet nga shteti. Këto kërkesa gjetën përkrahjen e gjithë parisë së fshatit të administratës së komunës dhe të ulemas së fshatit Ploshtan.

Në fund të nëntorit u hap shkolla në shtëpitë e Daut Lezes, me mësues Besim Dalliu dhe Molla Gafurr Brika. Pas 6 muajsh, shkolla u vendos tek xhamia, sepse aty kishte vend për zhvillimin e mësimit në mejtepin e fshatit, brenda ambienteve të xhamisë. Në pranverën e vitit 1923, filloi puna për ndërtimin e shkollës në truallin e shtëpive të Zholit. Ndërtimi përfundoj në kohe rekord, pajisjet e shkollës, banka, tavolina, dërrasa e zezë etj., u morën në Bicë, këto të punuara nga mësuesi shkodran, Ndrekë Cukala. Ndihmë të madhe ka dhenë edhe mësuesi Kolë Vila nga Shkodra që ishte dhe si përgjegjës për arsimin në nënprefekturë. Në katin e parë u bë klase për nxënësit dhe katin e dytë, dhomë për mësuesit.

Ushqimi sigurohej nga vetë mësuesit, por kontribuonin dhe fshatarët. Ne vitin 1925, mësuesi Besim Dalliu transferohet dhe aty dhe vjen Gjon Kabashi, Riza Riza dhe Ibrahim Riza, të cilët shërbyen aty në vitet 1926-1927. Pas tyre, vijnë: Zeqir Zeka, Mahmut Josufi, Tef Kuqani, Ali Dika të cilët shërbyen deri në vitet 1932-1934. Më vonë kanë dhenë mësim edhe Ali Neza e Riza Rama. Nga viti 1922 deri ne vitin 1939, në ketë shkollë ka qenë mësues i lëndës së Teologjisë, Molla Gafurr Brika dhe shkolla mbyllet me pushtimin italian të Shqipërisë. Pas vitit 1939, deri në vitin 1944, ka funksionuar në Ploshtan vetëm Mejtepi. Te gjithë këta mësues janë nderuar e respektuar nga banorët e Ploshtanit, për kontributin e dhenë në arsimimin e fëmijëve të Ploshtanit, e të zonës për rreth.

NË VITIN 1944, RIHAPET SHKOLLA E PLOSHTANIT NË SHTËPITË E EMIN PERZHILLES

Menjëherë pas mbarimit të Luftës, në vitin 1944 rihapet shkolla e Ploshtanit në shtëpitë e Emin Perzhilles, pasi ndërtesa e shkollës e ndërtuar në vitin 1923, ishte shitur Abaz Palushit. Mësimi në ketë shtëpi zhvillohej si në kushtet e luftës, me gjithë përkushtimin e mësueseve Qazim Kuqashi e Rufat Domi. Në shkollë, kishin shkuar me detyrim edhe disa vajza nga Ploshtani. Kontribut për mbarëvajtjen e shkollës kanë dhenë kryetari Këshillit Antifashiste Nacionalçlirimtar, Mahmut Hasani dhe sekretari, Rrahman Brika. Në ketë kohë ishte krijuar organizata e Partisë Komuniste, Organizata e Rinise Antifashiste Nacionalçlirimtare, me sekretare Asllan Iljaz Ferati. Duke parë ambientet jo të mira të shkollës, vëllezërit Rufat, Mislim dhe Sadik Maliki, i falen shkollës hotelin me 8 dhoma dhe 2 dynym tokë, për aktivitete sportive e fizkulture. Në atë kohë aty shërbyen si mësues: Qamil Hoxha, Mustafa Braha, Angjelina Kastrati dhe Dogjan Bulica.

Në vitin 1946, doli vendimi i reformës arsimore ku veç të tjerave, të gjithë të rinjtë nen moshën 40 vjeç, do të mësonin shkrim e këndim në gjuhën shqipe. Në këto kurse, një kontribut të çmuar kamë dhënë mësuesit: Rufat Domi, Qamil Hoxha, Angjelina Kastrati, Ramadan Gjorllaku, Xhemal Cala e të tjerë. Në vitin 1948, u hap klasa e V-të me 14 nxënës nga fshatrat: Çaj-Matraxhi, Kalisi, Bushtrica, Careni e Ploshtani. Por në vitin 1949, nuk pati klasë të V-të, sepse nuk pati numrin e mjaftueshëm të nxënësve për të hapur një klasë.

Ajo u hap në vitin 1950 me 24 nxënës. Per herë të parë shkollën 7 vjeçare (unike) e mbaruan në vitin 1952, nxënësit: Qerim Lame, Ramadan Gjorllaku, Xhemal Cala, Axhem Sufa, Ali Kovaçi, Halim Lita, Abdurrahman Tota, Ilmi Palushi, Xhafer Koka, Nezir Jata, Nuri Skeja dhe 6 vajza nga Ploshtani e Litet. Me ketë rast nga vetë nxënësit u organizua një drekë e cila ngeli si traditë, ku në fund të mbarimit të shkollës, shtrohej drekë me mësuesit e nxënësit e klasës. Me ketë rast, aty u dha një koncert recital, por dhe këngë e valle në Kiavec, ku marri pjesë edhe populli i Ploshtanit. Kjo traditë vazhdoi deri vonë është dhe në vitin l968, kur unë mbarova shkollën 8 vjeçare, bëmë një drekë në Kjavec.

NË VITIN 1956, SHKOLLA 7 VJEÇARE U TRANSFERUA NË CAREN DHE U RIKTHYE NË PLOSHTAN NË 1965-ËN!

Në shkollën tek hoteli i Rufat Malikit, kamë bëre dhe unë klasën e parë në vitin 1961, me mësuesin Bajram Çekiçi. Në vitin 1956, shkolla 7 vjeçare u transferua në Caren, për t'i ardhur në ndihmë Radomirës e Carenit, pasi u hap shkolla 7 vjeçare në Bushtricë. Shkolla rikthehet në Ploshtan ne vitin 1965, pasi hapet shkolla 7 vjeçare e Radomires në fshatin Derbaç. Në atë kohë në Ploshtan erdhën dhe nxënësit e Çernjeves e Carenit, pasi nuk kishte klasë të 6-të në Radomirë. Në vitin 1967, arsimi detyrueshme bëhet nga 7 klasë, në 8 klasë dhe ky sistem më kapi dhe mua. Nga kjo shkollë kanë dalë mësues: Ramadan Gjorllaku, Xhemal Domi, Xhemal Cala, Servet Ferati, Ali Lita, Shaqir Kovaçi, Iljaz Palushi, Shehat Palushi, Sulejman Istrefi, Ramazan Ferati, Shpetim Brika etj.

Ashtu si në gjithë vendin, edhe në shkollën Ploshtanit u ngritën rrethet letrare, të folklorit, të gojëtarisë, të gjuhëtarëve, të arkeologeve, të historisë e të sportit. Këto benë që të gjallërohet jeta në shkolla dhe në fshatra. Filluan të zhvilloheshin konkurse në matematikë, koncerte artistike, aktivitete sportive, marshime e ekskursione në vende historike, pra i dha jetë e gjallëri shkollës e zonës për rreth. Kontribut të veçantë kanë dhënë në ketë drejtim, Ramadan Gjorllaku, Servet Ferati, Xhemal Cala, Beqir Shehu, Iljaz Palushi, Jahe Delia, Rasim Deda, Sulejman Istrefi e shumë të tjerë.

DREJTUESIT E SHKOLLËS SË PLOSHTANIT NGA VITI 1965, DERI NË 2015-ËN

Nga viti 1965, e deri në vitin 20l5, kanë drejtuar shkollën e Ploshtanit Miftar Halili, Xhemal Cala, Beqir Shehu, Jahe Delia, Nezim Deda, Abaz Daci, Sulejman Istrefi, Rasim Deda, Shaqir Kovaçi, Shpetim Brika, Isa Lita, Rushit Mena. Te vjen keq që tani shkolla po shkon drejt mbylljes, për mungesë nxënësish, ku nga bankat e saj, vetëm nga Ploshtani, kanë mbaruar 40 veta arsimin e lartë, 72 veta arsimin e mesëm, dhe rreth 1380 arsimin 8 vjeçar.

Në tetor të vitit 2022 do të kremtojmë 100 vjetorin e Shkollës Shqipe të Ploshtanit. Kjo do të jetë një krenari e ligjshme për Ploshtanin dhe gjithë fshatrat e Kalasë Dodës, për të gjithë brezat që u arsimuan dhe u edukuan në bankat e kësaj shkolle. Do ishte mirë që intelektualët, studiuesit, historianët etj., të angazhohen në mbledhjen e kujtimeve, ndriçimin e historisë së shkollës Ploshtanit, si e para shkollë shqipe në nahijen Ana e Epër. Të gjithë së bashku të angazhohemi dhe të kontribuojmë për të festuar këtë jubile të 100 vjetorit të shkollës së Ploshtanit, sa më festive, dinjitoze dhe gjithëpërfshirëse.

Rruga e Arbërit nr. 183

Romani "Një histori qëndrese" i ka të gjitha përmasat për t'u vlerësuar. Më së pari, për idetë që na sjell. E tërë përmbajtja e tij është për punë, për bëma, përpjekje, rezultate, detyra, detyrime.

recensë

Dogjan Dervishi, "Një histori qëndrese"

Nga prof. **HAJRI SHEHU**


Romani "Një histori qëndrese" i ka të gjitha përmasat për t'u vlerësuar. Më së pari, për idetë që na sjell. E tërë përmbajtja e tij është për punë, për bëma, përpjekje, rezultate, detyra, detyrime. Por ai na sjell edhe të dhëna, dije, modele. Vend të veçantë zënë portretizimet. Ato vijnë krejt natyrshëm. Nga njohjet vetjake të autorit, nga vëzhgimet e tij e nga gjykimet e vlerësimet e tij. E, sigurisht, edhe nga mendimet e veprimet e të tjerëve në roman, që gjithsesi, janë përgjithësime të autorit.

Që në hyrje të romanit e kupton që ke të bësh me një penë të kujdesshme. Arkitektura dhe teknologjia rrëfimtare është si tek tri romanet e mëparshme – e thjeshtë, pa stërhollime e pa mbingarkesa. Shih, për shembull, rrëfimet për takimet, pritjet e përcjelljet e shoqërinë në mjedise të ndryshme. Vendit ia japin njerëzit fytyrën dhe karakterin. Autori e ka pjesë të vetes këtë gjykim. Prandaj në roman shikon një shoqëri të thjeshtë, të pastër, të çiltër, të gjerë. Shumë e vlefshme për jetën e njeriut. Kjo lloj shoqërie shihet në kulturën e mikpritjes, përshkruar bukur në roman në mjedisin shqiptar jashtë shtetit, në azil etj. Dhe mikpritja për ne shqiptarët është virtyt. Madje, edhe kult.

Kryepersonazhi është Artur Semini. Ai na vjen si një individ konkret, si një i njohuri ynë, si një nga brezi ynë (70-80-vjeçarët). Arturi është një model pune e jetese. Me veprimtarinë e tij, por edhe me mendësitë e të thënat e tij. Po përmendim për ata që mund të mos e kenë lexuar deri tani romanin, kur ai refuzon një propozim për rimartesë ngaqë zonja kishte një djalë, që ishte i një grupi bashkëjetese ndryshe nga ç'na ka ofruar natyra njerëzore. Në të vërtetë, kjo s'i prishte asnjë punë Artur Seminit. Por e gjykoi se te shqiptarët e me shqiptarët kjo nuk duhej të ndodhte. Në parantezë: Ishte një gjykim që mbështetej në ligjet e moralit dhe të përsosurisë njerëzore. Më shumë se kaq, Arturi kishte ndier neveri e urrejtje. Tashmë, pas viteve '90, Arturi kishte mësuar edhe historinë e hershme të kësaj pune – që në kohën e profetit Lut (*Lot*, sipas Krishterimit).

Në momente të caktuara, te një njeri i shkujdesur ekziston mundësia të veprojë në kundërshtim me logjikën dhe interesat e tij personale. Akoma më keq – në kundërshtim me logjikën dhe interesat shoqërore. Oficer Semini: Jo. Ai bën një refuzim tjetër. Shumë më të madh se ai i rimartesës: Ai kundërshtoi e refuzoi urdhrin epror që vinte nga lart, shumë lart për të bombarduar Jugun në vitin 1997. Me vendosmëri. Sepse ai kishte tjetër moral e tjetër zemër. Ai humbi në detyrë, por nuk humbi shpirtin. Nuk humbi moralin. Nuk humbi as trimërinë. Në parantezë: Në raste tilla duhet të jesh trim.

Personazhi tjetër, i dytë është Donika Stërmasi – ish-bashkënxënëse në shkollë, në klasë, në mbrëmjet e vallëzimit. Mësuese e shkëlqyer; tani – bashkazilante në shtëpinë e të moshuarve. Dhe, më në fund, bashkëshorte. Autori na sjell një model të personalizuar në dy emra. Të dy – njëri më i mirë se tjetri. Prej disa vitesh (po të duam, mund të themi *edhe dekadash),* disa vlera morale i kemi në krizë. Ne kemi nevojë për njerëz të tillë, sidomos, në kontekstin e sotëm social. Modeli Artur-Donika na nxit t'i kultivojmë. Sot ka çifte të reja bashkëshortore që përfundojnë shpesh në dyer gjykatash. Çiftin Semini nuk e ndau asgjë. As pandemia. Gjithnjë bashkë. Gjithnjë tok.



Ka edhe personazhe të tjera. Profesori, p.sh., në shtëpinë e të moshuarve. Model edhe ai me sjelljen e tij. Ai kishte dhomë të veçantë në azil. U martua çifti Semini dhe profesori u liroi dhomën e vetë shkoi diku tjetër. Edhe këtë lloj njeriu e do shoqëria jonë. Sa mirë do të ishte sikur ndërgjegjen masive ta kishim si të tyre.

Në roman na vijnë botë paralele, më mirë të themi, dy botë paralele – e shkuara jo shumë e largët dhe e tashmja. Në roman bëhet mirë lidhja komplekse midis së shkuarës dhe së tashmes. Por nuk është kaq e lehtë kjo lloj lidhjeje. Autori e bën këtë lidhje nëpërmjet jetës dhe veprimtarisë së personazheve. Në këtë kontekst, duam të përveçojmë vetëm një mendim: Në këto dy botë, që na vijnë në dy rrafshe në roman, njeriu mëson shumë. Një brezatar i tanishëm, për shembull, mëson për kohën e dikurshme, për zboret ushtarake, për trekëndëshin revolucionar në shkollë, për mësuesinë dhe shkollën, për ushtrinë dhe mbrojtjen, për vitet '90 dhe ç'ndodhi atëherë etj. Nga romani mëson edhe për azilet e jetën në azil. Jeta në azil është shumë shoqërore. Kësisoj, edhe e bukur. Kujtojmë, p.sh., ceremoninë e martesës së çiftit dhe fjalën shumë ngazëlluese të drejtoreshës së azilit. Për t'i përmbyllur këto thënie tonat, ne brezatarëve 70-vjeçarë, përveçse na zgjon kujtime e emocione, romani i Dogjan Dervishit na frymëzon e na nxit për të shkruar, të paktën, në formë mbresash e kujtimesh.

Autori nuk largohet nga jeta e gjallë e njerëzve. Po u largove nga jeta e gjallë e njerëzve, bëhesh pre e fantazisë së sëmurë. Autori ynë nuk fantazon. Kush nuk e ka lexuar, të shohë edhe një herë dasmën dhe organizimin e dasmës në shtëpinë e të moshuarve. Dasma është mbijetesa. Prandaj gazmendin e dasmës e jep me një narracion mjaft të ngrohtë.

Autori i zgjedh me shumë sqimë momentet e çastet e kësaj jete të gjallë të personazheve të tij. Edhe letrarisht. Prandaj thamë diku më parë se arkitektura dhe teknologjia e romanit është pa stërhollime e pa mbingarkesa. Shih disa nga këto momente e çaste: Moment i trishtë kur ndërron jetë bashkëshortja e parë. Thirrma "Moos Filomena!" të trand e të mpin. Sigurisht, sepse njeriu është produkt i natyrës e i jetës familjare. Momente të trishta dhe më pas, në jetën, tashmë vetmitare të kryepersonazhit: *Artur Semini u ngrit dhe hapi dritaren e dhomës. Qëndroi me kokën në dritare dhe ia lëshoi sytë qytetit. Iu duk se qyteti po mbytej nga dendësia e pallateve ... dhe smogu, që të merrte frymën nga qarkullimi i makinave të vogla e të mëdha, që lëshonin tym e zhurmë të pandërprerë.* I trishtë edhe momenti tjetër në buzë të detit: *Shpendë të ndryshëm, banorë të brigjeve të detit, lëshonin cicërima dhe në kor, bashkë me zhurmën e dallgëve, prodhonin një kompozim tingujsh që krijonin një gjendje shpirtërore romantike, të ndërthurur me nota pesimiste.* Më pas kemi një moment tjetër - njohjen, më mirë të themi, rinjohjen me ish-shoqen e shkollës – Donikën, tani azilante: Edhe pse rreth të 70ave: *Ishte e veshur mirë, e mbajtur, e pastër, me flokë të thinjur, por të krehur e të rregulluar, që të jepnin përshtypjen se me këtë ngjyrë kishin lindur.* Nuk është zor të shohësh pëlqimet e nëpërmjet tyre, ndjenjën e madhe njerëzore të dashurisë. Ja edhe dy momente të tjera po aq njerëzore: *Sado e mirë ... të ishte për ty një femër tjetër, asnjëherë, kurrë nuk mund ta zëvendësojë mamanë tonë, Filomenën.* I thonë kështu fëmijët (Filomena, e shoqja e parë, ishte ndarë nga jeta). Dhe fjala e A. Seminit, diku në breg të detit: *Ndjesë Filomena! Po përpiqemi të të zëvendësojmë. Por ... vendin tënd në zemrën time, sa të jem gjallë, nuk mund ta zëvendësojë askush* ... Por ja që e zuri dikush tjetër. Dhe atë ditë, kur do të rimartohej: *Për çudi, dielli lindi më herët dhe ndriçimi ishte më i fortë. Shpendët cicërinin në drurët gjelbërues të oborrit të shtëpisë së të moshuarve dhe këngët e tyre ishin kaq të ndryshme, sa të kujtonin një orkestër simfonike që të mbushte zemrën me gëzim, emocion dhe shpresë.* Një pranverë e vogël në mes të dimrit. Sepse njerëzisht, dashuria s'njihka kufi. Është një mundësi që ta jep jeta. Dhe njeriu duhet të dije që këtë mendësi ta bëjë një realitet të bukur. Çifti Semini e bëri. *Martohen dy banorë të shtëpisë sonë,* - thotë drejtoresha. Ndërkohë, Shpresës, vajzës së Arturit, i rrëshqasin dy pika lot. Njerëzore është. Dikush tjetër zë vendin e mamasë së saj.

Personazhet janë modele. Për virtytet dhe vlerat që kanë. Për kulturën që kanë. Në roman, gjithsekush bën detyrën e punën që i takon. Për të mirën e vet. Por edhe për të mirën e shoqërisë, sepse njeriu nuk jeton vetëm për veten e vet. Shih, p.sh., punën në shkollë. Por edhe në familje. Shih punën në ushtri. (Kujtojmë që Arturi ishte oficer. Një oficer patriot dhe i devotshëm). Shih edhe punën e punët në azil. Shih edhe marrëdhëniet ndërnjerëzore. Dhe ajo që mësojmë, është qytetaria. Nëse krijon qytetarin, - ka thënë shkrimtari i madh Viktor Hygo, - ke në pëllëmbë të dorës gjithçka. Dhe qytetaria vjen nga ata e ato, që kanë kulturë, në kuptimin më të përgjithshëm të fjalës.

Karakteret paraqiten, siç u tha, me vërtetësi – me të përbashkëtën e tyre, por edhe me tërë individualitetin e tyre: me ndodhitë e tyre vetjake, me kulturën e tyre të lartë, me protagonizmin e tyre, me copëzat e jetës së tyre, që përbëjnë, sidoqoftë një thyezim, një mozaik. Sigurisht, në qendër të romanit është jeta e Artur Seminit. Me gjithçka që i ndodhi. Dhe ajo që mësojmë nga ai dhe nga jeta e tij është: Jeta ka kuptim kur kemi vullnet për ta rregulluar, kur ka mungesa e defekte e për ta jetuar atë. Sidoqë, siç thotë autori, ajo (= jeta) nuk të lejon ta shijosh, njeriu nuk duhet t'i humbasë arsyet për të mos e jetuar atë siç duhet. Dhe më tej: *Nuk është i fortë, - thotë autori,- ai që nuk bie (= rrëzohet), por ai që bie dhe ka fuqi të ngrihet për të dalë më i fortë, për të ecur përpara pa u ndalur.* Kështu është, vërtet. Shihni në roman rënien dhe ringritjen e oficer Seminit.

Në roman koha ecën bukur. Pleqëria e çiftit është ngadalësuar tashmë. Por..., na del mikrobota. Virusi. Kovidi. Edhe kësaj mikrobotës e këtij virusit i rezistojnë Seminët. Por edhe të gjithë banorët e shtëpisë së të moshuarve. Dhe në shtëpinë e të moshuarve bëhet festë e madhe: U mund Kovidi. U ringrit jeta. Edhe jeta bashkatare e çiftit. Jeta vijon. Jeta është e bukur. Por nuk është e lehtë, - na thotë romani. Ku ka termale, - thotë populli, ka edhe teposhte. Për njeriun janë. Por njeriu nuk rri në teposhte. Një mësim tjetër ky.

Do të bëjmë një përsëritje për të nxjerrë një konkluzion tjetër. Kovidi mbërriti edhe te shtëpia e të moshuarve. Edhe te Artur Semini e Donika Stërmasi. Kovidi rrëmbeu jetë njerëzish, siç rrëmbejnë e lëshojnë përtokë furtunat e dimrit degët e thara të drurëve në pyll. Banorët e shtëpisë së të moshuarve i bënë ballë me sukses. Edhe Arturi e Donika. Dhe na erdhi festa në këtë shtëpi. Gjithandej në roman sheh qëndresën. Dhe bashkë me qëndresën, Dogjan Dervishi na solli optimizmin. Themi na e solli, sepse romani mund të kishte pasur edhe fund tjetër. Në parantezë: Jeta e personazheve në një vepër letrare është, siç vjen rrjedha objektive e ngjarjeve. Por personazhet janë edhe në dorë të autorit – në dorë të botëkuptimit të tij, të detyrës që i ka vënë vetes, të parimeve të tij etike, letrare e estetike, të pëlqimeve e të mospëlqimeve të tij etj. Nga leximet, dimë që heroi i Xhek Londonit – Martin Iden – mbytet në ujë. Ana Karenina futet nën rrotat e trenit. Dhe thonë që i madhi Lev Nikollajeviç Tolstoi (Leon Tolstoi, siç e njohim më shumë) është pezmatuar shumë që heroina e tij, Ana, përfundoi atje. Ka edhe shembuj të tjerë. Dogjan Dervishi i shpëton personazhet e tij. Një mësim tjetër etiko-letrar që marrim nga ai dhe nga vepra e tij. Dhe ne brezatarët e çiftit Semini ia dimë për nder. Sepse si Seminët, edhe ne e duam jetën. Sepse jeta është e bukur.

E urojmë përzemërsisht zotin Dervishi. Na tuboftë si sot për të përuruar romanin e tij të pestë!

Bëj një abonim online ose në print...
Tashmë mund të bëni pajtimin tuaj edhe pranë çdo sporteli të
Postës Shqiptare!
Kushton vetëm 600 lekë në vit...
email: rrugaearberit@gmail.com

Na ndiqni:

RRUGA E ARBËRIT
https://www.facebook.com/gazeteerajonitteDibres
ose
www.rrugaearberit.com

Xhelal Hysa, *heroi që rron në përjetësi*

Nga **SHAQIR ÇERPJA**

Koha, ditët, muajt dhe vitet, ashtu si njerëzit, ato kanë historinë dhe biografinë e tyre. Se, ashtu si njerëzit, që lënë gjurmë në kohë, edhe koha len gjurmë në jetën e njerëzve, në kujtimet dhe kujtesën e tyre. Viti 1985, dimri i madh i atij viti, ka lënë gjurmë të thella dhe mbahet e do të mbahet mend gjatë, shumë gjatë. Dhe, jo thjeshtë për borën e madhe dhe për vështirësitë e shumta të atij dimri të madh, por, kryesisht për fatkeqësitë që solli dhe vdekjet që shkaktoi, veçanërisht në Dardhë e Lurë, por edhe në zona e rrethe të tjera të vendit tonë. Dimri i vitit 1985, në Dardhë identifikohet me Xhelal Hysen, me emrin dhe vdekjen e tij nga orteku, nga bora e bardhë e asaj nate të zezë.

Që atëherë, që nga ajo kohë kanë kaluar rreth 36 vjet, por në kujtimet e kujtesën tonë, ajo kohë e ajo ngjarje është sikur të ishte dje, se nuk harrohet kurrë ai dimër, ajo borë dhe ai ortek, ajo dhimbje, ai hidhërim, trishtim e pikëllim, ata lotë e ai vajtim. Unë, bashkë me kolegun tim, Hakik Hysa ndodheshim në punë në Zall-Dardhë dhe kishim tri ditë e tri netë që nuk shkonin në shtëpi, por punonim e flinim në zyrë, se koha ishte e vështirë rrugët ishin zëna nga bora e madhe, lidhja, qarkullimi dhe lëvizja e njerëzve ishte ndërprerë. Lidhja telefonike nuk funksiononte. Pak pas mesditës, vjen në zyrën tonë mësuesi i edukimit fizik të shkollës së Zall-Dardhës, Faik Sula dhe, i zverdhur e i zbehur në fytyrë, me zë të dridhur dhe diksion dëshpërues, na thotë se kam një lajm të keq, por të lutemi e të shpresojmë se ky lajm të mos jetë i vërtetë. Na tha se dyshohej që, Xhalal Hysa ka mbetur mbrëmë në rrugë, në dëborë. Njerëzit në Lashkizë, por edhe fshatrat tjerë përrreth janë ngritur në alarm dhe po kërkojnë. Por dyshohet se Xhelali ka vdekur, nuk është gjallë. Na trembi e na trishtoi ky lajm i beftë, edhe pse nuk e besonim dhe uronim, shpresonim që ky lajm të mos ishte i vërtetë. Nuk na besohej se mund të kishte vdek Xhelal Hysa. Ishim mësuar t'a shikonim gjithmonë në ballë të punës e të punëve , në ballë të përpjekjeve, vështirësive dhe pengesave, të cilat, gjithmonë i kishte kaluar e kapërcyer me sukses. Ai ishte i fortë dhe i vrullshëm si një ortek. Si mund ta ndalte bora dhe orteku?! Jo! Nuk mund t'a ndalte bora dhe orteku , se s' mund t'a ndalte orteku ortekun! Ishte njeri energjik, i shkathët, i fuqishëm, i pathyeshëm, i pamposhtur.

Nuk më besohej se mund të kishte vdek Xhelali, se tri ditë pas festës së vitit të ri, tri ditë më parë ishin bashkë. U ndodhën bashkë në mbledhjen e shtabit të brigadës së Qanit, për të analizuar situatën dhe për të diskutuar dhe vendosur për masat emergjente për të përballuar vështirësitë e motit. Dhe pasi u ndanë detyrat, Xhelali u ngrit, iu drejtua kryetarit të kooperativës, Nazmi Shira dhe tha: -Punëtorët, që caktuat për të punuar këtu me mua, për të zbuluar nga bora çatitë e sallës dhe të magazinës, le të vinë me ju në Soricë, se atje ka më shumë nevojë, ndërsa unë do të punoj këtu me disa të moshuar. Kam folur e biseduar vetë me ta. Kështu u ndamë atë ditë janari, duke menduar se do të shiheshin përsëri, do të takoheshim përsëri bashkë dhe do të ecnim, do të punonim, do të qeshnim dhe do të festonim bashkë.

Dhe, siç ishim në zyrë të tre, unë, Faik Sula dhe Hakik Hysa, u nisëm menjëherë për në Lashkizë. Ecnim duke u ndërruar herë pas herë për të çarë borën e hapur rrugën. Gjithë rrugën nga Zall-Dardha në Lashkizë e bëmë në heshtje, por secili duke folur me mendimet e veta dhe me shpresën se sapo të arrinim në Lashkizë, do të mësonim të vërtetën, se lajmi i keq nuk ishte i vërtetë, se Xhelali ishte gjallë dhe vetë Xhelali do të na



dilte përpara dhe do të qeshte e do të bënte humor me nxitimin dhe lodhjen tonë. Dhe, me të arritur në Lashkizë, morëm vesh lajmin e vërtetë, por ... fatkeqësisht, lajmi i keq ishte i vërtetë, Xhelal Hysa kishte vdek.

* * *

Një natë më parë, Xhelali kishte qënë në mbledhjen e shtabit të sektorit në Lashkizë, ku ishte dhe kryetari i kooperativës, Nazmi Shira. Pas përfundimit të mbledhjes së shtabit të sektorit, Xhelali, i vetëm, ishte nisur për në Qa. Njerëzit në Lashkizë e kishin lutur dhe kishin këmbëngulur që Xhelali të rrinte në Lashkizë, të mos nisej për në Qa, se koha ishte e vështirë, rruga ishte zënë nga bora, ishte vetëm dhe ishte vonë. Se ai dimër nuk ishte si çdo dimër, se ajo borë nuk ishte si çdo borë, se ajo natë nuk ishte si çdo natë. Por Xhelali nuk kishte pranuar të rrinte në Lashkizë. Donte të shkonte në shtëpi, se përveç merakut për dy prindërit e tij të moshuar dhe familjen e tij, i duhej të përmbushte detyrën e dhënë dhe angazhimin e marrë në mbledhjen e shtabit të sektorit në Lashkizë, për të qënë pranë njerëzve, në krye e në ballë të tyre, për të përballuar situatën e krijuar nga koha e vështirë, bora e madhe dhe moti i ftohtë i atij dimri të acartë.

Dhe, Xhelali ishte nisur. Kishte besim tek vetja, tek shëndeti, fuqia fizike, tek shpirti dhe zemra e tij. I vetëm ishte nisur dhe i vetëm kishte ecur në rrugën pa rrugë, në natën pa hënë ... Ishte ngjitur deri në Kodër Lera. Kishte kaluar Kodër Letrat. Kishte arritur dhe kishte kaluar edhe Rrëshqimën, por vetëm disa hapa e disa metra dhe jo më shumë, sepse orteku i kishte dalë përpara, i kishte prerë rrugën, i kishte ndal hapin, i kishte lidh krahët, i kishte shtërnguar trupin dhe Xhelali bashkë me ortekun ishin ndal në përrua. Xhelali ishte përpjekur dhe kishte luftuar për të dalë e shpëtuar nga kthetrat e ortekut, por ... jo! Atë natë, vetmia, errësira e natës, bora e madhe dhe të ftohti, ... të gjitha i ishin bërë bashkë dhe i ishin bërë krah dhe kishin ndihmuar ortekun. Me Xhelali ishin vetëm mendimet e tij, ëndërrat dhe shpresat. Dhe, atë natë të ftohtë e të errët janari, Xhelal Hysa mbeti poshtë borës së ortekut. Aty iu ndal fryma, aty i pushoi zemra dhe i ngriu trupi. Aty iu prenë mendimet, ëndërrat, shpresat. Të nesërmen e asaj nate të zezë, pak pas mesditës, Xhelalin e gjetën në përrua, pa jetë, poshtë borës së ortekut. Vetëm një buzëqeshje e lehtë në fytyrën e tij nuk ishte shuar akoma. Ajo buzëqeshje vinte nga jeta, ishte buzëqeshje jete. ...Ndoshta, pak çaste përpara se të

Titulli i lartë, "Hero i Punës", iu dha Xhelali, pas vdekjes. Por Xhelali ishte hero i gjallë edhe kur ishte gjallë. Ai ishte njeri i gjallë dhe energjik, me shumë vullnet e pasion për punën. I përkushtuar dhe këmbëngulës për të realizuar detyrat, çdo detyrë dhe objektiv. Në moshën e rinisë, ai ishte drejtues i organizatës së rinisë të fshatit Lashkizë dhe për shumë vite drejtues i komitetit të rinisë të zonës së Dardhës. Ishte jo vetëm i zgjuar, por edhe i kulturuar dhe i emancipuar.

takohej e të përleshej me ortekun, Xhelali po mendonte, ëndërronte dhe shpresonte se do të kalonte e do të arrinte në shtëpi. Por... Xhelali, në shtëpinë e tij dhe në çdo familje e vatër shqiptare arriti atë ditë, por arriti si njeri i pavdekshëm, si hero që rron në përjetësi. Se lajmi për vdekjen e Xhelalit u shpërnda dhe u përhap me shpejtësi. Radio, televizioni dhe të gjitha gazetat qëndrore dhe lokale, lajmin për vdekjen e Xhelalit e përcollën për disa ditë me radhë, U shkruan dhe botuan poezi. Poezinë e parë e shkroi poeti Visar Zhiti. Pas tij shkruan edhe poet të tjerë. U krijuan dhe kënduan edhe këngë. Presidiumi i Kuvendit Populllor i akordoi dhe i dha titullin e lartë "Hero i Punës"

* * *

Titulli i lartë, "Hero i Punës", iu dha Xhelali, pas vdekjes. Por Xhelali ishte hero i gjallë edhe kur ishte gjallë. Ai ishte njeri i gjallë dhe energjik, me shumë vullnet e pasion për punën. I përkushtuar dhe këmbëngulës për të realizuar detyrat, çdo detyrë dhe objektiv. Në moshën e rinisë, ai ishte drejtues i organizatës së rinisë të fshatit Lashkizë dhe për shumë vite drejtues i komitetit të rinisë të zonës së Dardhës. Ishte jo vetëm i zgjuar, por edhe i kulturuar dhe i emancipuar. Përkundër mentalitetit fanatik të kohës, Xhelali, bashkë me nusen e tij, shkuan për disa muaj në fshatrat e jugut të Shqipërisë, për t'u njohur me jetën dhe jetesën atje, për shkëmbim përvojë dhe eksperience. Ka marrë pjesë vullnetar në disa aksione kombëtare.

Gjithmonë ka bërë punë e detyra drejtuese, jo vetëm shoqërore, por edhe shtetërore. Ishte njeri me shpirt human dhe ishte i papërtuar për të ndihmuar të tjerët. Xhelali ishte njeri vizionar. Mendonte dhe punonte për të ardhmen, për perspektivën. Vetë kontribuonte për hapje e zgjerim rrugësh në fshat, shkulte pemë të egra në pyll dhe i mbillte anës rrugëve të fshatit. I shartonte ato; shkonte në pyll dhe shartonte atje pemë të egra, që të hanin barinjtë, punëtorët, udhëtarët. Vetëm me iniciativën e tij, por dhe me kontributin e tij fizik, ndërtoi shkollën fillore në fshatin Qa, me dy klasa mësimi dhe dhomë për mësuesit dhe pasi përfundoi ndërtimi i shkollës, vetë Xhelali vuri në lëvizje organet shtetërore në zonë e në rreth dhe u miratua hapja e shkollës në fshatin Qa. Ndërtimi dhe hapja e shkollës fillore në fshatin Qan ishte një kontribut shumë i çmuar i Xhelalit për fshatin, por veçanërisht për fëmijët e moshës së shkollës fillore, që deri atëhere bënin rrugë shumë të gjatë e të vështirë dhe shkonin e bënin mësim në shkollën e Lashkizës. Xhelal Hysa ishte dhe mbetet një hero i pavdekshëm, që rron në përjetësi.

IN MEMORIAM

Një vit pa Avni Xhepën

Në plejadën e ushtarakëve tanë që i shërbyen atdheut me përkushtim e devotshmëri të lartë është edhe Avni Xhepa. Për katër dekada si oficer, fillimisht në Ministrinë e Mbrojtjes dhe më pas në reparte e njësi të ndryshme ushtarake ai krijoi profilin e ushtarakut me karrierë të shkëlqyer.



Avniu u lind në Vleshë të Dibrës me 10 Korrik 1932. Ai ishte vetëm 7 vjeë kur mbeti jetim nga të dy prindërit. Për disa vite, për Avniun, më të voglin e të tre fëmijëve, u përkujdesen të afërm të familjes. Respekti dhe mirënjohja për këta të afërm u ushqye e u mbajt e gjallë edhe në gjeneratat e tjera të familjes.

Jeta e Avniut mori një drejtim tjetër kur në adoleshencën e tij të hershme la fshatin e shkoi në kantjerin e ndërtimit të Hidrocentralit "Lenin" në Tiranë. Një botë e re u hap para djalit të ri. Shpejt ai ua caktua normist për një nga sektorët e kantjerit. Avniu punoi për dy vjet në Hidrocentral derisa u thirr për të kryer shërbimin ushtarak. Pa mbaruar periudhën e plotë të shërbimit, Avniu u caktua të ndjekë Shkollën e Bashkuar të Oficerëve të cilen e mbaroi me rezultate të larta.

Emërimin e parë si oficer Avniu e pati në Ministrinë e Mbrojtes e më pas u transferua në Korçë. Emerimi në Korcë pati ndikim të thellë në jetën e Avniut: këtu ai u njoh, lidhi jetën dhe krijoji familje me Nurien. Ata jetuan bashkë për 60 vjet – vetëm vdekja e parakoshme e Nuries i ndau.

Kariera e Avniut ishte gjithnjë në rritje. Ai u gradua vazhdimisht në detyrë dhe siç ishte jeta e ushtarakëve të asaj kohe Avniu u transferua shpesh në zona të ndryshme të Shqipërisë. Nuk ishte e lehtë, por Nurija dhe fëmijët e ndoqën pas kudo që u emerua.

Emërimi me detyrë në zonen e Lurës të rethit të Dibrës në vitin 1967 ishte kuptimplotë: Dibrani jetim, u kthye pas 20 vjetësh në Dibrën e tij, por tashmë me reputacion të formuar në rangun ushtarak e jetën civile. Fëmijet ishin të rritur tashmë për të kuptuar respektin e dashurinë me të cilën popullsia e zonës rrethoi këtë familje të re – dhe e njejta: me nderim e respekt u fol gjithmonë e flitet në familjen e Avniut për Lurën e njerezit e saj.

Në vitin 1970 Avniu u emërua në Peshkopi, me gradime të ndyshme në vite deri sa doli në pension më 1988.

Më 1993 familja e tij u shpërngul në Tiranë e më pas, në vitin 2003 Avniu dhe bashkëshortja e tij, Nuria, u bashkuan me fëmijet në Vankuver, Kanada.

Avniu u nda nga jeta me 11 Dhjetor 2020. Një udhëtim në Shqipëri që ai bëri në shtator të 2019 mori kuptim të veçantë – ai i dha lamtumirën e fundit të afermve, miqve e shokëve të atdheut ët tij të shtrenjtë.

Në përvjetorin e parë të ndarjes nga jeta, familjarët, miqtë, të afërmit dhe shokët e tij në vendlindje, Peshkopi, Tiranë e në hapësirën mbarëshqiptare në botë e kujtojnë atë me nderim të veçantë. I tillë do të kujtohet e nderohet gjiothmonë njeriu i mirë Avni Xhepa, iontelektuali që rrezatonte gjithkund mirësi e vlera.



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falënderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Website është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:

https://tinyurl.com/lcc3e2f

Foto Majtas tregon pamjen e parë të faqes zyrtare në Facebook të gazetës *Rruga e Arbërit*

NE nuk jemi gazetë e pavarur, NE jemi gazetë e lirë
dhe pavarësia dhe liria jonë garantohet
vetëm nga mbështetja e lexuesve...

BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

TANI MUND TË PAJTOHENI PRANË SPORTELEVE TË POSTËS SHQIPTARE NË TË GJITHË SHQIPËRINË. NJË PAJTIM VJETOR KUSHTON 600 LEKË

BIGmarket

një epokë e re dashurie
ndaj jush po nis tani

GJITHMONË ME OFERTA...
PESHKOPI MAQELLARË